

aftəsi



COPYRIGHT © UNITED NATIONS

GENEVA 2007

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem kërkimi, apo të transmetohet në çfarëdo lloj forme apo përmes cilësdo mënyre, elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi, apo ndonjë tjetër, pa lejen paraprake të Kombeve të Bashkuara.

Ky Udhëzues nuk është prodhuar për shitje tregtare. Ai shpërndahet me kushtin që nuk mund të jepet me qera apo të shpërndahet në ndonjë mënyrë tjetër, përfshirë këtu edhe mënyrat tregtare, pa lejen paraprake të botuesve, në cilëndo formë përveç se origjinalit dhe me kushtin që botuesi i rradhës të pëmbushë të njëjtat kërkesa.

Aplikimet për të drejtat e riprodhimit të këtij punimi apo pjesë të këtij punimi mirëpritur dhe duhet të dërgohen pranë Kombeve të Bashkuara. Shtetet Anëtare dhe institucionet e tyre qeveritare mund të përkthejnë dhe riprodhojnë këtë punim pa leje, por u kërkohet që të informojnë Kombet e Bashkuara për sa më lart.

ISBN 978-92-9142-347-7

HR/PUB/07/6

Falenderime

Udhëzuesi është përgatitur bashkarisht nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Shoqërore (UN-DESA), Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) dhe Unioni Ndër-Parlamentar (IPU).

Autorët kryesorë: Andrew Byrnes (Universiteti i New South Wales, Australi), Alex Conte (Universiteti i Southampton, Mbretëria e Bashkuar), Jean-Pierre Gonnot (UN-DESA), Linda Larsson (UN-DESA), Thomas Schindlmayr (UN-DESA), Nicola Shepherd (UN-DESA), Simon Walker (OHCHR), dhe Adriana Zarraluqui (OHCHR).

Kontribues të tjerë: Graham Edwards (Anëtar i Parlamentit, Australi), Anda Filip (IPU), Anders B. Johnsson (IPU), Axel Leblois (Nisma Globale për ICT Gjithpërfshirëse), Janet Lord (BlueLaw LLP), Alessandro Motter (IPU), James Mwandha (ish anëtar i Parlamentit, Uganda), Kaj Nordquist (ish anëtar i Parlamentit, Suedi), Mona Pare (Universiteti i Carleton, Kanada), dhe Hendrietta Bogopane-Zulu (Anëtare e Parlamentit, Afrikë e Jugut).

Gjithashtu, Organizata Inclusion International (II), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Shoqërore për Azinë dhe Paqësorin (ESCAP), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), Banka Botërore, dhe Organizata Botrore e Shëndetësisë (WHO) ofruan udhëzim fillestar dhe komente mbi tekstin.

Konsulent editorial: Marilyn Achiron

Dizenjo dhe faqosje: Kal Honey, Eye-to-Eye Design (Brampton, ON, Kanada)

Shtypja: SRO-Kundig (Gjenevë, Zvicër)

Botimi në shqip i Udhëzuesit për Parlamentarët u realizua me mbështetjen financiare të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, (PNUD), www.undp.org.al, në kuadrin e projektit “Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri; Program mbështetës për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)” që po zbatohet nga PNUD, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, www.mpcs.gov.al dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, www.adrf.org.al. Tiranë, Nëntor 2010.

Faqosja në shqip: Orest Muça
Printimi: AlbPAPER

Parathënie

Personat me aftësi të kufizuar mbeten ndër shtresat më të marginalizuara në çdo shoqëri. Ndërsa korniza ndërkombëtare e të drejtave të njeriut ka ndryshuar jetë njerëzish kudo në botë, personat me aftësi të kufizuar nuk kanë marrë të njëjtat përfitime. Pavarësisht prej situatës së të drejtave të njeriut apo gjendjes ekonomike të secilit vend, personat me aftësi të kufizuar janë përgjithësisht të fundit në rradhë sa i përket respektimit të të drejtave të tyre. Duke qënë se iu mohohen mundësitë që do t'i lejonin ata të ishin të pavarur, shumica e personave me aftësi të kufizuar i kthejnë sytë nga dashamirësia dhe bamirësia e të tjerëve. Në vitet e fundit, në të gjithë botën është kuptuar gjithmonë e më tepër fakti se mohimi i të drejtave të njeriut për 650 milionë individë ishte i patolerueshëm. Ishte koha për veprim.

Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar është përgjigja e komunitetit ndërkombëtar për historinë e gjatë të diskriminimit, përjashtimit dhe dehumanizimit të personave me aftësi të kufizuar. Kjo konventë është historike dhe novatore në shumë drejtime, duke qënë traktati i të drejtave të njeriut i cili është negociuar në periudhën kohore më të shkurtër ndonjëherë, dhe gjithashtu duke qënë traktati i parë i shekullit të njëzetënjtë. Konventa erdhi si rezultat i negociatave tre vjeçare që përfshinë shoqërinë civile, Qeveritë, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat ndërkombëtare. Pas adoptimit të Konventës në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Dhjetor 2006, një numër rekord vendesh demonstruan përkushtimin e tyre për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar duke nënshkruar Konventën dhe Protokollin e saj Opsional kur ato u hapën për nënshkrim në Mars të vitit 2007.

Konventa siguron që minoriteti më i madh në botë të gëzojë të njëjtat të drejta dhe mundësi si kushdo tjetër. Ajo mbulon hapsirat e shumta ku personat me aftësi të kufizuara janë diskriminuar, duke përfshirë aksesin tek drejtësia; pjesëmarrjen në jetën politike e publike; edukimin; punësimin; lirinë nga tortura, shfrytëzimi dhe dhuna, si dhe lirinë për të lëvizur. Sipas Protokollit Opsional, individët që i përkasin Shteteve që janë anëtarë të protokollit dhe që pretendojnë dhunim të të drejtave të tyre, dhe që kanë ezauruar shkallët kombëtare të ankimimit, mund të kërkojnë një rishqyrtim përmes një institucioni të pavarur ndërkombëtar.

Kjo Konventë ishte e nevojshme prej kohësh. Kanë kaluar më tepër se 25 vjet prej vitit 1981, që ishte Viti Ndërkombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar, vitit që solli vëmendje globale tek çështjet që prekin personat me aftësi të kufizuar. Në këto vite, shumë shoqëri i janë larguar praktikës së konsiderimit të personave me aftësi të kufizuar si objekte bamirësie dhe mëshire, duke njohur faktin se vetë shoqëria është kufizuese. Kon-

venta e ka trupëzuar këtë ndryshim qëndrimi, dhe ky është një hap tepër i rëndësishëm drejt ndryshimit të perceptimit të aftësive të kufizuara, për t'u siguruar që shoqëritë e njohin konceptin se të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësinë për të arritur potencialin e tyre të plotë.

Ky Udhëzues është rezultat i bashkëpunimit mes Departamentit të Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Shoqërore, Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, dhe Unionit Ndër-Parlamentar. Përgatitja e Udhëzuesit u ndihmua edhe prej bordit të rishikimit që përbëhej nga parlamentarë, akademikë dhe praktikantë të fushës – shumë prej të cilëve janë persona me aftësi të kufizuara.

Parlamentet dhe parlamentarët kanë një rol kyç për të luajtur në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky Udhëzues synon të ndihmojë parlamentarët dhe të tjerë në përpjekjet e tyre për të përmbushur Konventën në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kryejnë tranzicionin nga përjashtimi drejt barazisë. Udhëzuesi synon të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me Konventën dhe parashikimet e saj, të promovojë vlerësimin e shqetësimeve të aftësisë së kufizuara, dhe të ndihmojë parlamentet për të kuptuar mekanizmat dhe kuadrin e nevojshëm për të përkthyer Konventën në praktikë. Duke ofruar shëmbuj dhe depërtim në çështje, shpresohet që Udhëzuesi do të shërbejë si një mjet i dobishëm për parlamentarët për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të gjithë botën.

Sha Zukang
Nën Sekretare e Përgjithshme
Departamenti për Çështjet
Ekonomike dhe Sociale

Louise Arbour
Komisionere e Lartë e Kombeve
të Bashkuara për të Drejtat e
Njeriut

Anders B. Johnsson
Sekretar i Përgjithshëm
Unioni Ndër-Parlamentar

PËRMBAJTJA

Falenderime

Parathënie

Kapitulli 1: Pamje e përgjithshme

Kuptimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara: arsytet detyruese

Fokusi i Konventës

Përse nevojitet një konventë

Të drejtat e specifikuar në Konventë

Marrëdhënia mes aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit

Kapitulli 2: Konventa në detaje

**Zhvillimet historike të cilat çuan drejt konventës së re
Konventa e parë kalimthi**

Qëllimi i Konventës

Fusha e mbulimit të Konventës

Përkufizimi i aftësisë së kufizuar

Të drejtat dhe parimet e rradhitura në Konventë

Parimet e përgjithshme

Të drejtat

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Detyrimet e Shteteve anëtare sipas Konventës

Detyrimet për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur

Krahasimi i Konventës me traktatë të tjera të të drejtave të njeriut

Kapitulli 3: Monitorimi i Konventës dhe Protokollit Opsional

Mekanizma monitorues brenda Konventës

Komiteti mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Raportimi Periodik

Qëllimi i raportimit periodik

<i>Vazhdimësia ndjekëse pas raportimit periodik</i>	
<i>Konferenca e Shteteve anëtare</i>	
<i>Mekanizma të tjerë për të monitoruar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar</i>	
Protokolli Opsional i Konventës	
<i>Procedura e komunikimeve individuale</i>	
<i>Procedura e hetimit</i>	
<i>Anëtarësimi në Protokollin Opsional</i>	
Sekretariati i Kombeve të Bashkuara i cili mbështet Konventës	

Kapitulli 4: Bërja anëtar i Konventës dhe Protokollit Opsional

Anëtarësimi në Konventë	
<i>Nënshkrimi i traktatit</i>	
<i>Çfarë nënkupton nënshkrimi i traktatit</i>	
<i>Dhënia e pëlqimit për të qenë i detyruar nga Konventa</i>	
<i>Procesi i ratifikimit</i>	
<i>Ratifikimi nga organizatat e integritit rajonal</i>	
<i>Anëtarësimi në Konventë</i>	
<i>Instrumenti i ratifikimit, konfirmimit formal apo aksesit</i>	
<i>Roli i parlamentit në procesin e ratifikimit</i>	
<i>Kur hyjnë në fuqi Konventa dhe Protokollin opsional</i>	
Rezervimet ndaj Konventës dhe Protokollit Opsional	
<i>Modifikimi dhe tërheqja e rezervimeve</i>	
Deklaratat për Konventën dhe Protokollin Opsional Opsional ...	
<i>Tipet e deklaratave për Konventën dhe Protokollin Opsional</i>	
<i>Bërja e deklaratave për Konventën</i>	
Lidhja e Konventës për jo-anëtarët	

Kapitulli 5: Legjislacioni kombëtar dhe Konventa.....

Integrimi i Konventës në ligjin kombëtar	
---	--

<i>Kuptimi i nënshkrimit dhe ratifikimit</i>	
<i>Integrimi përmes masave kushtetuese, legislative dhe rregullatore</i>	
<i>Llojet e legjislacionit mbi barazinë dhe mos-diskriminimin</i>	
Përmbajtja e masave legislative	
<i>Elementë të rëndësishëm</i>	
<i>Lidhja mes legjislacionit zbatues dhe Konventës</i>	
<i>Llojet e aftësisë së kufizuar që duhet të adresohen në legjislacion</i>	
<i>“Akomodimi i arsyeshëm” si një gur themeli i legjislacionit</i>	
<i>Masat e veçanta</i>	
<i>Diskriminimi prej autoriteteve të Shtetit, personat privatë dhe korporatat</i>	
<i>Zonat specifike për reformë legislative</i>	
<i>Ligjet e pronësisë intelektuale dhe sigurimi i aksesit tek librat, filmat e forma të tjera të medias</i>	
<i>Legjislacioni që njih gjuhë(ët) kombëtare të shenjave</i>	
<i>Procedurat e ankimimit sipas ligjit kombëtar</i>	
Masat procedurale për të promovuar zbatimin	
<i>Ndërmarrja e një rishikimi të gjithësishtëm</i>	
<i>Sigurimi që të gjitha ligjet të jenë në përputhje me Konventën</i>	
<i>Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në procesin legjislativ</i>	
<i>Përfshirja e parlamenteve provinciale apo shtetërore</i>	

Kapitulli 6: Nga parashikimet ligjore tek praktika: Zbatimi i Konventës

Aftësimi dhe riaftësimi	
Aksesibiliteti	
Edukimi	
<i>Kostoja e edukimit përfshirës</i>	
Puna dhe punësimi	
Kapaciteti ligjor dhe vendim-marrja e mbështetur	

Kapitulli 7: Krijimi i institucioneve kombëtare për zbatimin dhe monitorimin e Konventës.....

Pikat e kontaktit	
--------------------------------	--

Mekanizmat e koordinimit

Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut

Lidhja mes Konventës dhe institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut

Tipet e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut

Parimet e Parisit

Funksionet potenciale të një institucioni kombëtar të të drejtave të njeriut

Institucionet kombëtare dhe mekanizmat e ankimit

Krijimi i një institucioni të përshtatshëm

Mbikqyrja parlamentare

Komisionet parlamentare

Komisionet hetimore

Pyetjet direkte për ministrat

Shqyrtimi i emërimeve në ekzekutiv

Mbikqyrja e agjencive jo-qeveritare publike

Shqyrtimi buxhetor dhe kontrolli financiar

Gjykatat dhe roli i gjyqësorit

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Referencat

Aneksi I: Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar

Aneksi II: Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

KAPITULLI NJË

Pamje e Përgjithshme

Kuptimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar: arsyet detyruese

Më shumë se 650 milionë njerëz në botë jetojnë me aftësi të kufizuar. Nëse i shtojmë kësaj shifre edhe familjet e tyre, atherë një numër marramendës prej dy miliardë njerëzish jetojnë çdo ditë me aftësi të kufizuara. Në çdo zonë të botës, në çdo vend të botës, personat me aftësi të kufizuar shpesh jetojnë të marginalizuar brenda shoqërisë, duke mos pasur akses tek disa prej eksperimenteve më themelore të jetës. Ata kanë pak shpresë për të shkuar në shkollë, për të gjetur një punë, për të pasur shtëpinë e tyre, për të krijuar familjen e tyre dhe për të pasur fëmijët e tyre, për të shijuar një jetë sociale apo për të votuar. Për shumicën dërrmuese të personave me aftësi të kufizuar nëpër botë, dyqanet, lehtësirat publike dhe ato të transportit, por edhe informacioni, janë përgjithësisht shumë të vështira për t'u aksesuar.

Personat me aftësi të kufizuar përbëjnë minoritetin më të madh e më të pafavorizuar. Shifrat janë drithëruese: përafërsisht 20 përqind e njerëzve më të varfër në botë janë persona me aftësi të kufizuar; 98 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuar në vendet në zhvillim nuk shkojnë në shkollë; përafërsisht 30 përqind e fëmijëve të rrugës nëpër botë kanë aftësi të kufizuar; dhe shkalla e të diturit shkrim e këndim tek të rriturit me aftësi të kufizuar është vetëm 3 përqind – dhe, në disa vende, edhe në nivelin 1 përqind tek gratë me aftësi të kufizuar.

Teksa njerëzit e varfër janë në mënyrë domethënëse më të prirur për të pasur aftësi të kufizuara përgjatë jetës së tyre, aftësia e kufizuar mund gjithashtu të sjellë si pasojë varfërinë, duke qënë se personat me aftësi të kufizuar shpesh përballen me diskriminim dhe marginalizim. Aftësia e kufizuar shoqërohet me analfabetizmin, ushqimin e varfër, mungesën e aksesit ndaj ujit të pijshëm, shkallë të ulët të vaksinimit ndaj sëmundjeve, dhe kushte pune të pashëndetshme e të rrezikshme.

Teksa rritet popullsia e botës, po ashtu rritet edhe numri i personave me aftësi të kufizuara. Në vendet në zhvillim, kushtet e varfëra mjeksore gjatë shtatzanisë dhe lindjes, përhapja në rritje e sëmundjeve ngjitëse, fatkeqësitë natyrore, konfliktet e armatosura, shtimi i minave të tokës dhe armëve të zjarrit shkaktojnë plagosje, dëmtime dhe trauma afatgjata në masë. Vetëm aksidentet me makinë shkaktojnë miliona plagosje dhe njerëz

“Në komunitetet tona, aftësia e kufizuar shikohet si një çështje bamirësie. Ti nuk shihesh si një person që mund të ketë një jetë, të ketë një punë, të jetojë në mënyrë të pavarur. Kjo është tërësisht kundër të drejtave tona njerëzore. Është shumë e nevojshme që të bëhet një punë sensibilizuese në vendet tona.”

Maria Veronica Reina, studiuese me aftësi të kufizuara në lëvizje (Argjentinë)

gjë pasi shoqëria ka hequr barrierat fizike dhe kulturore të cilat më përpara pengonin pjesmarrjen e tyre të plotë në jetën e vendit.

Këto ishin përparimet që u mbajtën parasysht teksa komuniteti ndërkombëtar u bashkua për të riafirmuar dinjitetin dhe vlerën e çdo personi me aftësi të kufizuara, dhe për t'i ofruar Shteteve një mjet efektiv ligjor për t'i dhënë fund padrejtësisë, diskriminimit dhe dhunimit të të drejtave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Ky mjet është Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Fokusi i Konventës

Termi “persona me aftësi të kufizuara” aplikohet për të gjithë ata persona të cilët kanë aftësi të kufizuara afatgjatë fizike, mendore, intelektuale apo ndijimore të cilat, duke patur parasysht sjelljet e ndryshme negative apo pengesat fizike, mund t'i ndalojnë këta persona nga pjesmarrja e plotë në shoqëri. Sidoqoftë, ky nuk është një përkufizim i cili përfshin të gjithë ata persona të cilët mund të pretendojnë mbrojtje prej kësaj Konvente; po ashtu, ky përkufizim nuk përjashton kategoritë edhe më të gjera të personave me aftësi të kufizuara të cilat specifikohen në legjislacionet kombëtare, duke përfshirë këtu personat me aftësi të kufizuara afatshkurtër apo personat që kanë pasur aftësi të kufizuara në të shkuarën.

Statistika për tu mbajtur në vëmendje

- ▶ Përafërsisht 10 përqind e popullatës së botës jeton me një aftësi të kufizuar - minoriteti më i madh në botë. Ky numër është në rritje për shkak të rritjes së popullsisë, avancimeve në fushën e mjeksisë dhe në procesin e plakjes. (OBSH/WHO)
- ▶ Përlllogaritet se rreth 20 përqind e njerëzve më të varfër në botë kanë një aftësi të kufizuar dhe tentojnë që të konsiderohen prej vetë komuniteteve të tyre si personat më shumë të paavantazuar. (Banka Botërore/World Bank)
- ▶ Përqindjet e aftësive të kufizuara janë në mënyrë domethënëse më të larta tek grupet me shkallë të ulët edukimi në vendet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Mesatarisht, 19 përqind e njerëzve më pak të arsimuar kanë aftësi të kufizuar, krahasuar me 11 përqind mes njerëzve më mirë të arsimuar. (OECD)
- ▶ Shkalla e vdekshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuar mund të jetë në nivelin 80 përqind në vendet ku vdekshmëria nën moshën 5 vjeç, në tërësi, është ulur poshtë nivelit të 20 përqindshit. Në disa raste, duket sikur fëmijët me aftësi të kufizuar po “zhduken”. (Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar, Mbretëria e Bashkuar)

Një person me aftësi të kufizuara mund të konsiderohet si i tillë në një shoqëri apo rrethanë të caktuara, por jo në një tjetër. Në shumicën e botës, ekzistojnë stereotipe negative dhe paragjykimet e thella e të vazhdueshme përkundrejt personave që kanë gjendje apo ndryshime të caktuara. Këto qëndrime përcaktojnë se kush konsiderohet si një person me aftësi të kufizuar dhe përforcojnë edhe më tepër imazhin negativ të personave me aftësi të kufizuar. Gjuha e përdorur për t’iu referuar personave me aftësi të kufizuar luan një rol domethënës në krijimin dhe mbajtjen e këtyre stereotipeve negative.

Terma si “sakat” apo “mendërisht i vonuar” janë dukshëm përbuzës e përlulës. Të tjerë, si për shembull, “i mbërthyer në karrige me rrota”, vendosin theksin tek aftësi e kufizuar e jo tek personi. Historikisht, shoqëria shpesh ka dështuar në përdorimin e termave të cilat përdoren nga vetë personat me aftësi të kufizuar për

“Për njerëzit e lindur me një aftësi të kufizuar, ashtu si unë, shpesh familja ka një pritshmëri shumë të vogël prej tyre, kjo është e para, e kështu pritshmëritë janë të ulta; e dyta, barrierat fizike në komunitetin tonë mund t’i pengojnë ata që të kenë akses tek komuniteti; dhe e treta, barrierat shoqërore mund t’i pengojnë ata që të kenë akses tek komuniteti i tyre.”

Linda Mastandrea, Atlete Paralimpike dhe avokate për çështjet e aftësisë së kufizuar (SHBA)

Aftësia e Kufizuar i ka rrënjët në shoqëri, jo tek personi

Një person me karrige me rrota mund të hasë në vështirësi për t'u punësuar ashtu siç duhet, kjo jo për shkak të kushteve të tij/saj, por sepse ekzistojnë barrierat mjedisore, si për shembull autobuzë të paaksesueshëm apo shkallë në vendin e punës, të cilat nuk i mundësojnë atij/asaj aksesin atje.

Një fëmijë me aftësi të kufizuar intelektuale mund të ketë vështirësi në shkollë për shkak të sjelljes e qëndrimit të mësuesve ndaj tij/saj, mungesës së kurrikulave të përshtatshme dhe materialeve mësimore, bordeve drejtuese të shkollave që nuk janë fleksibël, dhe prindërve të cilën janë të paaftë të adaptohen me nxënës që kanë aftësi të ndryshme mësimore.

Në një shoqëri ku lentet korrektuese janë të gjetshme prej një personi me miopi ekstreme (vështirësia për të parë nga afër), ky person nuk do të konsiderohej sikur kishte një aftësi të kufizuar.

Por dikush tjetër, me të njëjtat kushte, në një shoqëri ku lentet korrektive nuk janë të gjetshme lehtësisht do të konsiderohej se ishte me aftësi të kufizuar, veçanërisht në rastin kur ky person do e kishte të pamundur të kryente detyrat që priteshin prej tij/saj, si për shembull ruajtja e dhenve, qepja e rrobave apo blegtoaria.

të përshkruar vetveten ose i ka detyruar këta individë që ta përshkruanin veten me terma me të cilat ata nuk ndihen rehat.

Krijuesit e kësaj Konventë ishin të qartë për faktin se aftësi e kufizuar duhet parë si një rezultat i ndërveprimit mes personit dhe mjedisit rreth tij/saj, e që paaftësia nuk është diçka që mbetet brenda individit si pasojë e ndonjë dëmtimi. Kjo Konventë njeh faktin se aftësi e kufizuar është një koncept në evolucion dhe që legjislacioni mund të adaptohet në mënyrë që të reflektojë ndryshimet pozitive brenda shoqërisë.

Përse nevojitej një konventë

Personat me aftësi të kufizuar akoma vazhdojnë të shihen më së shumti si “objekte” të ndihmës sociale apo trajtimeve mjeksore sesa si “mbartës” të të drejtave të tyre. Vendimi për të shtuar një instrument universal të të drejtave të njeriut veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar lindi si pasojë e faktit se, pavarësisht se teorikisht ato i përkisnin të gjitha qenieve njerëzore, personave me aftësi të kufizuar vazhdojnë, në praktikë, t’iu mohohen ato të drejta bazë dhe liri themelore që merren si të mirëqena prej shumicës së njerëzve. Në thelbin e saj, Konventa siguron se personat me aftësi të kufizuar gëzojnë të njëjtat të drejta të njeriut si kushdo tjetër dhe janë të aftë të jetojnë jetën e tyre si qytetarë të denjë të cilët mund të ofrojnë kontribute të vlefshme për shoqërinë nëse u jepen të njëjtat mundësi si të tjerët.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollin Opsional i saj, adoptuar prej Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 13 Dhjetor 2006, janë shtesa më e fundit në trupin e instrumentave themelore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (shiko kapitullin 2). Që prej adoptimit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, Qeveritë, nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, kanë negociuar dhe kanë rënë dakort në lidhje me disa traktate ndërkombëtare të cilat përkufizojnë të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe shoqërore të cilat aplikohen për të gjitha qeniet njerëzore. Këto traktate krijojnë parimet themelore dhe parashikimet ligjore të dizenuara për të mbrojtur dhe promovuar këto të drejta.

Të drejtat e specifikuar në konventë

Konventa është një plotësues i traktateve ekzistuese për të drejtat e njeriut. Ajo nuk njeh të drejta të reja për personat me aftësi të kufizuar, por vetëm qartëson detyrimet dhe detyrat ligjore të Shteteve për të respektuar dhe siguruar gëzimin e barabartë të të gjitha të drejtave prej personave me aftësi të kufizuar. Konventa identifikon hapësira ku do duhet të kryhen adaptime në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe hapësira ku mbrojtja e të drejtave të tyre duhet forcuar pasi këto të drejta dhunohen në vazhdimësi. Ajo gjithashtu krijon standarte minimale universale të cilat duhet të aplikohen për këdo dhe të cilat ofrojnë një bazë për një kornizë koherente veprimi.

Sipas parashikimeve të Konventës, Shtetet janë të detyruara të konsultohen me personat me aftësi të kufizuar, përmes organizatave të tyre përfaqësuese, ndërsa zhvillojnë dhe zbatojnë legjislacionin dhe politikat me synim bërjen efektive të Konventës, dhe në lidhje me të gjitha çështjet e tjera të politikave të cilat do të ndikojnë jetët e personave me aftësi të kufizuar.

Personave me aftësi të kufizuara u mohohen sistematikisht këto të drejta bazë:

- ▶ Edukimi
- ▶ Lëvizja e lirë
- ▶ Jetesa e pavarur në komunitet
- ▶ Punësimi, edhe kur personi është i mirëkualifikuar
- ▶ Akses në informacioni
- ▶ Kujdes shëndetësor i përshtatshëm
- ▶ Ushtrimi i të drejtave politike sic është e drejta e votës
- ▶ Marrja e vendimeve nga vetë ata

Në Samitin e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara në Shtator 2000, Kryetarët e Shteteve dhe Qeveritë ranë dakord të punojnë për arritjen e këtyre objektivave:

OBJEKTIVI 1 Zhdukja e varfërisë ekstreme dhe e urisë

▣ Varfëria si shkak i aftësisë së kufizuar: më tepër se 50 përqind e aftësive të kufizuara janë të parandalueshme dhe drejtpërsëdrejti të lidhura me varfërinë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për aftësitë e kufizuara të cilat burojnë prej keqshqyerjes, ushqimit të keq të nënave shtatzëna dhe sëmundjeve ngjitëse.

▣ Aftësia e kufizuar si një faktor rreziku për varfërinë: më tepër se 85 përqind e personave me aftësi të kufizuar jetojnë në varfëri.

OBJEKTIVI 2 Arritja e edukimit parësor në shkallë universale

▣ Përafërsisht 98 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuara në vendet në zhvillim nuk shkojnë në shkollë.

OBJEKTIVI 3 Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave

▣ Është një fakt i pranuar gjithandej që gratë me aftësi të kufizuara janë dy herë të pafavorizuara në shoqëri: ato janë të përjashtuara nga aktivitete të ndryshme si për shkak të gjinisë së tyre ashtu edhe prej aftësisë së kufizuar.

▣ Gratë me aftësi të kufizuar kanë dy herë ose tre herë më tepër gjasa që të jenë viktimat e dhunës apo abuzimit seksual sesa gratë të cilat nuk kanë aftësi të kufizuara.

OBJEKTIVI 4 Reduktimi i vdekshmërisë foshnjore

▣ Përqindjet e vdekshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuara mund të jenë deri edhe në nivelin e 80 përqind në disa vende, madje edhe në ato vende ku përqindjet e vdekshmërisë mes fëmijëve pa aftësi të kufizuara janë poshtë nivelit të 20 përqind.

Objektivi 5 Përmirësimi i shëndetit të grave shtatzëna

▣ Përafërsisht 20 milion gra rezultojnë me aftësi të kufizuara çdo vit si rezultat i komplikacioneve gjatë shtatzënisë apo procesit të lindjes.

▣ Ngjarjet anormale para-lindjes janë një shkak kryesor i aftësive të kufizuara tek fëmijët në vendet në zhvillim. Të tilla aftësi të kufizuara mund të parandalohen.

OBJEKTIVI 6 Lufta ndaj HIV/AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera

▣ Personat me aftësi të kufizuar janë veçanërisht të prekshëm prej HIV/AIDS por përgjithësisht u mungojnë shërbimet e nevojshme dhe aksesit tek informacioni mbi parandalimin apo mjekimin.

▣ Një në çdo 10 fëmijë vuan nga një dëmtim neurologjik, duke përfshirë këtu vështirësitë në të mësuar, dhe humbje e koordinimit dhe epilepsi, si pasojë e malaries.

OBJEKTIVI 7 Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit

▣ Cilësia e varfër e mjedisit përbën një shkak domethënës për një shëndet të keq dhe aftësi të kufizuar

▣ Trachoma është arsyeja kryesore e verbërisë së parandalueshme, dhe mund të parandalohet përmes aksesit ndaj ujit të pastër të pijshëm.

OBJEKTIVI 8 Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim

▣ Shumica e personave me aftësi të kufizuara nuk kanë akses tek teknologjitë e reja, veçanërisht tek teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (ICT). Shumica e faqeve të internetit janë të paaksesueshme dhe teknologjia ndihmëse është tepër e shtrenjtë.

Marrëdhënia mes aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit

Pasi një vend ka ratifikuar Konventën, detyrimet e krijuara prej Konventës duhet të reflektohen brenda kuadrit ligjor të Shtetit, planifikimit zhvillimor dhe buxhetimit, si dhe politikave të ndërlidhura me to. Konventa vendos theksin tek hapat konkretë, pragmatistë, që Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin për të mbështetur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në të gjitha hapësirat e zhvillimit (shiko kapitullin 5).

Konventa gjithashtu njih rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar të zhvillimit për të mbështetur përpjekjet e zbatimit në nivel kombëtar. Për herë të parë, Konventa e zhvendos theksin prej krijimit të programeve të specializuara për personat me aftësi të kufizuar, si për shembull rehabilitimi, drejt kërkesës që të gjitha programet zhvillimore,

LISTË PËR PARLAMENTARËT

Përse duhet të jem i interesuar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar:

- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar duhet të promovohen për të njëjtat arsye që promovohen të drejtat e njeriut për të gjithë njerëzit e tjerë: për shkak të dinjitetit të tyre të qenësishëm dhe të barabartë dhe për shkak të vlerës së çdo qenieje njerëzore.
- Në shumicën e vendeve, personat me aftësi të kufizuar e kanë të vështirë të shkojnë në shkollë, të gjejnë një punë apo të marrin kujdes shëndetësor.
- E vetmja mënyrë për t'u siguruar që personat me aftësi të kufizuar të mund të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre njerëzore është të garantosh këto të drejta sipas ligjit kombëtar, ta mbështetësh këtë legjislacion me veprime të vazhdueshme, të koordinuara dhe konsistente nga të gjitha ministrinë, dhe të sigurosh që institucionet ligjore bëjnë të mundur respektimin e këtyre të drejtave.
- Margjinalizimi i personave me aftësi të kufizuar dhe inkurajimi i tyre për të mbetur të varur është i kushtueshëm, si për familjet e tyre ashtu si dhe për publikun e gjerë. Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar për të jetuar të pavarur dhe për të kontribuar në shoqëri sjell përfitime sociale dhe ekonomike.
- Gjithkush ka gjasa që të preket prej një aftësie të kufizuar në ndonjë pikë të jetës së tij/saj për shkak të një sëmundjeje, një aksidenti apo për shkak të plakjes.
- Personat me aftësi të kufizuar janë votues, taksapagues dhe qytetarë si kushdo tjetër. Ata presin mbështetjen tuaj dhe kanë të drejtë ta kenë këtë mbështetje.



duke përfshirë edhe ato që mbështeten përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, të përfshijnë dhe të jenë të aksesueshme prej personave me aftësi të kufizuar. Dhe në të gjitha rastet, organizatat e personave me aftësi të kufizuar duhet të marrin pjesë në formulimin e këtyre programeve zhvillimore.

Nevoja për të përfshirë personat me aftësi të kufizuar në rrymat zhvillimore të botës është e qartë, veçanërisht sa i përket Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Pa pjesëmarrjen e tyre, do të ishte e pamundur që të përgjysmohej varfëria dhe niveli i urisë brenda vitit 2015, ashtu siç është parashikuar tek Objektiv i Zhvillimit të Mijëvjeçarit numër 1 (shiko kutinë në faqen 16). Po ashtu, e drejta për edukim parësor universal e pa pagesë për çdo fëmijë (Objektiv i Zhvillimit të Mijëvjeçarit numër 2) nuk do të arrihet për sa kohë që 98 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuar në vendet në zhvillim nuk ndjekin shkollën.

KAPITULLI DY

Konventa në detaje

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar nuk është instrumenti i parë i të drejtave të njeriut që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Sidoqoftë, ndryshe nga paraardhësit e saj, ajo i ofron personave me aftësi të kufizuar një nivel të paprecedentë mbrojtjeje. Konventa detajon të drejtat që të gjithë personat me aftësi të kufizuar duhet të gëzojnë, dhe detyrimet e Shteteve dhe aktorëve të tjerë në mënyrë që këto të drejta të respektohen.

Zhvillimet historike të cilat çuan drejt konventës së re

Kombet e Bashkuara e adresuan çështjen e të drejtave të njeriut dhe aftësisë së kufizuar disa herë përpara se të negocionin dhe të adoptonin këtë Konventë. Në vitin 1982, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi Programin Botëror të Veprimit në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuar, i cili promovonte pjesëmarrjen e plotë dhe barazinë e personave me aftësi të kufizuar në jetën sociale dhe në zhvillim në të gjitha vendet, pavarësisht nivelit të tyre të zhvillimit¹. Asambleja e Përgjithshme shpalli dekadën prej vitit 1983 në vitin 1992 si “Dekada e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuar” dhe inkurajoi Vendet Anëtare që të zbatonin Programin Botëror të Veprimit në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuar përgjatë kësaj periudhe².

Gjatë rishikimit të parë ndërkombëtar në lidhje me zbatimin e Programit Botëror të Veprimit në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuar, të mbajtur në Stokholm në vitin 1987, pjesëmarrësit rekomanduan përgatitjen e një konvente mbi të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuar. Me gjithë nismat e

¹ Shiko objektivat e shpalosur në Programin Botror për Veprim të adoptuar prej rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme nr. 37/52 më 3 Dhjetor 1982.

² Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr. 37/53 më 3 Dhjetor 1982.

Pararendësit kryesorë të Konventës

Legjislacioni Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut:

- ▶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- ▶ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore
- ▶ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike

Të tjera instrumenta të Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Botërore të Punës (ILO) që merren specifikisht me të drejtat e njeriut dhe aftësinë e kufizuar:

- ▶ Deklarata e të Drejtave të Personave me Zhvillim të Vonuar Mendorr (1971)
- ▶ Deklarata e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (1975)
- ▶ Programi Botëror i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (1982)
- ▶ Udhëzimet e Talinit për Veprim në lidhje me Zhvillimin e Burimeve Njerëzore në Fushën e Aftësisë së Kufizuar (1990)
- ▶ Parimet për Mbrojtjen e Personave me Sëmundje Mendore dhe për Përmirësimin e Kujdesit të Shëndetit Mendor (1991)
- ▶ Rregullat Standarte për Barazinë e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuar (1993)

ndryshme, duke përfshirë këtu propozimet e bëra prej Qeverive të Italisë dhe Suedisë, dhe Reporterit mbi Aftësinë e Kufizuar të Komisionit për Zhvillimin Social, si dhe lobimit të fortë nga ana e shoqërisë civile, propozimi nuk mori mjaftueshëm mbështetje sa për të shpënë tek negociimi i një traktati të ri.

Në vitin 1991, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi “Parimet për mbrojtjen e personave me sëmundje mendore dhe përmirësimin e kujdesit të shëndetit mendor,” të njohura edhe si Parimet MI (Sëmundjeve Mendore). Parimet MI krijuan dhe vendosën standartet dhe garancitë procedurale dhe ofruan mbrojtje kundër abuzimeve më serioze të të drejtave të njeriut që mund të ndodhin në rrethana institucionale, si për shembull shpërdorimi apo përdorimi i papërshtatshëm i dhunës fizike apo mbyllja e pavullnetshme, sterilizimi, kirurgjia e trurit, si dhe trajtime të tjera ndërhyrëse e të pakthyeshme në lidhje me aftësinë e kufizuar mendore. Ndërsa konsideroheshin tepër novatore për kohën, në ditët e sotme vlera e Parimeve MI është vënë në pikëpyetje.

Në vitin 1993, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi “Rregullat Standarte për Barazinë e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara (Rregullat Standarte). Rregullat standarte synonin që të siguronin se “vajzat, djemtë, burrat dhe gratë me aftësi të kufizuar, si anëtarë të shoqërive të tyre, mund të ushtrojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime si të tjerët,” dhe i kërkuan Shteteve që të hiqnin barrierat e pjesëmarrjes në shoqëri për personat me aftësi të kufizuar. Rregullat Stan-

darte u bënë instrumenti kryesor i Kombeve të Bashkuara që drejtonte veprimet e Vendeve anëtare në lidhje me të drejtat e njeriut dhe aftësinë e kufizuar, dhe përbënin një referencë të rëndësishme për identifikimin e detyrimeve të Shteteve sipas instrumentave ekzistuese të të drejtave të njeriut. Shumë vende e kanë bazuar legjislacionin e tyre kombëtar tek Rregullat Standarte. Ndonëse një Reporter Special monitoron zbatimin e Rregullave Standarte në nivelin kombëtar, Rregullat Standarte nuk janë ligjërisht detyruese dhe nuk mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar aq gjerësisht sa i mbron Konventa e re.

Instrumentat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e gjithkujt, përfshirë dhe ato të personave me aftësi të kufizuar.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike së bashku formojnë atë që quhet Legjislacioni Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut. Këto tre dokumenta së bashku njohin të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale të cilat janë të patjetërsueshme për çdo qenie njerëzore; e si rrjedhim, Legjislacioni Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut njih dhe mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, edhe pse këto persona nuk përmenden shprehimisht.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është traktati i parë i të drejtave të njeriut i cili shprehimisht ndalon diskriminimin ndaj fëmijëve në bazë të aftësive të kufizuara.

Rruga drejt një konvente të re

Dhjetor 2001 Qeveria e Meksikës i propozon Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të krijojë një komitet ad hoc për të marrë në konsideratë propozimet për një konventë ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe integrale për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuar.

Gusht 2002 Sesioni i parë i Komitetit Ad Hoc, në të cilin u diskutua mbi arsyetimin dhe logjikën e një konvente të re dhe mbi procedurat për pjesëmarrjen e shoqërisë civile.

25 Gusht 2006 Sesioni i tetë i Komitetit Ad Hoc, në të cilin u finalizuan negociatat mbi draftin e konventës dhe mbi një protokoll opsional veçan, si dhe u adoptuan tekstet e përkohshme (ad interim), në pritje të ndonjë rishikimi teknik.

13 Dhjetor 2006 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adopton me konsensus Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollin Opsional të saj.

30 Mars 2007 Konventa dhe Protokollin Opsional hapen për nënshkrim në Zyrat Qëndrore të Kombeve të Bashkuara në New York.

Gjithashtu ajo njeh të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuar për të gëzuar një jetë të përmbushur dhe për të pasur akses tek kujdesi i specializuar dhe asistenca në mënyrë që të arrijnë këtë qëllim.

Përpara adoptimit të Konventës së re, traktatet ekzistuese të të drejtave të njeriut nuk e kishin adresuar gjerësisht mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuar; dhe personat me aftësi të kufizuar nuk i kishin vlerësuar dhe përdorur në shkallën e duhur mekanizmat e ndryshme të mbrojtjes që parashikoheshin prej këtyre mekanizmave. Adoptimi i Konventës dhe krijimi i mekanizmave të rinj për mbrojtjen dhe monitorimin e të drejtave të njeriut duhet si rrjedhojë të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Shikim i shkurtër mbi Konventën

Qëllimi i Konventës

Neni 1 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar thotë se qëllimi i Konventës është “të promovojë, mbrojë dhe sigurojë gëzimin e plotë e të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut prej personave me aftësi të kufizuar dhe të promovojë respekt për dinjitetin e tyre të lindur.”

Fusha e veprimit të Konventës

Konventa promovon dhe mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në jetën e tyre ekonomike, sociale, politike, ligjore dhe kulturore. Ajo bën thirrje për një trajtim jo-diskriminues dhe barazi sa i përket aksesit tek drejtësia, trajtimin prej gjykatave dhe organeve policore dhe ndërmarrjen e detyrave administrative duke ofruar akomodimet e nevojshme dhe të arsyeshme, proceduriale dhe të përshtatshme me moshën, sa i përket edukimit, kujdesit shëndetësor, në vendin e punës, në jetën familjare, në aktivitetet kulturore dhe sportive, si dhe në pjesëmarrjen në jetën politike e publike. Konventa siguron që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të njihen përpara ligjit. Ajo gjithashtu ndalon torturën, shfrytëzimin, dhunën dhe abuzimin, dhe mbron jetën, lirinë dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuar, lirinë e tyre të lëvizjes dhe shprehjes, dhe respektin për jetën e tyre private.

Përkufizimi i aftësisë së kufizuar

Konventa nuk e përkufizon në mënyrë të shprehur termin “aftësi e kufizuar”; dhe në realitet, Preambula e Konventës e konsideron “aftësinë e kufizuar” si një koncept gjithmonë në evolucion (nënparagrafi (e)). Gjithashtu Konventa nuk jep një përkufizim për termin “person me aftësi të kufizuar”. Sidoqoftë, traktati thotë se ky term përfshin personat të cilët vuajnë nga një aftësi e kufizuar afatgjatë fizike, mendore, intelektuale, apo ndjesore e cila, duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme negative apo pengesat fizike, mund t’i pengojë këta persona për t’u përfshirë plotësisht në shoqëri (neni 1).

Njohja e faktit se “aftësia e kufizuar” është një koncept gjithmonë në evolucion është një shprehje e faktit se shoqëria dhe opinionet brenda shoqërisë nuk janë të qëndrueshme. Si rrjedhim, Konventa nuk imponon një pamje të ngurtë të “aftësisë së kufizuar”, por zgjedh të marrë një përfaqje dinamike e cila bën të mundur adaptimet me kalimin e kohës si dhe në përputhje me situata të ndryshme socio-ekonomike.

Përfaqja që Konventa merr në lidhje me aftësinë e kufizuar vendos theksin edhe tek impakti domethënës që barrierat e sjelljes dhe të ambjentit në shoqëri mund të kenë mbi gëzimin e të drejtave të njeriut nga personat me aftësi të kufizuar. Me fjalë të tjera, një person në karrige me rrota mund të ketë vështirësi në përdorimin e transportit publik apo në gjetjen e punës, kjo jo për shkak të gjendjes së tij/saj, por sepse ekzistojnë pengesa mjedisore, si për shembull, autobuza të paaksesueshëm apo shkallë në vendin e punës, të cilat e pengojnë që të ketë akses.

Në një mënyrë të ngjashme, një fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale mund të përballet me vështirësi në shkollë për shkak të sjelljes e qëndrimit që mësuesit mbajnë ndaj tij/saj, bordeve drejtuese të shkollave që janë jofleksibël dhe ndoshta edhe prej prindërve që janë të paaftë të adaptohen me studentët të cilët kanë kapacitete të ndryshme mësimore. E për këto arsye, është tepër e rëndësishme që të ndryshohen këto qëndrime dhe ambiente të cilat e bëjnë shumë të vështirë pjesëmarrjen e plotë në shoqëri të personave me aftësi të kufizuar.

Konventa më shumë tregon, sesa përkufizon, se cilët janë personat me aftësi të kufizuar. Personat me aftësi të kufizuar do të “përfshinin” ata persona të cilët kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo sensoriale; në fjalë të tjera, Konventa mbron të paktën këta individë. I përfshirë në brendi të këtij treguesi është edhe fakti se Shtetet mund të zgjerojnë gamën e personave të mbrojtur, për të përfshirë, për shembull, personat me aftësi të kufizuar afatshkurtër.

“Në këtë moment ne jemi duke nxjerrë një Ligj Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, i cili përfaqëson një legjislacion gjithëpërfshirës që do t’i ofrojë ‘dhëmbë’ ligjorë mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuar. Po ashtu, ne jemi duke krijuar një numër programesh dhe nismash për të përmirësuar kapacitetet në fushën e edukimit të personave me aftësi të kufizuar, pasi ne besojmë se në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të transformohen në një mënyrë të qëndrueshme, kjo gjë mund të arrihet përmes edukimit. E kështu ne jemi thellësisht krenarë që jemi vendi i parë që ka ratifikuar Konventën.”

Senator Floyd Emerson Morris, Ministër i Shtetit në Ministrinë e Punës dhe Shërbimeve Sociale (Xhamajka)

Mos-diskriminimi dhe barazia

Parimi i mos-diskriminimit është një gur themeli i ligjit për të drejtat e njeriut dhe një parim i përfshirë në të gjitha traktatet e tjera të të drejtave të njeriut. Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar përkufizohet në Konventë si “çdo lloj dallimi, përjashtimi apo kufizimi në bazë të aftësisë së kufizuar i cili ka qëllim apo sjell pasojën e pengesës apo eliminimit të njohjes, gëzimit apo ushtrimit, në një bazë të barabartë me të tjerët, të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile apo cilëndo fushë tjetër. Ajo përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë mohimin e akomodimit të arsyeshëm.”

Shtetet duhet ta ndalojnë diskriminimin si në ligj, si për shembull diskriminimin e trupëzuar në legjisllacion, ashtu edhe në praktikë, si për shembull në rastet kur diskriminimi ndodh në vendin e punës. Sidoqoftë, Shtetet mund të aplikojnë diskriminimin në favor të personave me aftësi të kufizuar kur kjo gjë është e nevojshme për të siguruar që personat me ose pa aftësi të kufizuar të kenë shanse të barabarta.

“Akomodimi i arsyeshëm” nënkupton ndërmarrjen, kur bëhet e nevojshme, të modifikimeve dhe rregullimeve të përshtatshme, të cilat nuk krijojnë një barrë jo-proporcionale apo të pabarabartë, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësi të gëzojnë të drejtat e tyre të njeriut dhe liritë themelore në mënyrë të barabartë me të tjerët (neni 2). Duke marrë parasysh këtë parim, një individ me aftësi të kufizuar mund të argumentojë se Shteti dhe, përmes Shtetit, aktorë të tjerë, duke përfshirë këtu sektorin privat, janë të detyruar të ndërmarrin hapa për të akomoduar situatën e veçantë të tij/saj, sa kohë që këto hapa nuk sjellin si pasojë një barrë të rëndë.

Për shembull, nëse një punonjës përfshihet në një aksident, brenda ose jashtë ambjenteve të punës, kjo sjell si pasojë një aftësi të kufizuar fizike që detyron punonjësin të përdorë një karrige me rrota në të ardhmen, atëherë punëmarrësi ka përgjegjësinë për të ndërtuar një platformë ngjitjeje, tualete të aksesueshme për karriget me rrota dhe korridorë të hapur, dhe të kryejë rregullime dhe modifikime të tjera në mënyrë që personi të mund të vazhdojë të punojë si një punonjës aktiv. Dështimi për të kryer të tilla akomodime mund t'i japë të drejtën punonjësit që të ngrejë padi për diskriminim përpara një organi gjyqësor ose quasi-gjyqësor.

Sidoqoftë, akomodimet që punëdhënësi duhet të ndërmarrë nuk janë të pafundme; ato duhet të jetë vetëm ‘të arsyeshme’. Prandaj, rikonfigurimet tepër të kushtueshme të vendit të punës nuk do të ishin të detyrueshme, veçanërisht nëse ndërmarrja në fjalë është shumë e vogël ose në rastin kur mjediset e saj nuk mund të modifikohen lehtësisht.

Të drejtat dhe parimet e rradhitura në Konventë

Parimet e përgjithshme

Parimet e përgjithshme i ofrojnë udhëheqje Shteteve dhe aktorëve të tjerë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës. Tetë parimet e përgjithshme janë:

- ▶ Respekti për dinjitetin e lindur, autonominë, përfshirë këtu edhe lirinë për të marrë vendime personale, dhe pavarësinë e individëve;
- ▶ Mos-diskriminimi;
- ▶ Pjesëmarrje dhe përfshirje e plotë dhe efektive në shoqëri;
- ▶ Respekt për të qenurit ndryshe dhe pranim për personat me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- ▶ Mundësi të barabarta;
- ▶ Aksesueshmëri;
- ▶ Barazi mes meshkujve dhe femrave; dhe
- ▶ Respekt për kapacitetet zhvillimore të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe për të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetet e tyre.

Të drejtat

Ndërsa të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe shoqërore të specifikuara në Konventë aplikohen për të gjitha qeniet njerëzore, Konventa fokusohet tek veprimet që Shtetet duhet të ndërmarrin për t'u siguruar që personat me aftësi të kufizuar i gëzojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa gjithashtu adreson të drejtat specifike të grave dhe fëmijëve, hapësirat në të cilat kërkohet veprimi i Shtetit, si për shembull mbledhja e të dhënave dhe rritja e ndërgjegjësimit, dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Të drejtat e paraqitura shprehimisht në Konventë janë:

- ▶ Barazia përpara ligjit pa diskriminim
- ▶ E drejta për jetën, lirinë dhe sigurinë e individit
- ▶ Njohje të barabartë përpara ligjit dhe kapacitet i njëjtë ligjor
- ▶ Liria prej torturës
- ▶ Liria prej shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit
- ▶ E drejta për respekt fizik dhe integritet mendor
- ▶ E drejta për lëvizje dhe kombësi
- ▶ E drejta për të jetuar në komunitet
- ▶ E drejta për t'u shprehur dhe për të pasur opinionet
- ▶ Respekti për jetën private
- ▶ Respekti për shtëpinë dhe familjen

- ▶ E drejta për edukim
- ▶ E drejta për shërbime shëndetësore
- ▶ E drejta për të punuar
- ▶ E drejta për një standart të përshtatshëm jetese
- ▶ E drejta për të marrë pjesë në jetën politike e publike
- ▶ E drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore

Konventa njih edhe faktin se disa njerëz përballen me diskriminim jo vetëm për shkak të aftësisë së kufizuar, por edhe në bazë gjinie, moshe, etniciteti dhe/ose të tjera arsye. Për këtë arsye, Konventa përfshin dy nene që i dedikohen individëve specifikë: grave me aftësi të kufizuar dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Konventa parashtrohet fusha të veçanta për veprimet e Shtetit. Krijimi i një të drejte nuk është domosdoshmërisht siguri që kjo e drejtë të përmbushet. Kjo është arsyeja se përse Konventa i detyron Shtetet anëtare që të ofrojnë ambjentet e përshtatshme që të bëjë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të mund të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Këto masa lidhen me:

- ▶ Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit – në mënyrë që personat me ose pa aftësi të kufizuar të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- ▶ Përshatshmërinë– e cila është themelore për gëzimin e të gjitha të drejtave dhe

Pjesëmarrja: parim dhe e drejtë

Parimi i pjesëmarrjes dhe përfshirjes synon të përfshijë personat me aftësi të kufizuar në shoqëri dhe në marrjen e vendimeve që do të ndikojnë tek ta, duke i inkurajuar ata që të jenë aktivë në jetët e tyre dhe brenda komuniteteve ku ata jetojnë. Përfshirja është një proces dykahesh: personat të cilat nuk kanë kufizim të aftësive duhet të jenë të hapur kundrejt pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar.

Konventa në mënyrë specifike njih të drejtën e pjesëmarrjes në jetën politike, si për shembull përmes votimit në zgjedhjet parlamentare, dhe atë të pjesëmarrjes në jetën kulturore, si për shembull përmes pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore, sportive apo të tjera aktivitete argëtuese. Sidoqoftë, realizimi i të drejtës për pjesëmarrje ndonjëherë kërkon veprime specifike nga ana e Shtetit. Për shembull, një person i verbër mund të ketë nevojë për material votimi në gjuhën Braille dhe po ashtu mund t'i nevojitet mbështetje personale tek kutia e votimit, në mënyrë që zgjedhja e tij/saj të jetë e qartë. Nëse një qendër votimi nuk ka një plan të pjerrët në hyrje apo është shumë larg banesës së tij/saj, një person me karrige me rrota mund ta ketë të vështirë të votojë, e për këtë arsye e drejta e tij për të marrë pjesë në jetën politike pengohet.

Barazia midis burrave dhe grave

Gratë me aftësi të kufizuar mund të përballen me diskriminimin në të paktën dy nivele: në diskriminimin me bazë gjinore dhe në diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar. Parimi i barazisë mes burrave dhe grave i kërkon Shteteve që të promovojnë barazinë mes burrave dhe grave dhe të luftojnë pabarazinë teksa zbatojnë parashikimet e Konventës. Neni 6 i Konventës specifikisht një faktin se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar bëhen subjekt i formave të shumëfishta të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin që vjen si pasojë e aftësisë së kufizuar, si pasojë e gjinisë, dhe ndonjëherë në të tjera baza diskriminuese. Barazia mes burrave dhe grave nuk është vetëm një parim drejtues i punës së të drejtave të njeriut të kryer nga Kombet e Bashkuara, por gjithashtu është një e drejtë në vetvete.

për të mundësuar jetesën e pavarur në komunitet;

- ▶ Situatat e rrezikut dhe emergjencat humanitare – një shkak për aftësinë e kufizuar që kërkon veprim specifik prej Shtetit për të siguruar mbrojtje;
- ▶ Aksesin tek drejtësia – e cila është thelbësore për personat me aftësi të kufizuar në mënyrë që ata të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre;
- ▶ Lëvizshmërinë personale – për të promovuar pavarësinë e personave me aftësi të kufizuar;
- ▶ Aftësimin dhe riaftësimin – për personat me aftësi të kufizuar prej lindjes, si dhe për njerëzit të cilët kanë vuajtur gjatë jetës një kufizim të aftësive, për t'i mundësuar këta persona që të arrijnë e që të mbajnë maksimumin e pavarësisë dhe aftësisë;

Përshatshmëria

Parimi i aksesueshmërisë synon të shpërbëjë barrierat të cilat pengojnë gëzimin e të drejtave prej personave me aftësi të kufizuar. Kjo ka lidhje jo vetëm me aksesin fizik në vende të caktuara, por edhe me aksesin ndaj informacionit, teknologjisë, si për shembull, Interneti, komunikacionet, si dhe jeta ekonomike dhe sociale. Ofrimi i platformave, i korridorëve dhe dyerve mjaftueshëm të gjera e të pabllokuara, vendosja e dorezave të përshtatshme të dyerve, vendosja e informacionit në gjuhën Braille dhe në formate të lehta për t'u lexuar, përdorimi i gjuhës së shenjave dhe përkthyesëve të gjuhës së shenjave, si dhe prania e asistencës dhe mbështetjes mund të sigurojnë që një person me aftësi të kufizuar të ketë akses tek vendi i punës, tek një ambient argëtimi, një kuti votimi, transporti, gjykata, etj. Pa akses ndaj informacionit apo pa mundësinë për të lëvizur lirisht, të drejtat e tjera të personave me aftësi të kufizuar gjithashtu kufizohen.

- █ Statistikat dhe mbledhjen e të dhënave – si një themel për formulimin dhe zbatimin e politikave për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar njihet botërisht si tepër i rëndësishëm për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar të mund të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre të njeriut. Konventa shprehimisht e njeh këtë lidhje, dhe i detyron Shtetet anëtare të bashkëpunojnë me të tjerë Shtete dhe/ose me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale të fushës si dhe me shoqërinë civile për:

- █ Të ngritur kapacitetet, duke përfshirë kapacitetet që ngrihen përmes shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit, eksperiencave, programeve të trajnimit si dhe praktikave më të mira;
- █ Programe kërkimore dhe për lehtësimin e aksesit tek njohuria shkencore; dhe
- █ Ndihmë teknike dhe ekonomike, duke përfshirë lehtësimin për përdorimin e teknologjive të aksesueshme dhe ndihmuese.

Duke përfshirë një nen të veçantë në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, Konventa nënvizon nevojën që të gjitha këto përpjekje, duke përfshirë programe ndërkombëtare të zhvillimit, të jenë të aksesueshme dhe përfshirëse për të gjithë personat me aftësi të kufizuar. Duke qënë se, në shumë vende, ekziston një përqindje më e lartë e personave me aftësi të kufizuar që jetojnë në varfëri më tepër sesa në shtesa të tjera të shoqërisë, dështimi për të përfshirë personat me aftësi të kufizuar në planifikimin dhe zbatimin e programeve zhvillimore thjesht do të rriste edhe më tepër pabarazitë ekzistuese si dhe diskriminimin brenda shoqërisë.

Konventa afirmon faktin se nuk janë vetëm Shtetet anëtare që kanë një rol për të luajtur në shpënie përpara të bashkëpunimit ndërkombëtar për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, por edhe shoqëria civile, duke përfshirë organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar, si dhe organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, si për shembull agjensitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, Banka Botërore dhe të tjera banka të zhvillimit, si dhe organizatat rajonale, si për shembull Komisioni Evropian dhe Unioni Afrikan, kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm për të luajtur.

Detyrimet e Shteteve anëtare sipas Konventës

Ashtu siç afirmohet në nenin 4 të Konventës, një Qeveri e cila ratifikon Konventën angazhohet të promovojë dhe të sigurojë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa asnjë lloj diskriminimi. Kutia e mëposhtme detajon veprimet konkrete që Shtetet duhet të ndërmarin në mënyrë që të përmbushin detyrimet e tyre.

Veprime që duhen ndërmarrë nga Shtetet Anëtare

- ▶ Shtetet duhet të adoptojnë legjislacion dhe masa administrative për të promovuar të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara.
- ▶ Shtetet duhet të adoptojnë masa legjislative apo masa të tjera për të ndaluar diskriminimin.
- ▶ Shtetet duhet të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha politikat dhe programet.
- ▶ Shtetet duhet të ndalojnë çfarëdolloj praktike që dhunon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- ▶ Shtetet duhet të sigurohen që sektori publik respekton të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- ▶ Shtetet duhet të sigurohen që sektori privat dhe individët të respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- ▶ Shtetet duhet të ndërmarrin kërkim dhe zhvillim të të mirave, shërbimeve dhe teknologjive të aksesueshme prej personave me aftësi të kufizuara dhe të inkurajojnë shtetet e tjera që të ndërmarrin të tilla kërkime.
- ▶ Shtetet duhet të ofrojnë informacion të aksesueshëm në lidhje me teknologjinë ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara.
- ▶ Shtetet duhet të promovojnë trajnimin në lidhje me të drejtat e parashikuara në Konventë për profesionistët dhe punonjësit të cilët punojnë me personat me aftësi të kufizuara.
- ▶ Shtetet duhet të konsultohen dhe të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave si dhe në proceset e vendim-marrjes të cilat kanë lidhje me ta.

Çdo Shtet duhet të ndërmarrë masa për të realizuar të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore në mënyrë progresive, duke përdorur sasinë më të madhe të mundshme të burimeve për t'ia arritur këtij qëllimi. Ky detyrim, që përgjithësisht quhet realizimi progresiv, njih faktin se shpesh nevojitet kohë për të realizuar shumë prej këtyre të drejtave në mënyrë të plotë, për shembull, kur duhet që të krijohen apo të përmirësohen sistemet e sigurimeve shoqërore apo të kujdesit shëndetësor. Teksa realizimi progresiv i jep Shteteve anëtare, veçanërisht vendeve në zhvillim, një lloj fleksibiliteti në lidhje me arritjen e objektivave të Konventës, kjo nuk i heq atyre detyrimin për t'i mbrojtur këto të drejta. Për shembull, një Shtet nuk duhet të nxjerrë jashtë shtëpisë me forcë një person me aftësi të kufizuara, nuk mund të heqë në mënyrë arbitrare mbrojtjen sociale, apo nuk mund të mos krijojë dhe respektojë një sistem të pagës minimale.

Ndryshe nga të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të drejtat civile dhe politike nuk janë subjekt i realizimit progresiv. Shtetet duhet t'i mbrojnë dhe t'i promovojnë këto të drejta në mënyrë të menjëhershme.

“Personalisht, si një grua me aftësi të kufizuar, ashtu si të tjera gra me aftësi të kufizuar në vende në zhvillim, ne vuajmë një diskriminim të trefishtë si pasojë e aftësisë sonë të kufizuar, si pasojë e gjinisë sonë, dhe si pasojë e varfërisë, e për këtë arsye kjo Konventë do të jetë shumë ndihmuese për të siguruar që ne të gëzojmë të drejtat tona në të njëjtën mënyrë që i gëzojnë njerëzit e tjerë.”

Venus Ilagan, Disabled Peoples' International (Filipine)

(shiko kutinë në faqen e mësipërme).

Shembujt se si këto detyrime mund të përmbushen në praktikë janë prezantuar në kutinë në faqen në vijim.

Krahasimi i Konventës me traktate të tjera të të drejtave të njeriut

Konventa plotëson kuadrin e traktateve të tjera të të drejtave të njeriut. Ajo nuk njeh të drejta të reja të njeriut për personat me aftësi të kufizuar, por qartëson detyrimet e Shteteve për të respektuar dhe siguruar gëzimin e barabartë të të drejtave të njeriut prej personave me aftësi të kufizuar.

Instrumentet ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut që janë adoptuar pas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike qartësojnë hapat që Shtetet duhet të ndërmarrin në mënyrë që të sigurojnë se këto të drejta respektohen edhe në situata të veçanta. Këto janë, për shembull, traktatet që në mënyrë specifike mbrojnë fëmijët apo punëtorët emigrantë dhe familjet e tyre, apo që ndalojnë

Detyrime për t'u respektuar, mbrojtur dhe përmbushur

Të përfshira në frymën e Konventës qëndrojnë tre detyra të veçanta për të gjitha Shtetet anëtare:

Detyrimi për të respektuar – Shtetet anëtare duhet të mos ndërhyjnë në gëzimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Për shembull, Shtetet nuk duhet të kryejnë eksperimente shkencore mbi personat me aftësi të kufizuar pa lejen e tyre, ose nuk duhet të përjashtojnë një person me aftësi të kufizuar nga shkolla si pasojë e aftësisë së tyre të kufizuar.

Detyrimi për të mbrojtur – Shtetet anëtare duhet të ndalojnë dhunimin e këtyre të drejtave prej palëve të treta.

Për shembull, Shtetet duhet t'i kërkojnë punëdhënësve privatë që të ofrojnë kushte pune të drejta dhe të favorshme për personat me aftësi të kufizuar, duke përfshirë ofrimin e akomodimit të arsyeshëm. Shtetet duhet të jenë të vëmendshëm që të mbrojnë personat me aftësi të kufizuar nga keqtrajtimet apo nga abuzimet.

Detyrimi për të përmbushur – Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin veprime të përshtatshme legjislative, administrative, buxhetore, gjyqësore si dhe veprime të tjera, për të përmbushur në mënyrë të plotë këto të drejta

Detyrime për t'u respektuar, mbrojtur dhe përmbushur: si mund të kthehen në veprime

Liria prej Torturës

Respektimi: Shtetet nuk duhet t'i bëjnë personat me aftësi të kufizuar subjekt të torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, jonjerëzore apo degraduese brenda burgjeve shtetërore.

Mbrojtja: Shtetet duhet të sigurohen që burgjet private apo institucionet psikiatrike të mos praktikojnë torturën apo praktika të ngjashme mbi personat me aftësi të kufizuar.

Përmbushja: Shtetet duhet të sigurohen se zyrtarët e burgjeve dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor të kenë marrë trajnimin dhe informacionin e duhur, në mënyrë që të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuar të respektohen.

E drejta për kujdes shëndetësor

Respektimi: autoritetet nuk duhet të kryejnë eksperimente mjeksore mbi një person me aftësi të kufizuar pa pranimin e lirë dhe të informuar prej tij/saj.

Mbrojtja: Qeveritë duhet të sigurohen që ofruesit privatë të shërbimeve shëndetësore të mos diskriminojnë apo të mos i mohojnë kujdes shëndetësor dikujt në bazë të aftësisë së kufizuar të tij/saj.

Përmbushja: Qeveritë duhet të rrisin nivelin e pranisë së kujdesit shëndetësor cilësor e të përballeshëm për personat me aftësi të kufizuar.

Liria e Shprehjes

Respektimi: Shtetet nuk duhet të pengojnë marrjen e informacionit ose nuk mund të ndalojnë një person me aftësi të kufizuar për të shprehur lirisht mendimet e tij/saj.

Mbrojtja: Shtetet duhet të mos lejojnë që entet private të ndalojnë personat me aftësi me kufizuar që të shprehin mendimet e tyre.

Përmbushja: Shtetet duhet të mundësojnë përdorimin e gjuhës së shenjave, gjuhës së thjeshtë, gjuhës Braille, si dhe komunikimit shpjegues dhe alternativ (AAC) në ndërveprimet zyrtare.

E Drejta për Edukim

Respektimi: autoritetet arsimore nuk duhet të përjashtojnë një student me aftësi të kufizuar prej mundësisë së edukimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

Mbrojtja: Shtetet duhet të sigurohen se shkollat private nuk diskriminojnë kundër një personi me aftësi të kufizuar në programet e tyre edukuese.

Përmbushja: Shtetet duhet të sigurohen se edukimi i nivelit dytësor pa pagesë të jetë në mënyrë progresive i aksesueshëm nga të gjithë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuar.

E Drejta për të Punuar

Respektimi: Shtetet duhet të respektojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të formuar sindikata.

Mbrojtja: Shtetet duhet të sigurohen që sektori privat të respektojë të drejtën e punës të personave me aftësi të kufizuar.

Përmbushja: Shtetet duhet të ofrojnë trajnime profesionale, me burimet që kanë, për personat me aftësi të kufizuar.

Njohja e barabartë përpara ligjit: Brendia e një parimi

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni. 16)

Gjithkush do të ketë të drejtën të njihet si një person përpara ligjit.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (neni. 12)

- 1** Shtetet Anëtare riafirmojnë faktin se personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën të njihen kudo si persona përpara ligjit.
- 2** Shtetet Anëtare do të njohin faktin se personat me aftësi të kufizuar gëzojnë kapacitet ligjor në një mënyrë të barabartë me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës.
- 3** Shtetet Anëtare do të ndërmarrin masa të përshatshme për t'i ofruar personave me aftësi të kufizuar mbështetjen që mund t'iu nevojitet për të ushtruar kapacitetin e tyre ligjor.
- 4** Shtetet Anëtare do të sigurohen se të gjitha masat të cilat lidhen me ushtrimin e kapaciteteve ligjore ofrojnë garanci të përshtatshme dhe efektive për të parandaluar abuzimet, në përputhje me ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Të tilla garanci do të sigurojnë se masat që lidhen me ushtrimin e kapacitetit ligjor respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit, nuk kanë konflikt interesi apo influencë të panevojshme, janë proporcionale dhe të krijuara në përputhje me rrethanat e personit, aplikohen për kohën më të shkurtër të mundshme, dhe janë subjekt i një rishikimi të rregullt prej një autoriteti kompetent, të pavarur dhe të paanshëm apo prej një trupi gjyqësor. Garancitë do të jenë në proporcion me nivelin që këto masa prekin të drejtat dhe interesat e personit.
- 5** Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Shtetet Anëtare do të ndër-marrin të gjitha masat e përshtatshme dhe efektive për të siguruar të drejtat e barabarta të personave me aftësi të kufizuar për të zotëruar apo trashëguar pronësi, për të kontrolluar çështjet e tyre financiare dhe për të pasur akses të barabartë tek kreditë bankare, huatë, dhe të tjera forma të kreditimit financiar, dhe do të sigurohen që personave me aftësi të kufizuar nuk u merret prona në mënyrë arbitrare.

torturën, apo që mbrojnë nga diskriminimi në bazë gjinie apo rrace. Konventa e re fokusohet tek hapat që Shtetet duhet të ndërmarrin në mënyrë që të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuar të respektohen.

Kutia sipër ilustron se si Konventa e re merr një të drejtë e cila u prezantua nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike – të drejtën për mbrojtje të barabartë përpara ligjit – dhe e zgjeron e përpunon atë, duke u fokusuar specifikisht tek personat me aftësi të kufizuar. E drejta për njohje të barabartë përpara ligjit është themelore, jo vetëm si e drejtë në vetvete, por si një para-kërkesë për gëzimin e plotë të të drejtave të tjera, duke qënë se vetëm me njohjen përpara ligjit të drejtat mund të mbrohen përpara gjykatave (e drejta për ankimim gjyqësor), dhe një individ mund të

lidhë kontrata (e drejta për të punuar, midis të tjerave), të blejë dhe të shesë pronë (e drejta për të zotëruar prona vetëm ashtu si dhe në bashkëpunim me të tjerët), dhe të martohet (e drejta për t'u martuar dhe për të ndërtuar një familje).

Personave me aftësi të kufizuar po ashtu shumë shpesh u është mohuar e drejta për njohje të barabartë përpara ligjit thjesht për shkak të ekzistencës së një aftësie të

LISTË PËR PARLAMENTARËT

Si mund të rris ndërgjegjësimin mbi parimet kryesore të Konventës:

- Të ngre në parlament çështje që kanë të bëjnë me Konventën.
Të rishikoj projektligjet për të vlerësuar përputhjen me Konventën.
- Të mbaj lidhje me grupet e shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e të drejtave të njeriut.
- Të diskutoj në lidhje me Konventën nëpër takime dhe gjatë vizitave në elektoratet vendore, në shkollat vendore, në takimet e partisë, etj.
- Të diskutoj në lidhje me Konventën në fjalime përpara publikut, veçanërisht në Ditën Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar (3 Dhjetor).
- Të organizoj takime me anëtarët e parlamentit për të diskutuar në lidhje me Konventën.
- Të organizoj intervista në televizion dhe radio në lidhje me Konventën.
- Të shkruaj artikuj në lidhje me Konventën në gazeta, revista, dhe publikime të tjera.
- Të kërkoj që Konventa të përkthehet në gjuhët kombëtare dhe të shpërndahej gjerësisht.
- Të kërkoj që Konventa të jetë e gjatshme në formate të aksesueshme.
- Të sigurohem që parlamenti respekton parashikimet e Konventës sa i përket anëtarëve të tij si dhe anëtarëve të personelit të cilët kanë aftësi të kufizuar.
- Të bëj thirrje dhe lobim për krijimin e një komisioni parlamentar për të drejtat e njeriut dhe aftësinë e kufizuar, i cili do të ketë rolin e monitorimit të Konventës, dhe të sigurohem që komisione të tjera parlamentare të konsiderojnë çështje të cilat lidhen me aftësinë e kufizuar.
- Të sigurohem që çdo Anëtar i Parlamentit të ketë një kopje të Konventës dhe të Protokollit Opsional.
- Të promovoj Konventën dhe Protokollin Opsional në punën time politike, veçanërisht tek elektorati im.
- Të mbaj dëgjesa parlamentare në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.



kufizuar. Disa persona me aftësi të kufizuar nuk janë regjistruar pasi kanë lindur dhe disa personave me aftësi të kufizuar u janë transferuar tërësisht kapacitetet juridike, në mënyrë të panevojshme, tek tutorët e tyre ligjorë, të cilët kanë abuzuar me të drejtat e këtyre personave. Për t'i dhënë zgjidhje kësaj situatë, Konventa shprehimisht përshkruan përmbajtjen e së drejtës si dhe hapat që Shtetet duhet të ndërmarrin për t'u siguruar se kjo e drejtë nuk është dhunuar.

KAPITULLI TRE

Monitorimi i Konventës dhe i Protokollit Opsional

Të gjithë traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut me fuqi ligjore kanë një komponent monitorues dhe kjo Konventë nuk bën përjashtim nga ky rregull. Ashtu si mekanizmat monitorues që gjenden në të tjera traktate të të drejtave të njeriut, procedura e parashtruar në këtë Konventë promovon dialogun konstruktiv me Shtetet për të siguruar se parashikimet e Konventës do të zbatohen në mënyrë të efektshme. Monitorimi gjithashtu nënkupton të drejtën e individëve për t'u ankuar dhe për të marrë mbrojtje ligjore. Mekanizmat e monitorimit rrisin përgjegjshmërinë dhe, në një nivel afatgjatë, forcojnë kapacitetin e Shteteve anëtare për të përmbushur angazhimet dhe detyrimet.

Mekanizmat monitorues në Konventë

Konventa ofron monitorim si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar:

Në nivel kombëtar, Shtetet anëtare duhet të emërojnë një ose më shumë pika kontakti brenda qeverisë për t'u marrë me çështje të cilat lidhen me zbatimin e Konventës. Shtetet anëtare gjithashtu duhet të konsiderojnë krijimin apo dizajnimin e një organi koordinimi brenda qeverisë për të lehtësuar zbatimin e Konventës. Në mënyrë të ngjashme, Shtetet anëtare duhet të mbajnë, forcojnë apo krijojnë një institucion të pavarur, si për shembull një institucion kombëtar të të drejtave të njeriut, për të promovuar, mbrojtur dhe monitoruar Konventën. (Më tepër informacion në lidhje me monitorimin në nivel kombëtar ofrohet në kapitullin 7.)

Në nivel ndërkombëtar, Konventa ofron monitorim përmes krijimit të një komisioni ekspertësh të pavarur, të quajtur Komisioni i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. Komisioni merr në konsideratë raportet e paraqitura në mënyrë periodike prej Shteteve Anëtare. Në bazë të këtyre raporteve,

Komisioni punon me Shtetet anëtare respektive dhe bën vëzhgime përfundimtare dhe rekomandime drejtuar këtyre Shteteve anëtare.

Protokolli Opsional i Konventës, nëse ratifikohet veçmas nga ana e një Shteti, e mundëson Komisionin që të ndër marrë dy forma shtesë monitorimi: një procedurë komunikimi individual, përmes së cilës Komisioni merr komunikime (ankimime) prej një individi i cili pretendon se Shteti dhunon të drejtat e tij/saj të parashikuara në Konventë; si dhe një procedurë hetimore, përmes së cilës Komisioni heton dhunime të rënda apo sistematike të Konventës dhe, përmes pranimit të Shtetit anëtar në fjalë, ndërmerr misione në terren për të thelluar hetimin.

Konventa gjithashtu bën fjalë për një Konferencë të Shteteve anëtare, e cila do të marrë në konsideratë çështjen e zbatimit të Konventës.

Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Konventa mandaton krijimin e një Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuar në momentin që Konventa hyn në fuqi. Ky Komision do të ekzaminojë raportimet periodike të paraqitura prej Shteteve anëtare, do të marrë në konsideratë komunikimet individuale, do të ndër marrë hetime, dhe do të formulojë vëzhgime të përgjithshme si dhe rekomandime.

Komisioni fillimisht do të përbëhet prej 12 ekspertëve të pavarur, ndonëse ky numër do të rritet në 18 pasi 60 Shtetet ta kenë ratifikuar Konventën. Një Konferencë e Shteteve anëtare do të kryejë zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit, të cilët do të shërbejnë në kapacitetin e tyre personal. Anëtarët e Komisionit do të zgjidhen në bazë të kompetencës së tyre dhe eksperiencës që kanë në fushën e të drejtave të njeriut dhe aftësive të kufizuar, dhe gjithashtu duke marrë parasysh përfaqësimin e përshtatshëm gjeografik, përfaqësimin e formave të ndryshme të civilizimit dhe sistemeve ligjore, të balancës gjinore, si dhe pjesëmarrjen e ekspertëve me aftësi të kufizuara brenda Komisionit.

Shtetet duhet të konsultohen dhe të përfshijnë personat me aftësi të kufizuar si dhe organizatat që i përfaqësojnë ata teksa zgjedhin individët që do të kandidohen për anëtarësim në Komision.

Raportimi periodik

Çdo Shtet anëtar në Konventë duhet të paraqesë përpara Komisionit një raport fillestar gjithpërfshirës mbi masat e marra në lidhje me zbatimin e Konventës. Çdo Shtet duhet të paraqesë raportin e vet fillestar brenda dy viteve pasi Konventa ka hyrë në fuqi në atë Shtet. Raporti fillestar duhet:

- ▣ Të krijojë kornizën kushtetuese, ligjore dhe administrative për zbatimin e Konventës;

- ▶ Të shpjegojë politikat dhe programet e adoptuar për të zbatuar secilin prej parashikimeve të Konventës; dhe
- ▶ Të identifikojë çfarëdo progresi të arritur në realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar si rezultat i ratifikimit dhe zbatimit të Konventës.

Çdo Shtet duhet të paraqesë raporte të mëpasshme të paktën çdo katër vjet ose kurdo që Komisioni kërkon që të paraqitet një i tillë. Raporti e mëpasshëm duhet:

- ▶ T'i përgjigjet shqetësimeve dhe çështjeve të tjera të vëna në dukje prej Komisionit në vëzhgimet e tija përfundimtare në raportet e mëparshme;
- ▶ Të tregojë progresin e bërë në realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar përgjatë periudhës së raportimit; dhe
- ▶ Të vërë në dukje çfarëdo pengesash me të cilat Qeveria dhe të tjerë aktorë mund të jenë përballur në punën e tyre për të zbatuar konventën përgjatë periudhës së raportimit.

Komisioni do të krijojë pika udhëzuese në lidhje me përmbajtjen e raporteve. Raportimet e para duhet të jenë gjithëpërfshirëse, në fjalë të tjera, ato duhet të mbulojnë zbatimin e të gjitha parashikimeve të bëra prej Konventës. Raportet e mëvonshme nuk është e nevojshme që të përsërisin informacionin që është ofruar më përpara. Shtetet anëtare duhet që të përgatisin raportet e tyre në një mënyrë të hapur e transparente dhe duhet të konsultohen e të përfshijnë në përgatitjen e tyre personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat që i përfaqësojnë ata.

Përgatitja e raporteve periodike:

- ▶ Inkurajon Qeveritë që të ndërmarrin një rishikim të zgjeruar e gjithëpërfshirës të legjislacionit kombëtar, politikave dhe programeve që lidhen me të drejtat e njeriut dhe aftësinë e kufizuar;
- ▶ Siguron që secili Shtet monitoron rregullisht realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar;
- ▶ Inkurajon Qeveritë që të vendosin prioritete dhe tregues kundrejt të cilëve ato mund të gjykojnë performancën e tyre;
- ▶ I ofron Qeverive një standart kundrejt të cilit mund të krahasohen raportet që do të vijnë në të ardhmen;
- ▶ Ofron një mundësi për diskutime publike si dhe analizë në detaje të performancës së Qeverisë; dhe
- ▶ Sjell në dukje vështirësitë në zbatim të cilat përndryshe do të kishin kaluar pa u vënë re.

Qëllimi i raportimit periodik

Raportimi periodik ofron një mënyrë për të promovuar zbatueshmërinë e Shteteve në lidhje me detyrimet që kanë sipas Konventës, si dhe një mjet që mundëson Qeverinë; institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe shoqërinë civile, që të vlerësojnë nivelin e respektimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në një vend specifik. Raportimi periodik përpara Komisionit:

- ▶ Ofron një instrument përmes së cilit Qeveritë, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe shoqëria civile mund të kuptojnë më mirë objektivat dhe të drejtat e përfshira në Konventë;
- ▶ Rrit ndërgjegjësimin në lidhje me Konventën si dhe në lidhje me situatën e personave me aftësi të kufizuara në një vend të caktuar;
- ▶ Mundëson që Qeveritë të përfitojnë prej ekspertizës së një komisioni të pavarur, ndërkombëtar në lidhje me mënyrën e përmirësimit të zbatimit të Konventës;
- ▶ Vë në dukje praktikatat dhe eksperiencat më të mira në vend;
- ▶ U mundëson Qeverive që të përfitojnë prej praktikave dhe eksperiencave më të mira të Qeverive të tjera, duke qënë se të gjitha raportet periodike dhe vëzhgimet përmblylëse të ndërmarra nga Komisioni janë dokumente publike;

Mbikqija parlamentare e raportit: Eksperiencia e Afrikës së Jugut

Komisioni dhe mekanizmat raportues të parashikuar në Konventë janë të ngjashëm me ato të parashikuara në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Parlamentet kanë mënyra të ndryshme për të mbikqyrur këto raporte. Për shembull, në Afrikën e Jugut, të gjitha raportet kombëtare duhet të debatohen në Parlament, dhe Parlamenti duhet të sigurohet që raportet të përmbajnë një larmi pikëpamjesh, duke përfshirë edhe pikëpamjet e shoqërisë civile. Është për këtë arsye që Parlamenti mban debate dhe dëgjesa të hapura, thërret ministrat për raportim dhe kërkon dokumenta dhe raporte prej një game të gjerë departamentesh si dhe grupimesh të qytetarëve. Në Afrikën e Jugut, Anëtarët e Parlamentit janë të përfshirë në delegacionet kombëtare të cilat marrin pjesë në punimet e Komisionit të CEDAW, duke u siguruar në këtë mënyrë që ata të kenë një perceptim e kuptim të mirë të rekomandimeve që dalin prej punimeve të Komisionit. Parlamenti gjithashtu luan një rol drejtues në procesin e të siguruarit që këto rekomandime të bëhen efektive në nivelin kombëtar.¹

¹ E cituar nga Parlamenti dhe Demokracia në Shekullin e Njëzetënjtë: Një Udhëzues për Praktikatat e Mira (Gjenevë, Unioni Ndër-Parlamentar, 2006).

Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve dhe të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve ka qënë organi më aktiv i një traktati të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe aftësisë së kufizuar. Ky Komision në mënyrë sistematike kërkon informacione prej Shteteve në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në vendet e tyre. Në Shtator të vitit 2006, Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve theksoi se fëmijët me aftësi të kufizuar janë akoma duke u përballur me vështirësi serioze në lidhje me gëzimin e plotë të të drejtave të rradhitura në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Komisioni vendosi theksin mbi faktin se pengesa për gëzimin e plotë nuk është aftësia e kufizuar në vetvete, por një kombinim i barrierave sociale, kulturore, fizike dhe të qëndrimeve me të cilat fëmijët me aftësi të kufizuar përballen çdo ditë. Komisioni ka ofruar udhëzime për Shtetet duke promovuar regjistrimin si dhe aksesin tek informacioni në lidhje me mjedisin familjar dhe kujdesin alternativ, kujdesin shëndetësor e social bazë, edukimin dhe argëtimin, drejtësinë për të miturit, dhe parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit.

- ▣ Ofron një udhëzim autoritar për Qeveritë, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe shoqërinë civile në lidhje me veprimet e të ardhmes, në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet; dhe
- ▣ Tregon fushat ku bashkëpunimi ndërkombëtar, veçanërisht përmes Kombeve të Bashkuara, mund të jetë i dëshirueshëm.

Vijimësia e raportimit periodik

Pasi Komisioni të ketë marrë në konsideratë raportin dhe të ketë formuluar vëzhgimet e veta përmbyllëse dhe rekomandimet, ai mund t'ia transmetojë gjetjet agjensive të ndryshme të specializuara, fondeve dhe programeve të Kombeve të Bashkuara, për vijimësinë në formën e bashkëpunimit teknik.

Ekzistojnë shumë agjensi të Kombeve të Bashkuara mandatet e të cilave përfshijnë aktivitete që kanë lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, si për shembull UNESCO, ILO, WHO, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), ashtu si dhe Banka Botërore. Duke angazhuar të lartpërmendurat si dhe të tjera organizata, Shtetet dhe Komisioni mund të ndihmojnë që të sigurohen se raportimi periodik çon tek përmirësimi i qëndrueshëm në lidhje me realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Konferenca e Shteteve Anëtare

Shtetet të cilat kanë ratifikuar Konventën do të takohen në mënyrë të rregullt në një Konferencë për Shtetet anëtare për të marrë në konsideratë çdo çështje e cila lidhet me zbatimin e Konventës. Takimi i parë i Konferencës së Shteteve do të ndodhë gjashtë muaj pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi. Konventa nuk jep detaje të hollësishme në lidhje me modalitetet dhe funksionet e Konferencës.

Mekanizma të tjerë për të monitoruar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Të gjitha traktatet e të drejtave të njeriut mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, që do të thotë se komisionet e pavarura të krijuara sipas traktateve të tjera të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut po ashtu luajnë një rol në monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar brenda fushës së mbulimit të secilit

LISTË PËR PARLAMENTARËT

Si mund të sigurohem që raportimi periodik të jetë efektiv:

Anëtarët e Parlamentit kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar që Qeveria të përmbushë detyrimet e veta raportuese sipas Konventës. Anëtarët e Parlamentit mund:

- Të sigurohen që Qeveria të përgatisë raportin fillestar si dhe ato të mëpasshme në kohën e duhur.
- Të ngulin këmbë që raportimet të krijohen përmes përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuar përmes dëgjësave dhe mekanizmash të tjerë konsultimi.
- Të kërkojnë shpjegime prej Qeverive kur raporti është me vonësë dhe, nëse është e nevojshme, të përdorin procedura parlamentare për të nxitur Qeverinë të përmbushë detyrimet e saj për raportimin.
- Të jenë aktivisht të përfshirë në përgatitjen e raporteve, si për shembull përmes qënies anëtar i një komisioni parlamentar që lidhet me çështjen.
- Të sigurohen që raportet përfshijnë brenda tyre masat e marra nga parlamenti në favor të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.
- Të këmbëngulin në lidhje me shpërndarjen e gjerë të vëzhgimeve përmbyllëse të Komisionit.
- Të inkurajojnë ministrinë e fushës për të zbatuar vëzhgimet përmbyllës të Komisionit.
- Të ngrënë pyetje për ministrat e fushës në parlament në kuadrin e vijimësisë në lidhje me pengesat domethënëse për zbatimin.
- Të bëjnë publike çështjet e ngritura prej vëzhgimeve përmbyllëse të Komisionit përmes debateve parlamentare si dhe debateve publike.



traktat specifkisht. Për shembull, Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka autoritet për të monitoruar të drejtat civile dhe politike të personave me aftësi të kufizuara në Shtetet të cilat janë anëtare të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve zotëron autoritetin për të monitoruar realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Protokolli Opsional i Konventës

Një protokoll opsional është një instrument ligjor i cili bashkëlidhet me një traktat ekzistues; një instrument i cili adreson çështje të cilat traktati në vetvete nuk i mbulon aspak ose nuk i mbulon mjaftueshëm. Ky instrument zakonisht, ndonëse jo gjithmonë, është i hapur për ratifikim ose anëtarësim vetëm prej Shteteve të cilat janë anëtare të vetë traktatit. Ai quhet ‘opsional’ në kuptimin që Shtetet nuk janë të detyruara që të bëhen pjesë e protokollit, edhe në rast se ato janë bërë anëtare të traktatit.

Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara prezanton dy procedura për të forcuar zbatimin e Konventës: një procedurë të komunikimeve individuale si dhe një procedurë hetimore.

Procedura e komunikimeve individuale

Procedura e komunikimeve individuale i mundëson individëve si dhe grupeve të individëve në një Shtet anëtar të Protokollit Opsional për t’u ankuar përpara Komisionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara sepse Shteti ka thyer një prej detyrimeve që mban sipas Konventës. Ankimimi është i njohur si “komunikim”. Komisioni më pas do të ekzaminojë ankimin, do të formulojë pikëpamjet dhe rekomandimet e tij, nëse ka të tilla, në lidhje me komunikimin, dhe do t’ia dërgojë ato Shtetit në fjalë. Këto pikëpamje dhe rekomandime dalin në raportin publik që Komisioni i dërgon Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Normalisht, procedurat e komunikimit individual janë procedura shkresore ose shkrimore, në fjalë të tjera, as ankimesi e as Shteti nuk paraqiten përpara Komisionit personalisht; të gjitha aplikimet bëhen në mënyrë të shkruar.

“Një protokoll opsional do të fuqizojë shumë qartësisht sistemin e sotëm të monitorimit të traktateve. Në mënyrë veçanërisht të rëndësishme, ai do të ndihmojë për të qartësuar atë që është - dhe atë që nuk është - e kërkuar prej Shteteve, ndërsa ofron zgjidhje efektive për individët që kanë vuajtur abuzime. Dhe në fund, shpresoj se një protokoll opsional do të jetë një hap përpara drejt shpërbërjes së kategorisë të së drejtave që janë papërshtatshëmrisht të ngurta dhe të bëjë përpara drejt një vizioni të unifikuar të të drejtave civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale.”

Louise Arbour, Komisionere e Lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

Jo të gjitha llojet e komunikimeve janë të pranueshme. Komisioni do të konsiderojë një komunikim si të papranueshëm kur:

- ▶ Komunikimi është anonim;
- ▶ Komunikimi është një abuzim apo është i papërputhshëm me parashikimet e Konventës;
- ▶ E njëjta ankesë është ekzaminuar një herë prej Komisionit;
- ▶ I njëjti ankimim është ekzaminuar ose është duke u ekzaminuar prej një procedure tjetër hetimi ndërkombëtar;
- ▶ Nuk janë përshkruar të gjitha shkallët e ankimit në nivel kombëtar;

Procedura e komunikimit individual

Procedura e komunikimit individual përbëhet prej hapave të mëposhtëm:

- ▶ Komisioni merr ankimimin.
- ▶ Komisioni merr në konsideratë pranueshmërinë e ankimit. Ndonjëherë, pranueshmëria e ankimit merret në konsideratë në të njëjtën kohë me përmbajtjen e ankimit, në fjalë të tjera, merret një vendim në lidhje me pranueshmërinë e ankesës (pranueshmëria) dhe po ashtu në të njëjtën kohë merret një vendim nëse Shteti ka thyer ose jo detyrimet e tij sipas Konventës (përmbajtja).
- ▶ Komisioni ia paraqet ankimimin Shtetit në mënyrë konfidenciale. Brenda gjashtë muajsh, Shteti prezanton sqarime në formë të shkruar ose deklarata të cilat ofrojnë sqarime për çështjen dhe tregojnë se çfarë hapash rregullues apo të tjerë hapa, nëse ka të tillë, janë marrë nga ana e Shtetit.
- ▶ Ankimuesit i ofrohet mundësia që të komentojë në lidhje me vëzhgimet e bëra prej Shtetit.
- ▶ Komisioni mund t'i kërkojë Shtetit që të ndërmarrë masa të ndërmjetme për të mbrojtur të drejtat e ankimuesit.
- ▶ Komisioni ekzaminon ankimimin në një sesion me dyer të mbyllura.
- ▶ Komisioni bën sugjerime dhe rekomandime, nëse ka të tilla, për Shtetin dhe ankimuesin, dhe shpesh i kërkon Shteteve që të ofrojnë informacion në lidhje me veprimet që ka marrë si rezultat i sugjerimeve dhe rekomandimeve.
- ▶ Komisioni bën publike sugjerimet dhe rekomandimet në raportin e tij.

Gjithmonë e më tepër, të tjera Komisione të cilat përmbajnë procedurën e komunikimit individual po i kërkojnë Shteteve që t'i raportojnë Komisioneve në lidhje me veprimet e ndërmarra në përgjigje të sygjërimeve dhe rekomandimeve të bëra prej tyre.

- ▣ Kërkesa është e pabazuar ose pamjaftueshmërisht e pabazuar;
- ▣ Faktet kanë ndodhur dhe kanë marrë fund përpara hyrjes në fuqi të Protokol- lit për Shtetin në fjalë.

Procedura hetimore

Nëse Komisioni merr informacion të besueshëm i cili tregon dhunime të rënda e sistematike të parashikimeve të Konventës nga një Shtet anëtar, Komisioni mund t'i bëjë ftesë Shtetit që të bashkëpunojë për ekzaminimin e informacionit duke ofruar vëzhgime. Pasi të ketë marrë në konsideratë vëzhgimet e Shtetit anëtar, dhe çfarëdo lloj informacioni tjetër të besueshëm, Komisioni mund të delegojë një ose më shumë anëtarë të tij për të ndërmarrë një hetim dhe për të nxjerrë një raport në mënyrë

Komisioni për të Drejtat e Njeriut merr në konsideratë komunikime individuale nga persona me aftësi të kufizuara

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, i cili monitoron përputhjen e Shteteve me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, tashmë ka marrë në konsideratë komunikime individuale në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara:

Në rastin Hamilton kundër Xhamajkës (1995), Komisioni për të Drejtat e Njeriut, mori në konsideratë trajtimin dhe kushtet e izolimit të një të burgosuri me aftësi të kufizuara i cili ndodhej në seksionin e burgut ku mbaheshin të dënuarit me vdekje. Ankimuesi ishte i paralizuar në të dyja këmbët dhe përballej me vështirësi shumë të madhe për t'u ngjitur në shtratin e tij. Komisioni për të Drejtat e Njeriut deklaroi se dështimi i autoriteteve të burgut për të marrë në konsideratë aftësinë e kufizuar të të burgosurit si dhe për të ndërmarrë arranzhimet e duhura për të përbërë një shkelje të së drejtës së tij për t'u trajtuar në mënyrë të njerëzishme dhe me respekt për dinjitetin e lindur të qenies njerëzore, e si rrjedhim binte në kundërshtim me nenin 10 (1) të Paktit. Në rastin e Clement Francis kundër Xhamajkës (1994), Komisioni për të Drejtat e Njeriut njohu faktin se dështimi i Shtetit për të ofruar shërbim në favor të shëndetit të përkeqësuar mendor të një të dënuari të dënuar me vdekje si dhe dështimi për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përmirësuar sëmundjen e tij psikiatrike përbënin një shkelje të të drejtave të viktimës sipas neneve 7 dhe 10 (1) të Paktit.

Në rastin C. kundër Australisë (1999), një azil-kërkues iranian ishte mbajtur në izolim prej autoriteteve australiane teksa ata po merrnin në konsideratë aplikimin e tij për azil. Komisioni për të Drejtat e Njeriut deklaroi se izolimi i vazhdueshëm i të ankimuarit, duke mos përmendur këtu edhe përkeqësimin e shëndetit të tij mendor, përbënte një dhunim të së drejtës së tij sipas nenit 7 të Paktit (ndalimi i torturës, si dhe trajtimit mizor, çnjerëzor dhe degradues). Komisioni për të Drejtat e Njeriut gjithashtu deklaroi se kthimi i aplikantit azil-kërkues mbrapsht në Republikën Islamike të Iranit, ku me shumë pak gjasa ai do të mund të merrte mjekimin e duhur si dhe trajtimet e nevojshme, përbënte një shkelje të nenit 7.

urgjente. Aty ku është e nevojshme, dhe me praninë e Shtetit të interesuar, kjo procedurë hetimi mund të përfshijë edhe një vizitë në vendin në fjalë. Pasi të ketë ekzaminuar gjetjet e hetimit, Komisioni duhet t'ia transmetojë këto gjetje, si dhe komentet e Komisionit, Shtetit në fjalë, i cili më pas ka gjashtë muaj kohë në dispozicion për të prezantuar vëzhgimet e veta përpara Komisionit. Hetimi është konfidencial dhe duhet të kryhet me bashkëpunimin e plotë të Shtetit të interesuar.

Pasi të ketë kaluar periudha gjashtë mujore përgjatë së cilës mund të prezantojë vëzhgimet e veta, Shtetit mund t'i kërkohej që të ofrojë detaje në lidhje me masat që ka marrë për t'iu përgjigjur hetimit. Komisioni mund të kërkojë informacione të mëtejshme prej Shtetit. Më pas Komisioni do të publikojë një përmbledhje të gjetjeve të tij në një raport për Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Me pëlqimin e Shtetit të interesuar, Komisioni gjithashtu mund të publikojë raportin e plotë të hetimit që ka ndërmarrë.

Një Shtet i cili ka ratifikuar Protokollin Opsional mund të kërkojë të “mbetet jashtë” procedurës hetimore. Në fjalë të tjera, në momentin që kryhet nënshkrimi, ratifikimi apo aksesimi në Protokollin Opsional, Shteti mund të deklarojë se ai nuk njeh kompetencën e Komisionit për të ndërmarrë procedurën hetimore. Sidoqoftë, edhe në rastin kur një Shtet zgjedh të “mbetet jashtë” procedurës hetimore, sipas Konventës të gjitha Shtetet anëtarë në Protokollin Opsional duhet të pranojnë procedurën e komunikimit individual.

Shumica e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përfshijnë brenda tyre procedura opsionale të komunikimit; disa prej tyre kanë gjithashtu në brendi procedura hetimore. Të gjitha këto procedura kanë një farë rëndësie për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Instrumentet ndërkombëtare të përmendura në vijim përmbajnë brenda tyre procedura të komunikimit individual²:

- ▶ Protokollin Opsional i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
- ▶ Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial
- ▶ Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese
- ▶ Protokollin Opsional i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
- ▶ Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Punëtorëve Emigrantë si dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre

² Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në këtë moment janë duke përgatitur një protokoll opsional për t'ia bashkëngjitur Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Drafti për momentin parashikon përfshirjen si të një procedure të komunikimit individual ashtu edhe të një procedure hetimore.

- ▶ Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave prej Zhdukjes së Dhunshme (e cila akoma nuk ka hyrë në fuqi)

Instrumentat ndërkombëtare të përmendura në vijim përmbajnë procedura hetimore:

- ▶ Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese
- ▶ Protokollin Opsional i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
- ▶ Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave prej Zhdukjes së Dhunshme (e cila akoma nuk ka hyrë në fuqi)

Procedura e komunikimit individual dhe procedura hetimore

Procedura e komunikimit individual:

- ▶ Ofron një mundësi për të konsideruar në mënyrë specifike çështjet individuale në të cilat një Shtet dhuron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe kur nuk mund të merret një zgjidhje prej procedurave në rang kombëtar;
- ▶ Ofron mundësinë e rekursit ndërkombëtar për personat me aftësi të kufizuara të cilëve u është mohuar aksesimi ndaj drejtësisë në nivel kombëtar;
- ▶ I mundëson Komisionit që të vendosë në dukje nevojën për zgjidhje më efektive në nivel kombëtar;
- ▶ E lejon Komisionit që të zhvillojë një gamë të re legjislacioni në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen më të mirë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; dhe
- ▶ Ndhmon Shtetet anëtare që të përkufizojnë përmbajtjen e dety-

rimeve të tyre sipas Konventës, e në këtë mënyrë i asiston Shtetet që t'i zbatojnë këto detyrime.

Procedura hetimore:

- ▶ Mundëson Komisionin që të adresojë dhunimet sistematike dhe të përhapura të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
- ▶ Lejon Komisionin që të rekomandojë masat për të luftuar rastet strukturore të diskriminimit kundër personave me aftësi të kufizuara;
- ▶ Mundëson Komisionin të vendosë një gamë të gjerë rekomandimesh për të arritur një respektim më të madh të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; dhe
- ▶ Lejon Komisionin të punojë me Shtetet anëtare për të eliminuar pengesat për gëzimin e plotë të të drejtave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Ndonëse të gjithë këto traktate janë të hapur për komunikime prej personave me aftësi të kufizuar të cilët jetojnë në Shtetet të cilat kanë ratifikuar procedurat, asnjë prej tyre nuk shënjestron në detaje të drejtat e personave me aftësi të kufizuar; dhe ndërsa të gjithë këto komisione kanë në përbërjen e tyre ekspertë të të drejtave të njeriut, ata jo domosdoshmërisht përfitojnë prej ekspertizës në lidhje me të drejtat e njeriut dhe aftësinë e kufizuar. Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, për arsyen e lartpërmendur, ofron procedura të cilat shënjestrojnë në mënyrë specifike të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Anëtarësimi në Protokollin Opsional

Protokolli Opsional i inkurajon Shtetet që të zbatojnë Konventën në mënyrë efektive, që të ofrojnë më tepër zgjedhje në nivel kombëtar dhe të eliminojnë ligjet dhe praktikat diskriminuese, dhe përfaqëson një shtresë përkushtimi shtesë duke ofruar garanci shtesë se Shteti ka për të qënë i përgjegjshëm për detyrimet e veta sipas Konvetës.

Protokolli Opsional është një mjet i përdorur prej Shteteve:

- ▶ Për të përmirësuar mekanizmat ekzistues të mbrojtjes për personat me aftësi të kufizuar;
- ▶ Për të shtuar edhe më shumë numrin e mekanizmave ekzistues mbrojtës;
- ▶ Për të rritur kuptimin e Shtetit në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar;
- ▶ Për të justifikuar veprimet e Shteteve anëtare në rastet kur Komisioni zbulon se nuk ka ndodhur asnjë shkelje;
- ▶ Për të shtyrë e nxitur ndryshimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese; dhe
- ▶ Për të krijuar një rritje të ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me standardet e të drejtave të njeriut në lidhje me personat me aftësi të kufizuar.

Procedura për nënshkrimin dhe ratifikimin apo anëtarësimin në Protokollin Opsional është e njëjtë si ajo për Konventën, ndonëse Protokolli Opsional do të hyjë në fuqi vetëm pasi të kenë ndodhur 10 ratifikime apo anëtarësime, ndryshe nga Konventa, e cila kërkon 20 ratifikime apo anëtarësime. Kapitulli 4 diskuton në lidhje me procedurat që kanë të bëjnë me nënshkrimin, ratifikimin apo anëtarësimin e Konventës.

Sekretariati i Kombeve të Bashkuara i cili mbështet Konventën

Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar do të mbështetet nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, me seli në Gjenevë të Zvicrës. Konferenca e Shteteve anëtare do të mbështetet nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale, me seli në New York.

Për detajet e kontaktit, shikoni faqen në vijim.

LISTË PËR PARLAMENTARËT

Si mund të rris ndërgjegjësimin mbi Protokollin Opsional:

- Duke marrë informacion nëse Qeveria synon të bëhet palë e Protokollit Opsional dhe, nëse jo, të pyes se përse është marrë ky vendim.
- Duke ngritur pyetje në parlament në lidhje me veprimet që Qeveria synon të ndërmarrë në lidhje me Protokollin Opsional.
- Duke prezantuar një projektligj të iniciuar nga vetë deputeti në lidhje me çështjen në fjalë.
- Duke inkurajuar debatin parlamentar në lidhje me Protokollin Opsional.
- Duke mobilizuar opinionin publik përmes organizimit të fushatave publike dhe debateve duke përdorur televizionin, radion dhe median e shkruar, si dhe takimet me publikun e gjerë.
- Duke u siguruar që Protokollin Opsional të përkthehet në gjuhën/gjuhët kombëtare dhe të shpërndahet gjerësisht.
- Duke u siguruar që Protokollin Opsional si dhe informacionet e thjeshta në lidhje me procedurat e tij të jenë të gatshme në gjuhët lokale si dhe në formate të aksesueshme.
- Duke organizuar dhe duke ofruar kontribut në mbledhjet, trajnimet apo seminarët e informimit në lidhje me Protokollin Opsional për anëtarët e parlamentit, anëtarët e Qeverisë apo shoqërinë civile.
- Duke u lidhur me organizata të cilat përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara si dhe organizata të të drejtave të njeriut
- Duke përdorur Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Afësi të Kufizuara (3 Dhjetor) si një rast për të inkurajuar veprim sa i përket nënshkrimit dhe ratifikimit të Protokollit Opsional.
- Duke inkurajuar personat me aftësi të kufizuara të drejtat e të cilëve janë dhunuar që të përdorin në mënyrë të përshtatshme Protokollin Opsional.



Detajet e Kontaktit

Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

UNOG-OHCHR
1211 Geneva 10
SWITZERLAND

E-mail: crpd@ohchr.org

(Ju lutem, shkruani "Request for information" në kutinë e subjektit të e-mailit)

Konferenca e Shteteve Anëtare

Sekretariati për Konventën e të Drejtave me Aftësi të Kufizuar

Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale
Two United Nations Plaza
New York, NY, 10017
United States of America

Fax: +1-212-963-0111

E-mail: enable@un.org

KAPITULLI KATËR

Anëtarësimi në Konventë dhe në Protokollin Opsional

Mënyrat përmes të cilave një traktat ndërkombëtar hyn në legjislacionin kombëtar ndryshojnë në varësi të sistemit parlamentar ashtu si dhe procedurave kombëtare. Sidoqoftë, në të gjitha rastet, Shtetet duhet që të ndërmarrin një numër të caktuar hapash për t'u bërë anëtarë të Konventës si dhe të Protokollit Opsional. Këto masa janë praktika ndërkombëtare sipas ligjit ndërkombëtar.

Anëtarësimi në Konventë

Nënshkrimi i traktatit

Një Shtet bëhet anëtar i Konventës dhe i Protokollit Opsional duke nënshkruar dhe ratifikuar secilin prej dokumentave apo duke u anëtarësuar në to. Një organizatë rajonale integrimi bëhet pjesë e Konventës dhe Protokollit Opsional duke e nënshkruar dhe duke e konfirmuar formalisht synimin e saj, ose duke u bërë anëtare tek të dyja. Një parakusht për nënshkrimin dhe ratifikimin e Protokollit Opsional është që Shteti të ketë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën.

Hapi i parë në procesin e bërjes palë në një traktat është nënshkrimi i traktatit. Shtetet dhe organizatat rajonale të integrit, si për shembull Bashkimi Evropian, mund ta nënshkruajnë Konventën. Çdo shtet që ka nënshkruar ose organizatë rajonale e integritit e cila ka nënshkruar Konventën mundet po ashtu të nënshkruajë Protokollin Opsional.

Një Shtet mund të nënshkruajë Konventën dhe Protokollin Opsional në cilëndo kohë. Nënshkrimi duhet të koordinohet me Zyrën e Çështjeve Ligjore në Zyrat Qëndrore të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Ndërsa disa traktate nuk e lënë të hapur periudhën për nënshkrimin, kjo Konventë dhe Protokollit i saj Opsional janë të hapura për nënshkrim në një periudhë të papërcaktuar.

Kush mund ta nënshkruajë Protokollin Opsional?

Kryetarët e Shteteve, Kryetarët e Qeverive apo Ministrat e Punëve të Jashtme kanë fuqinë që të nënshkruajnë një traktat në emër të një Shteti pa pasur nevojën që të provojnë se kanë fuqinë të vepronë kështu.

Përfaqësues të tjerë të cilët synojnë të nënshkruajnë një traktat duhet të kenë kredenciale zyrtare të plota, të lëshuara nga një prej autoriteteve të mësipërme, kredenciale të cilat autorizojnë nënshkrimin e Konventës apo të Protokollit Opsional prej përfaqësuesit në fjalë.

Shtetet apo organizatat rajonale të integrit të cilat dëshirojnë të nënshkruajnë Konventën dhe Protokollin Opsional përmes një përfaqësuesi duhet që paraprakisht të ofrojnë kopje të letrave të plota të kredencialeve në nevojshme në adresën e mëposhtme:

Treaty Section
Office of Legal Affairs
United Nations Headquarters
New York, New York
United States of America

Tel: +1 212 963 50 47

Fax: +1 212 963 36 93

E-mail: treaty@un.org

Çfarë nënkupton nënshkrimi i traktatit

Konventa dhe Protokollin Opsional ofrojnë mundësinë për një procedurë të thjeshtë nënshkrimi. Kjo do të thotë që nuk ekzistojnë detyrime ligjore të vendosura për një Shtet nënshkruar apo një organizatë rajonale integrimi menjëherë pasi traktati të jetë nënshkruar. Sidoqoftë, duke nënshkruar Konventën dhe Protokollin Opsional, Shtetet ose organizatat rajonale të integrit shpalosin synimin e tyre për të ndërmarrë hapa për të qenë të lidhur prej traktatit në një datë të mëvonshme. Nënshkrimi gjithashtu krijon një detyrim, në periudhën mes nënshkrimit dhe ratifikimit apo pranimit për të qenë ligjërishë i detyruar prej Konventës, për të mos ndërmarrë akte që do të binin në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e traktatit.

Shprehja e vullnetit për të qenë palë e Konventës

Në mënyrë që të bëhet pjesë e Konventës dhe Protokollit Opsional, një Shtet duhet të demonstrojë, përmes veprimeve konkrete, gatishmërinë e tij për të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet ligjore të përfshira në këto dy instrumenta. Në fjalë të tjera, duhet të shprehë pëlqimin për të qenë palë e Konventës dhe Protokollit Opsional.

Sipas Konventës dhe Protokollit Opsional, Shtetet mund të shprehin pranimin e tyre për të qenë të detyruar në disa mënyra:

- ▶ Ratifikimi (për Shtetet)
- ▶ Anëtarësimi (për Shtetet dhe organizatat rajonale të integritit)
- ▶ Konfirmimi formal (për organizatat rajonale të integritit)

Pranimi për të qënë i detyruar e ligjërish i lidhur prej Konventës dhe Protokollit Opsional është akti përmes të cilit Shtetet demonstrojnë përkushtimin e tyre për të ndërmarrë detyrime ligjore sipas këtyre instrumentave.

Procesi i ratifikimit

▶ **Ratifikimi në nivel ndërkombëtar**

Si Konventa ashtu dhe Protokollit Opsional ofrojnë mundësinë për Shtetet që të shprehin pranimin e tyre për të qënë palë duke e nëshkruar me synim ratifikimin. Pas ratifikimit në nivel ndërkombëtar, traktati merr fuqi ligjore për shtetin palë.

▶ **Ratifikimi në nivel kombëtar**

Ratifikimi në nivel ndërkombëtar nuk duhet të ngatërrohet me ratifikimin në nivel kombëtar. Në nivel kombëtar, Shtetit mund t'i nevojitet që ta ratifikojë traktatin në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së tij ose me parashikimet e tjera ligjore, përpara se të ndërmarrë detyrime në nivel ndërkombëtar. Për shembull, Kushtetuta mund t'i kërkojë parlamentit që të marrë në konsideratë termat e Konventës dhe të marrë një vendim në lidhje me ratifikimin, përpara se të ketë ndonjë veprim në nivel ndërkombëtar që do të tregonte se Shteti pranon të jetë ligjërish i detyruar prej traktatit. Sidoqoftë, vetëm ratifikimi në nivel kombëtar nuk është i mjaftueshëm për të treguar vendosmërinë e Shtetit për të qënë ligjërish i lidhur në nivel ndërkombëtar. Është kjo arsyeja se përsa ratifikimi në nivel ndërkombëtar mbetet i nevojshëm, pavarësisht procedurave në nivel kombëtar.

Ratifikimi nga organizatat rajonale të integritit

Konventa dhe Protokollit Opsional lejojnë edhe që organizata rajonale integrimi, si për shembull Bashkimi Europian, të shprehin pranimin e tyre për të qënë të lidhur si prej Konventës ashtu edhe prej Protokollit Opsional përmes nënshkrimit dhe “konfirmimit formal”. Konfirmimi formal ka të njëjtin efekt praktik si ratifikimi. Prandaj, pasi ka ndodhur konfirmimi formal, organizata rajonale e integritit është ligjërish e lidhur prej Konventës dhe/ose Protokollit Opsional.

Anëtarësimi në Konventë

Një Shtet ose një organizatë rajonale integrimi mundet gjithashtu të shprehë pranimin e tij për të qënë palë e Konventës ose Protokollit Opsional duke depozituar një instrument anëtarësimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ndryshimi midis nënshkrimit, ratifikimit, konfirmimit formal dhe anëtarësimit

- ▶ **Nënshkrimi** tregon synimin e Shtetit për të ndërmarrë hapa për të shprehur pëlqimin për të marrë detyrime ligjore prej Konventës dhe ose Protokollit Opsional në një datë të mëvonshme. Nënshkrimi gjithashtu krijon një detyrim, në periudhën ndërmjetëse mes nënshkrimit dhe pranimit për të qënë palë, për të mos kryer akte të cilat do të binin në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e traktatit.
- ▶ **Ratifikimi** detyron ligjërisht Shtetin për të zbatuar Konventën dhe/ose Protokollin Opsional, gjithmonë me mundësinë për rezervime të vlefshme, kuptim dhe deklarata të vlefshme.
- ▶ **Konfirmimi** formal detyron ligjërisht një organizatë rajonale të integritit për të zbatuar Konventën dhe/ose Protokollin Opsional.
- ▶ **Anëtarësimi** përbën detyrim ligjor për Shtetin ose organizatën rajonale të integritit për të zbatuar Konventën dhe/ose Protokollin Opsional.

Anëtarësimi ka të njëjtin efekt ligjor si ratifikimi; sidoqoftë, ndryshe nga ratifikimi, i cili duhet të paraprihet prej nënshkrimit për të qënë palë e konventës, sipas ligjit ndërkombëtar, anëtarësimi kërkon vetëm një hap, që realisht është vetëm depozitimi i instrumentit të anëtarësimit.

Instrumenti i ratifikimit, konfirmimit formal apo anëtarësimit

Në rastin kur një Shtet dëshiron të ratifikojë apo të bëhet anëtar i Konventës apo i Protokollit Opsional, apo një organizatë rajonale integriti dëshiron që në mënyrë formale të konfirmojë apo anëtarësohet, Shteti apo organizata rajonale e integritit duhet me doemos të përmbushë një instrument ratifikimi, konfirmimi formal apo anëtarësimi, të nënshkruar prej Kreut të Shtetit, Kreut të Qeverisë apo Ministrit të Punëve të Jashtme.

Nuk ekziston një formë e mandatuar për instrumentin; sidoqoftë, ky dokument duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- ▶ Titullin, datën dhe vendin e krijimit të Konventës dhe/ose Protokollit Opsional;
- ▶ Emrin e plotë dhe titullin e personit i cili nënshkruan instrumentin;
- ▶ Një shprehje e qartë e synimit të Qeverisë, në emër të Shtetit, për ta konsideruar veten palë të Konventës dhe/ose Protokollit Opsional, dhe për të marrë përsipër detyrimet për të respektuar dhe vëzhguar parashikimet dhe kërkesat e Konventës;

- Nënshkrimin e Kryetarit të Shtetit, Kryetarit të Qeverisë apo Ministrit të Punëve të Jashtme (vula zyrtare nuk është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për këtë qëllim) apo cilido zyrtari tjetër i cili vepron në këto funksione në momentin në fjalë apo është me fuqi të plota për të përmbushur këtë qëllim, të deleguara nga një prej autoriteteve të lartpërmendura.

Instrumenti i ratifikimit, konfirmimit formal apo anëtarësimit hyn në fuqi vetëm kur Shteti apo organizata rajonale e integrimit e depoziton atë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Zyrat Qëndrore të Kombeve të Bashkuara në New York.

Shtetet apo organizatat rajonale të integrimit duhet t'i dorëzojnë të tilla dokumenta pranë Seksionit të Traktateve në Kombet e Bashkuara për t'u siguruar se veprimi është procesuar në mënyrën e duhur. (Shiko më lart detajet e kontaktit për Seksionin e Traktateve.)

Në rastin kur është e mundur, Shteti apo organizata rajonale e integrimit duhet të ofrojë përkthim kortezie në Anglisht dhe/ose Frëngjisht, të instrumentave të cilat janë përgatitur në gjuhë të tjera. Kjo do të ndihmojë në sigurimin se instrumenti është procesuar në mënyrën e duhur.

Roli i parlamentit në procesin e ratifikimit

Parlamentet kanë një rol kyç për të luajtur në procesin e ratifikimit. Ndërsa një përfaqësues i pushtetit ekzekutiv – një Kryetar Shteti, Kryetar i Qeverisë apo Ministrisë së Punëve të Jashtme – nënshkruan dhe ratifikon traktatet, në shumicën e vendeve, vendimi përfundimtar në lidhje me ratifikimin i përket parlamentit, i cili duhet të aprovojë ratifikimin. Kjo është tepër e vërtetë në vendet të cilat aplikojnë një traditë dhe sistem ligjor evropian (civil-law). Sidoqoftë, në shumicën e vendeve të cilat kanë një traditë ligjore anglo-saksone (common-law), fuqia për nënshkrimin e traktateve i përket ekzekutivit, dhe parlamentet mund të luajnë një rol më të kufizuar në procesin e ratifikimit. Teksa traktatet ndërkombëtare rriten në numër dhe mbulojnë një gamë të gjerë subjektsh, të cilat kanë implikime të qarta për ligjin dhe politikën vendase, parlamentet në të gjitha vendet po tregojnë një interes më të madh në lidhje me prerogativat e ekzekutivit për të nënshkruar traktate. Shikoni listën në fund të këtij kapitulli në lidhje me veprimet e mundshme që parlamentarët mund të ndër marrin në këtë drejtim.

Kur hyjnë në fuqi Konventa dhe Protokollin Opsional

Në momentin që secila prej tyre hyn në fuqi, Konventa dhe Protokollin Opsional bëhen ligjërish të vlefshëm dhe detyrues për Shtetet anëtare.

Ka shumë të ngjarë që Konventa dhe Protokollin Opsional do të hyjnë në fuqi në dy data të ndryshme nga njëra tjetra, duke qënë se të dy instrumentat kanë procese tepër të ndryshme sa i përket hyrjes në fuqi:

Roli i parlamentit në procesin e ratifikimit

Roli i parlamenteve në procesin e ratifikimit varion nga njëri vend në tjetrin. Në Australi, parlamenti merr në konsideratë veprimet e Qeverisë për të ratifikuar një traktat. Sipas kësaj praktike, çdo veprim që lidhet me një traktat, si për shembull ratifikimi, mbahet i publikuar në parlament për një periudhë prej të paktën 15 ditësh pune, përpara se qeveria të ndërmarrë ndonjë veprim. Kur prezantohet në Parlament, teksti i traktatit të propozuar shoqërohet nga një analizë e interesit kombëtar (national interest analysis (NIA), e cila shpjegon se përse Qeveria e konsideron të përshtatshme që ta ratifikojë traktatin. NIA përfshin informacion në lidhje me:

- ▶ Efektet ekonomike, mjedisore, sociale dhe kulturore të traktatit të propozuar;
- ▶ Detyrimet që imponohen prej traktatit;
- ▶ Procedurën se si traktati do të zbatohet brenda vendit;
- ▶ Kostot financiare të cilat kanë të bëjnë me zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave të traktatit; dhe
- ▶ Konsultime të cilat janë ndërmarrë me shtetet, industrinë, grupet komunitare apo palë të tjera të interesuara.

Një Komision për Traktatet merr në konsideratë NIA-n si dhe çfarëdo material tjetër të lidhur me çështjen, e pastaj publikon raportin e vet në shtypin kombëtar si dhe në faqen e tij të internetit, duke ftuar bërjen e komenteve prej gjithëkujt i cili ka një interes në lidhje me traktatin e propozuar. Komisioni zakonisht mban dëgjesa publike të herëpas'herëshme dhe i prezanton një raport Parlamentit, raport i cili mban brenda mendimin e opinionit nëse Australia duhet të ratifikojë apo të marrë ndonjë tjetër vendim në lidhje me traktatin.

Në Australi, Qeveria mund gjithësesi të vendosë që ta ratifikojë një traktat edhe në rastin kur Komisioni për Traktatet ka rekomanduar që ratifikimi të mos kryhet; sikurse Qeveria mund të vendosë që të mos e kryejë ratifikimin, edhe pse Komisioni për Traktatet ka sugjeruar që kjo gjë të ndodhë. Sidoqoftë, procesi sigurisht që ofron një mjet shumë të rëndësishëm për shqyrtimin publik dhe parlamentar të vendimeve të Qeverisë në lidhje me ratifikimin e traktateve ndërkombëtare.

- ▶ Konventa hyn në fuqi ditën e 30të pasi të jetë depozituar instrumenti i 20të i ratifikimit apo anëtarësimit.
- ▶ Protokolli Opsional hyn në fuqi ditën e 30të pasi të jetë depozituar instrumenti i 10të i ratifikimit apo anëtarësimit.

Pasi Konventa dhe Protokolli Opsional të kenë hyrë në fuqi në nivel ndërkombëtar, në nivel kombëtar dhe nivel rajonal, për çdo Shtet apo organizatë rajonale integrimi që bën ratifikimin, Konventa hyn në fuqi 30 ditë pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit.

Për më tepër informacion në lidhje me procesin e ratifikimit, shikoni faqen e internetit të Zyrës së Çështjeve Ligjore në adresën: <http://untreaty.un.org>

Rezervimet për Konventën dhe Protokollin Opsional

Një rezervim është një deklaratë e cila pretendon të përjashtojë apo modifikojë efektet ligjore të një dispozite të traktatit në lidhje me Shtetin apo organizatën rajonale të integritit në fjalë. Deklarata mund të titullohet “rezervim”, “deklarim”, “kuptim”, “deklaratë interpretuese” apo “deklarim iterpretues”. Cilado qoftë terminologjia e përdorur, çdo deklaratë e cila përjashton apo modifikon efektet ligjore të një dispozite të traktatit është, në fakt, një rezervim. Një rezervim i mundëson një Shteti apo organizate rajonale integrimi që përndryshe nuk do të dëshironte apo nuk do ta kishte të mundur që të merrte pjesë në Konventë apo në Protokollin Opsional, që të bëhet pjesë e Konventës apo Protokollit Opsional.

Shtetet apo organizatat rajonale të integritit mund të bëjnë rezervime në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, konfirmimit formal apo anëtarësimit. Kur rezervimi bëhet në kohën e nënshkrimit, rezervimi është thjesht deklarues dhe duhet të konfirmohet në mënyrë formale në formë të shkruar në momentin që Shteti shpreh pranimin e tij për të qënë ligjërisht i lidhur prej traktatit.

Shtetet ose organizatat rajonale të integritit mund të bëjnë rezervime pas ratifikimit, konfirmimit formal apo anëtarësimit.

Normalisht, kur një Shtet apo një organizatë rajonale integrimi formulon një rezervim, ai duhet të përfshihet në instrumentin e ratifikimit, konfirmimit formal apo anëtarësimit, apo të bashkëngjitet si shtojcë me të dhe të nënshkruhet veçan prej Kreut

Rezervime të palejueshme

Si Konventa ashtu edhe Protokollin Opsional lejojnë mundësi për rezervime. Sidoqoftë, rezervimet të cilat janë të papërputhshme me objektin dhe qëllimin e Konventës apo të Protokollit Opsional nuk janë të lejuara.

Kundërshtimi i Rezervimeve

Pasi një rezervim bëhet publik dhe qarkullohet, Shtetet e tjera kanë 12 muaj kohë gjatë të cilave ato mund të kundërshtojnë rezervimin, periudhë kohore e cila nis në datën që lajmërimi i rezervimit është depozituar ose në datën në të cilën Shteti apo organizata rajonale e integritit ka pranuar detyrimet për të qënë palë e konventës, cilado prej tyre që është me vonë në kohë. Kur një Shtet dërgon një kundërshtim për një rezervim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara pas përfundimit të periudhës 12-mujore, Sekretari i Përgjithshëm e qarkullon atë si “komunikatë.”

të Shtetit, Kreut të Qeverisë apo Ministrisë të Punëve të Jashtme, apo një zyrtar i cili zotëron fuqinë e plotë për këtë qëllim, fuqi e cila i është deleguar prej një prej autoriteteve të përmendura më lart.

Në momentin kur Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara merr një rezervim, Sekretari i Përgjithshëm informon Shtetet e tjera, zakonisht përmes e-mailit, në datën e formulimit të rezervimit. Kur Sekretari i Përgjithshëm merr një rezervim pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, konfirmimit formal apo anëtarësimit, dhe ky rezervim përmbush kërkesat formale të përmendura më poshtë, Sekretari i Përgjithshëm qarkullon rezervimet tek të gjitha Shtetet e interesuara.

Modifikimi dhe tërheqja e rezervimeve

Një rezervim ekzistues mund të modifikohet. Modifikimi mund të sjellë si pasojë tërheqjen e pjeshme të rezervimit ose mund të krijojë përjashtime të reja prej, apo modifikime të efekteve ligjore të disa prej parashikimeve të konventës. Një modifikim i llojit të dytë është i ngjashëm me një rezervim të ri. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara qarkullon këto modifikime dhe i jep Shteteve anëtare një kohë prej 12 muajsh brenda së cilës ata mund t'i kundërshtojnë këto modifikime. Në mungesë të kundërshtimeve prej shteteve anëtare, Sekretari i Përgjithshëm i pranon modifikimet e depozituara. Nëse ka kundërshtime, atëherë modifikimi dështon.

Një Shtet ose një organizatë rajonale integrimi mund të tërheqë cilindo rezervim që i ka bërë Konventës apo Protokollit Opsional në çdo kohë. Tërheqja duhet të formulohet në formë të shkruar dhe të nënshkruhet prej Kreut të Shtetit, Kreut të Qeverisë ose Ministrisë të Punëve të Jashtme, apo një zyrtar i cili ka aftësitë e plota për këtë qëllim, të deleguara prej një prej autoriteteve të lartpërmendura. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara qarkullon një lajmërim në lidhje me tërheqjen e rezervimit ndër të gjitha Shtetet e interesuara.

Deklarimet për Konventën dhe Protokollin Opsional

Llojet e deklarimeve për Konventën dhe Protokollin Opsional

Sipas parashikimeve të Konventës, Shtetet mund të bëjnë deklarime vetëm në formën e deklarimeve interpretuese. Sipas Protokollit Opsional, Shtetet mund të bëjnë deklarime interpretuese dhe deklarime opsionale.

▣ Deklarimet interpretuese

Një Shtet apo një organizatë rajonale integrimi gjithashtu mund të bëjë një deklaram në lidhje me kuptimin që ata i bëjnë një çështjeje që përfshihet brenda një parashikimi të caktuar të traktatit apo interpretimit të një parashikimi të caktuar të traktatit. Të tilla shprehje quhen “deklarime” ose “deklarime interpretuese.” Në ndryshim nga rezervimet, këto deklarime nuk synojnë të përjashtojnë apo të modifikojnë efektet ligjore të traktatit.

Qëllimi i deklarimeve është që të qartësojnë kuptimin e parashikimeve të caktuara të traktatit, ose të traktatit në tërësinë e vet.

■ **Deklarimet opsionale**

Një formë shtesë e deklarimeve është e lejueshme sipas Protokollit Opsional. Protokollin Opsional lejon dy lloj procedurash: një sistem i cili i lejon individëve t'i drejtohen Komisionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, duke pretenduar një dhunim të Konventës (procedura e komunikimit individual), si dhe një sistem i cili i lejon Komisionit që të ndërmarë hetime kur merr informacion të besueshëm i cili tregon dhunime të rënda ose sistematike prej një Shteti anëtar të të drejtave të paraqitura në Konventë (procedura hetimore). Shtetet dhe organizatat rajonale të integritit të cilat ratifikojnë Protokollin Opsional mund, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit apo anëtarësimit, të deklarojnë se ata nuk e njohin kompetencën e Komisionit në lidhje me procedurat e hetimit.

Bërja e deklarimeve për Konventën

Deklarimet zakonisht depozitohen në momentin e nënshkrimit apo në momentin që depozitohet instrumenti i ratifikimit, konfirmimit formal apo anëtarësimit.

Deklarimet interpretuese nuk kanë një efekt ligjor të ngjashëm me rezervimet dhe rrjedhimisht nuk kërkojnë nënshkrimin e një autoriteti formal, sa kohë që dokumenti vjen qartësisht prej Shtetit në fjalë. Sidoqoftë, preferohet që një deklaratë e tillë të nënshkruhet prej Kreut të Shtetit, Kreut të Qeverisë apo Ministrisë të Punëve të Jashtme, apo një zyrtari i cili zotëron fuqinë për këtë qëllim, të deleguar prej autoriteteve të lartpërmendura.

Duke qënë se deklarimet opsionale ndikojnë tek detyrimet ligjore që kanë Shtetet apo organizata rajonale të integritit, ato duhet të nënshkruhen prej Kreut të Shtetit, Kreut të Qeverisë apo Ministrisë të Punëve të Jashtme, apo një zyrtari i cili zotëron fuqinë për këtë qëllim, të deleguar prej autoriteteve të lartpërmendura.

Pasi Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara merr deklarin, ai/ajo ia komunikon tekstin e deklarin të gjitha Shteteve të interesuara, duke përfshirë edhe përmes e-mailit, duke i lejuar këtyre Shteteve që të arrijnë në konkluzionet e tyre në lidhje me statusin e deklarin.

Një deklarin i cili përbën në vetvete një rezervim dhe është në mospërputhje me objektin dhe qëllimin e Konventës apo të Protokollit Opsional nuk është i lejueshëm. Nëse një gjë e tillë ndodh, një Shtet mund të lajmërojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në lidhje me kundërshtimet e tij për deklarin. Sekretari i Përgjithshëm qarkullon çdo kundërshtim që merr. Kundërshtimet për deklarinet përgjithësisht fokusohen mbi faktin nëse një komunikim nga shteti është thjesht një deklarin interpretues apo është, në fakt, një rezervim i vërtetë i cili do të modifikonte efektet ligjore të traktatit. Një Shtet i cili kundërshton një deklarin ndonjëherë kërkon që Shteti që

bën deklarimin të “qartësojë” qëllimet e veta. Në këtë rast, nëse Shteti deklarues bie dakort mbi faktin se ka formuluar një rezervim dhe jo një deklaram, atëherë ai mund të tërheqë rezervimin e tij, ose përndryshe të konfirmojë se komunikimi i tij është vetëm një deklaram.

Ashtu si në rastin e rezervimeve, është e mundur që të modifikohen ose të tërhiqen edhe deklarimet.

Rëndësia e Konventës për palët joanëtare

Idealisht, Shtetet duhet të ratifikojnë Konventën dhe Protokollin Opsional për të siguruar një mbrojtje optimale të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara brenda territorit të tyre. Por edhe në rastin kur një Shtet nuk është anëtar i Konventës dhe i Protokollit Opsional, parashikimet e Konventës mund të jenë të rëndësishme gjithësesi. Miratimi i Konventës pa asnjë votë kundër nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara tregon se komuniteti ndërkombëtar njeh dhe vlerëson rëndësinë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Minimalisht për këtë arsye, Konventa mban përsipër një autoritet moral dhe mund të përdoret për të udhëzuar Shtetet dhe madje edhe për të nxitur reforma atje ku nuk ka mjaftueshëm vullnet politik për të pasur të tilla reforma. Kur një Qeveri vendos të ndërmarrë një reformë ligjore, anëtarët e parlamentit mund të përdorin Konventën si një standart ndërkombëtar të njohur kundrejt të cilit mund të rishikohen e modelohen legjislacionet dhe politikat kombëtare. Konventa mund të përdoret edhe si model për t’u ndjekur në rastin kur po përgatitet një legjislacion i ri.

Shtetet vazhdojnë të kenë detyrime sipas traktateve të tjera të të drejtave të njeriut dhe sipas ligjit ndërkombëtar në përgjithësi për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Për shembull, të gjitha Shtetet kanë ratifikuar të paktën njërin prej traktateve themelore të të drejtave të njeriut, gjë kjo që do të thotë se të gjitha Shtetet kanë rënë dakort që të ndalojnë diskriminimin, përfshirë këtu edhe diskriminimin që ndodh kundër personave me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të ngjashme, Shtetet kanë detyrime për të respektuar ligjin ndërkombëtar zakonor të të drejtave të njeriut si dhe normat e pakushtëzuara dhe autoritare të ligjit ndërkombëtar, si për shembull ndalimi i torturës.

Shënim:


Përmbajtja e këtij kapitulli është shtuar prej kapitullit 3 të “Udhëzuesit të Traktatit,” i nxjerrë nga Zyra për Çështjet Ligjore e Kombeve të Bashkuara, që mund të gjendet tek:

<http://untreaty.un.org/English/TreatyHandbook/hbframeset.htm>

LISTË PËR PARLAMENTARËT

Si mund të ndihmoj për t'u siguruar që Qeveria ime nënshkruan dhe ratifikon, ose bëhet anëtare e Konventës dhe e Protokollit Opsional:

- Informohu në lidhje me synimin që ka Qeveria juaj për të nënshkruar dhe ratifikuar Konventën dhe Protokollin Opsional të saj.
- Nëse ky synim nuk ekziston, përdor procedurat parlamentare për të nxjerrë në pah arsyet për këtë mosveprim dhe për të inkurajuar Qeverinë që të nisë procesin e nënshkrimit dhe të ratifikimit pa vonesë. Për shembull, bëjini një pyetje verbale ose në formë shkresore Qeverisë suaj për të kuptuar qëndrimin e saj në lidhje me ratifikimin apo për të nxjerrë në pah arsyet e mosveprimit të Qeverisë.
- Merr në konsideratë të drejtën tuaj për të propozuar një projektligj individual në lidhje me këtë çështje.
- Inkurajo një debat parlamentar në lidhje me këtë çështje.
- Mobilizo opinionin publik përmes fushatave të sensibilizimit publik dhe shpërnda informacioni i cili promovon ratifikimin e Konventës dhe të Protokollit Opsional.
- Nëse ka nisur tashmë procedura e nënshkrimit, sigurohu që të informoheni nëse Qeveria synon të bëjë ndonjë rezervim në lidhje me Konventën apo Protokollin Opsional dhe, nëse kjo është e vërtetë, informohu e vendos nëse rezervimet janë të nevojshme dhe të përputhshme me objektin dhe qëllimin e Konventës apo Protokollit Opsional. Nëse arrin në konkluzionin se këto rezervime janë të pabazuara, vepro për t'u siguruar që Qeveria nuk e kryen apo e kthen pas pozicionimin e saj.
- Nëse ratifikimi ka ndodhur, kontrollo nëse ekzistojnë ratifikime të bëra prej Qeverisë të cilat janë akoma në fuqi dhe nëse këto rezervime janë akoma të nevojshme. Nëse arrin në konkluzionin se këto rezervime janë të panevojshme, vepro që ato të tërhiqen.
- Sigurohu që zyrtarët publikë, agjentët Shtetërore dhe publiku i gjerë të jenë të sensibilizuar dhe të informuar për faktin se Shteti ka ratifikuar ose është bërë anëtar i Konventës dhe Protokollit Opsional.
- Nëse vendi juaj ka ratifikuar ose është anëtarësuar në Konventë por nuk ka ratifikuar akoma Protokollin Opsional, informohu mbi arsyet se pse kjo gjë nuk ka ndodhur dhe vepro për t'u siguruar se pengesat për të ratifikuar Protokollin Opsional të hiqen apo evitohen dhe inkurajo një ratifikim të shpejtë të Protokollit Opsional.



KAPITULLI PESË

Legjislacioni kombëtar dhe Konventa

Një nga parimet kryesore të ligjit ndërkombëtar është se një Shtet anëtar i një traktati ndërkombëtar duhet të bëjë të mundur që vetë ligji dhe praktikat e vendit të tij të jenë në përputhje me atë çka kërkohet nga traktati. Në disa raste, traktati mund të japë udhëzime të përgjithshme mbi masat që duhet të merren. Në raste të tjera, traktati përfshin kushte të veçanta. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara i përmban të dyja llojet e parashikimeve. Për këtë qëllim, Parlamenti luan një rol kritik për të siguruar aprovimin e masave të duhura legjislative për Konventën.

Shumë nga parashikimet e përfshira në Konventë ngjasojnë si në mënyrën e formulimit ashtu edhe në përmbajtje me parashikime të traktateve të tjera mbi të drejtat e njeriut, në të cilat mund të jetë palë një Shtet i caktuar. Studimi i mënyrës si janë vënë në fuqi këto parashikime, mund të jetë i dobishëm për të përcaktuar hapat e nevojshëm për zbatimin e Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Përfshirja e Konventës në ligjin vendas

Kuptimi i nënshkrimit dhe ratifikimit

Kapitulli 4 shpjegon në mënyrë të detajuar procesin dhe kuptimin e nënshkrimit dhe ratifikimit të Konventës dhe të Protokollit Opsional. Gjatë shqyrtimit të masave legjislative që duhen ndërmarrë për zbatimin e Konventës, duhet të kemi parasysh se:

- Nuk ekziston asnjë kufi kohor midis nënshkrimit të Konventës ose Protokollit Optional dhe ratifikimit të çdonjërit prej këtyre instrumentave;

- ▣ Nënshkrimi i Konventës apo Protokollit Opsional e detyron Shtetin të distancohet nga akte të cilat mund të kundërshtojnë objektin dhe qëllimin e çdonjërit instrument, dhe
- ▣ Ratifikimi i Konventës ose Protokollit Opsional shenjon të paktën një detyrim që duhet plotësuar nga këto instrumente si edhe respektimin e këtyre detyrimeve në mirëbesim.

Një nga detyrimet themeltare të përmendura në Konventë është fakti se ligji vendas duhet të garantojë të drejtat e listuara në Konventë. Në këtë aspekt, Anëtarët e Parlamentit duhet të marrin në konsideratë mënyrën më të mirë për zbatimin e suksesshëm të të drejtave të garantuara nga Konventa në ligjin vendas. Metoda e përzgjedhur do të ndryshojë në varësi të sistemeve kushtetuese dhe ligjore të vendeve individuale.

- ▣ Në disa vende, pas ratifikimit në nivel ndërkombëtar, Konventa automatiki-

“Uganda ishte një prej 82 vendeve që nënshkruan Konventën më 30 mars dhe procesi drejt ratifikimit është në vazhdim e sipër. Me zbatimin e Konventës, do të shënohet një ndryshim drejt modelit që e trajton aftësinë e kufizuar bazuar tek të drejtat e njeriu, duke mishëruar parimet e dinjitetit, mos-diskriminimit, pjesëmarrjes së plotë, respektit, barazisë dhe përshatshmërisë, si edhe përparimin e të drejtave dhe përfshirjen e të gjithë njerëzve me aftësi të kufizuara.”

James Mwandha, ish-Anëtar i Parlamentit (Ugandë)

Veprime që sigurojnë se ligjet e reja dhe të rishikuara përshtaten me Konvetën

Gjatë procesit të rishikimit gjithpërfshirës të legjislacionit, Qeveritë mund të përfitojnë nga një organ i sapokrijuar apo ekzistues, si psh një komision barazie, një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut apo një komision për aftësinë e kufizuar. Ky proces duhet të marrë në konsideratë:

- ▣ Përfshirjen e ekspertëve nga institucione qeveritare dhe ministritë, nga shoqëria civile, persona me aftësi të kufizuara dhe përfaqësues nga organizatat e tyre përfaqësuese;
- ▣ Vendosjen dhe monitorimin e afateve kohore për përfundimin e rishikimit; dhe
- ▣ Krijimin e një komisioni parlamentar për mbikqyrjen e procesit dhe shqyrtimin sistematik të çdo propozimi legjislativ për të siguruar përputhje me Kushtetutën.

sht mund të bëhet pjesë e ligjit vendas. Me fjalë të tjera, Konventa do të hynte në fuqi drejtpërsëdrejti nga gjykatat vendase dhe autoritete të tjera zbatuese.

- ▶ Në disa vende të tjera, legjislacioni mund të ketë nevojë të adoptojë një akt

Garanci kushtetuese për barazinë e personave me aftësi të kufizuar

Kapitulli 15 i Kartës **Kanadeze mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore** të vitit 1982 thekson: “Çdo individ është i barabartë përpara dhe sipas ligjit dhe gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë dhe përfitimit të barabartë nga ligji pa diskriminim dhe, në mënyrë të veçantë, pa diskriminim të bazuar mbi racën, kombësinë ose etnicitetin, ngjyrën, përkatësinë fetare, seksin, moshën ose aftësinë e kufizuar mendore ose fizike.”

Neni 3 i **Kushtetutës** së **Republikës Popullore të Kinës** deklaron se “njerëzit me aftësi të kufizuar gëzojnë të njëjtat të drejta si edhe qytetarët e tjerë përsa i përket aspekteve politike, kulturore dhe sociale, si edhe jetës familjare” dhe se “është i ndaluar diskriminimi, fyerja ose ngacmimi i njerëzve me aftësi të kufizuar.”

Neni 3 i **Ligjit Bazë** të **Republikës Federale të Gjermanisë** deklaron se të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk do të disfavorizohet për shkak të aftësisë së kufizuar.

Kapitulli 38 i **Kushtetutës** së **ishujve Fixhi** (Akt i Amenduar) i vitit 1997 thekson se “një njeri nuk duhet diskriminuar në mënyrë të padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, bazuar në karakteristikat aktuale apo të supozuara të tij/saj ose rrethanave që përfshijnë....aftësinë e kufizuar.”

Kushteta e Ugandës e vitit 1995 u formulua me pjesëmarrjen e shumë grupeve të ndryshme të komunitetit, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuar. Kjo pjesëmarrje është reflektuar në një numër parashikimesh të kushtetutës që në këtë mënyrë garantojnë dhe promovojnë barazinë e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 21 thekson se një person “nuk duhet diskriminuar në bazë të seksit, racës, ngjyrës, etnicitetit, fisit, lindjes, besimit ose përkatësisë fetare, ose sipas qëndrimit social ose ekonomik, opinionit politik ose aftësisë së kufizuar.”

Neni 32(1) thekson se Shteti “duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme në favor të grupeve të marginalizuara bazuar në gjininë, moshën, aftësinë e kufizuar, ose ndonjë arsye tjetër të krijuar nga historia, tradita apo zakonet, me qëllim që të riadresohen pabarazitë që ekzistojnë kundër tyre.”

Neni 9 i **Kushtetutës** së **Afrikës së Jugut** deklaron se “... për promovimin e arritjes së barazisë, duhen ndërmarrë masa ligjore edhe në të tjera fusha për mbrojtjen ose përparimin e personave, ose kategorive të personave të deprivuar nga diskriminimi i padrejtë.”

ratifikimi në nivel vendi. Kjo mund të ndikojë në përfshirjen e Konventës në ligjin vendas. Megjithatë, edhe në rastet kur parlamentet ratifikojnë Konventën (ratifikim kombëtar), shumë parashikime mund të kenë sërish nevojë për ndërhyrje ligjore përpara hyrjes së tyre në fuqi. Pjesërisht, kjo varet nga sa specifike janë detyrimet e Konventës: sa më specifik detyrimi, aq më pak do të ketë nevojë për zbatimin e legjislacionit.

- Në raste të tjera, duke përfshirë shumë vende me sistem ligjor të përbashkët (common-law), vetëm ato parashikime të traktatit të cilat inkorporohen direkt në ligjin vendas do t'u japin prioritet të drejtave dhe detyrimeve të detyrueshme.

Integrimi përmes masave kushtetuese, legjislative dhe rregullatore

Përveç rasteve të rralla kur ligjet e një vendi përkrijnë plotësisht me kërkesat e Konventës, normalisht një Shtet anëtar do të duhet të amendojë ligjet ekzistuese ose të prezantojë ligje të reja në mënyrë që të zbatojë Konventën në praktikë.

Idealisht, duhet të ekzistojë një deklaratë ligjore gjithpërfshirëse dhe e paktyeshme e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, dhe legjislacioni i detajuar për t'i shndërruar ato në garanci të vërteta në praktikë. Është vërtetë e rëndësishme që njohja dhe mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar të mishërohen në ligjin suprem të vendit, me fjalë të tjera, në kushtetutën kombëtare ose në ligjet bazë. Kjo do të sigurojë mbrojtjen dhe njohjen më të lartë të mundshme. Ky veprim mund të konsiderojë aftësinë e kufizuar si një nga bazat ku diskriminimi është i ndaluar; ose të mbrojë qartësisht të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuar në kushtetutën vendase, si pjesë e një garancie të përgjithshme barazie, ose në formën e parashikimeve të veçanta në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Më tej, parlamenti mund të integrojë të gjithë Konventën në ligjin kombëtar. Në këtë rast, mund të jetë e dobishme përfshirja e një treguesi të qartë në ligjin përkatës se parashikimet e Kushtetutës janë vetë-ekzekutuese, domethënë, që ato duhet të hyjnë drejtpërdrejt në fuqi përpara trupit gjykues dhe gjykatave vendase. Megjithatë, edhe atje ku Kushtetuta është integruar tërësisht në ligjin vendas, kjo normalisht nuk mjafton për t'ju akorduar efektshmëri të plotë parashikimeve të saj; zbatimi i legjislacionit sërish do të jetë i nevojshëm, duke përfshirë ligje të detajuara në fusha të veçanta, si ligji për ndalimin e diskriminimit në punësim.

Për më tepër, nuk do të jetë gjithmonë e mundur ose e përshtatshme për legjislacionin të përcaktojë në detaje rregullat dhe standartet e duhura për të siguruar gëzimin e barabartë të të drejtave të veçanta nga personat me aftësi të kufizuar. Shteti mund të duhet të adaptojë politika dhe nisma rregulluese, përveç legjislacionit, për t'u njehsuar me parashikimet e shumta të cilat kërkojnë ndërmarrjen e “masave të përshtatshme” në fusha si përshatshmëria fizike e ambienteve dhe sistemeve të transportit ose teknologjive të informacionit dhe komunikimit (neni 4 i Konventës).

Ndërsa parlamentet mund të mos aprovojnë hyrjen në fuqi të këtyre rregulloreve të detajuara, mund të jetë e përshtatshme të aprovohen ligje të cilat lejojnë vendosjen e standarteve në këto fusha dhe të kërkojnë prezantimin e këtyre standarteve ndaj legjislacionit për informacion dhe/ose aprovim.

Modele të legjislacionit mbi barazinë dhe mos-diskriminimin

Detyrimi për të ndaluar diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar dhe për të garantuar mbrojtje të barabartë dhe të efektshme të personave me aftësi të kufizuar (neni 5 i Konventës) kërkon si përfshirjen e ndalimit në ligjet dhe mundësisht, edhe në

Përqasje të ndryshme të legjislacionit mbi diskriminimin

Të paktën 40 vende e kanë aprovuar legjislacionin që adreson të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Një pjesë e këtij legjislacioni si objektiv kryesor ka ndalimin e diskriminimit; ligje të tjera adresojnë detyrimin pozitiv të Shtetit dhe komunitetit për sigurimin e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuar dhe aksesin e tyre ndaj mbështetjes sociale. Shumë vende kanë të dyja llojet e legjislacionit.

Akti për **Amerikanët** me **Aftësi të Kufizuar (ADA)** ndalon diskriminimin ndaj njerëzve me aftësi të kufizuar në punësim, shërbime publike dhe transport, dhe në vendet publike. Në kontekstin e punësimit, ADA ndalon në mënyrë të qënësishme diskriminimin ndaj individëve me një aftësi të kufizuar të kualifikuar, të cilët mund të përmbushin funksionet e pozicionit që ata mbajnë apo që dëshirojnë, me ose pa akomodimin e arsyeshëm, funksion i cili nuk imponon vështirësi të pajustificueshme mbi punëmarrësin.¹

Në **Indi**, **Akti për Personat me Aftësi të Kufizuar (Mundësi të Barabarta, Mbrojtje e të Drejtave dhe Pjesëmarrje e Plotë)** i vitit 1995, ofron një përqasje akoma më të gjerë: përdor gjuhë mos-diskriminuese në një numër fushash dhe gjithashtu mbështet dikriminimin pozitiv në të mirë të personave me aftësi të kufizuar përmes një sistemi kuote, që rezervon një numër vendesh për persona me aftësi të kufizuar në trajnimet dhe programet e punësimit të institucioneve publike dhe sektorit privat. Gjithashtu, siguron nxitës për veprime të cilat promovojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe trajtim preferencial përmes heqjes së taksave, dhe dhënies së pagave dhe granteve.²

Në 1996, **Kosta Rica** aprovon **Ligjin Nr. 7600 mbi Barazinë për Personat me Aftësi të Kufizuar**. Ky ligj imponon detyrime të qarta mbi Shtetin për avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, dhe garanton barazinë në fusha si edukimi, shëndetësia dhe puna.

¹ Marrë nga përmbledhja e DESA-s: <http://www.un.org/esa/socdev/enable/discom102.htm#19#19>

² Marrë nga përmbledhja e DESA-s: <http://www.un.org/esa/socdev/enable/discom102.htm#19#19>

kushtetutat e vendeve, ashtu edhe adoptimin e parashikimeve të detajuara legjislative të cilat mbulojnë diskriminimin në të gjitha fushat e jetës publike dhe private. Forma përfundimtare e këtyre parashikimeve do të varet nga ligjet ekzistuese dhe sidomos nga sistemi ligjor përkatës i një Shteti anëtar.

Disa vende kanë ligje gjithpërfshirëse, anti-diskriminuese të përgjithshme që mbulojnë baza të shumëfishta për ndalimin e diskriminimit; të tjerë kanë ligje individuale të cilat mbulojnë format e ndryshme të diskriminimit, si ato të bazuara në seksin, moshën ose statusin social, ose që mbulojnë diskriminimin në fusha të veçanta, si në punësim.

Një mundësi është hyrja në fuqi e një ligji mosdiskriminimi për aftësinë e kufizuar që ndalon diskriminimin e bazuar në aftësinë e kufizuar në përgjithësi, por që gjithashtu siguron rregulla të detajuara mbi fusha specifike të jetës publike dhe private.

Një mundësi tjetër mund të jetë hyrja në fuqi e një ligji mbi barazinë dhe aftësinë e kufizuar, i ngjashëm me ligjet për barazinë gjinore të adoptuara nga disa Shtete. Ligje të kësaj natyre nuk kufizohen vetëm me ndalimin e diskriminimit, por adresojnë një shkallë të gjerë të çështjes në lidhje me personat me aftësi të kufizuar. Për shembull, në Indi, Akti për Personat me Aftësi të Kufizuar (Mbi Mundësitë e Barabarta, Mbrojtjen e të Drejtave dhe Pjesëmarrjen e Plotë) (1995) përcakton një kuadër të gjerë politikash për adresimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar, përcakton krijimin e një numri organesh në nivel kombëtar dhe shtetëror për të bërë këtë, adreson parandalimin dhe identifikimin e hershëm të aftësië së kufizuar, barazinë në punësim dhe arsim, duke përfshirë veprime pozitive, siguri sociale, ambiente dhe mjete transporti të përshtatura, njohjen e institucioneve për persona me aftësi të kufizuar, kërkime studimore mbi çështje të aftësisë së kufizuar dhe probleme të tjera.

Edhe një ligj me bazë të gjerë mbi barazinë dhe aftësinë e kufizuar ka shumë mundësi të mos adresojë disa prej çështjeve thelbësore që lidhen me barazinë e personave me aftësi të kufizuar. Duke pasur parasysh nevojën për detaje më të hollësishme mbi çështjet e sigurisë sociale dhe mbështetjen sociale, kompensimin e punëtorëve, standartet e transportit, ngritjen e standarteve, dhe të tjera mund të jetë forma më e duhur, adresimi i këtyre çështjeve në ligje të tjera.

Atje ku ekzistojnë forma të tjera legjislative për ndalimin e formave të tjera të diskriminimit, mund të jetë me vend amendimi i legjislacionit ekzistues për përfshirjen e aftësisë së kufizuar si një bazë për ndalimin e diskriminimit. Minimalisht, është e rëndësishme të sigurohet se kuptimi i ‘aftësisë së kufizuar’ në Konventë dhe përkufizimi i ‘diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar’ reflektohen plotësisht në një ligj të përgjithshëm anti-diskriminimi. Atje ku legjislacioni ekzistues mbulon vetëm disa nga fushat e Konventës, atëherë duhet krijuar legjislacioni i ri për t’u siguruar se mbrojtja kundër diskriminimit mbi bazat e aftësisë së kufizuar është e vlefshme për të gjitha fushat. Gjithashtu, mund të jetë me vend dhënia e përgjegjësisë për monitorimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nën legjislacionin e ri, institucione-

ve ekzistuese, me kusht që personat me aftësi të kufizuar të jenë ose të angazhohen si anëtarë të këtyre institucioneve dhe që institucionet të kenë ekspertizë të mjaftueshme mbi çështjet e aftësisë së kufizuar.

Çfarë mund të bëjë parlamenti për të siguruar inkorporimin e Konventës në ligjin vendas

- ▶ Të njohë të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale të grave, burrave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar në instancat e ligjit suprem të vendit tuaj (kushtetutë ose ligj i përbashkët);
 - ▶ Të rishikojë parashikimet ekzistuese në kushtetutë, ligjin e bazë dhe në mbrojtjen e dhënë ndaj personave me aftësi të kufizuar;
 - ▶ Të përfshijë një garanci të përgjithshme për barazinë;
 - ▶ Të ndalojë përdorimin e aftësisë së kufizuar si bazë për diskriminim;
 - ▶ Të përfshijë parashikime specifike mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar;
 - ▶ Të rishikojë gjuhën e përdorur për t'ju drejtuar personave me paaftësi;
- ▶ Të adoptojë një ligj vendas ku përfshihet përmbajtja e Konventës, ose edhe i gjithë teksti i saj, duke specifikuar se ligji hyn në fuqi përpara gjykatave.
- ▶ Të adoptojë ligje shtesë për t'u zbatuar. Në varësi të legjislacionit ekzistues, vendi juaj mund të adoptojë ose amendojë:
 - ▶ Një ligj të përgjithshëm mbi diskriminimin duke përfshirë ndalimin e përdorimit të aftësisë së kufizuar si bazë për diskriminim në jetën publike dhe private;
 - ▶ Ligje mos-diskriminimi në sektorë të ndryshëm, si punë, arsim dhe akses në drejtësi, duke përfshirë aftësinë e kufizuar si bazë për të ndaluar diskriminimi; dhe/ose
 - ▶ Ligj mbi barazinë dhe aftësinë e kufizuar, që ndalon diskriminimin me bazë aftësnë e kufizuar, dhe përcakton një kuadër më të gjerë në adresimin e aftësisë së kufizuar.
- ▶ Të sigurojë që egziston një mekanizëm për konsultime me personat me aftësi të kufizuar, dhe/ose organizatat e tyre përfaqësuese, në nivel ligj-bërës.
- ▶ Të rishikojë gjuhën e përdorur për t'ju referuar personave me aftësi të kufizuar në të gjithë ligjet ekzistuese dhe të reja.

Përmbajtja e masave legjislative

Elementë të rëndësishëm

Ekzistojnë një numër elementësh të rëndësishëm të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e legjislacionit, dhe mund të bëhet fjalë për një ose më shumë ligje të ndara. Legjislacioni duhet:

- ▶ T'i referohet qartësisht Konventës dhe asaj çfarë pranohet në konventë në lidhje me faktin që koncepti i aftësisë së kufizuar është në zhvillim e sipër, dhe nocioneve të “Diskriminimit me bazë aftësinë e kufizuar,” “Akomodimit të arsyeshëm” dhe termave të tjera të rëndësishme të Konventës;
- ▶ Të ndalojë diskriminimin me bazë aftësinë e kufizuar në të gjitha fushat e mbulurara nga Konventa;
- ▶ Të identifikojë aktorët përgjegjës, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisë dhe aktorëve jo-Qeveritarë;
- ▶ Të raportojë të drejtat mbi individët dhe grupet për të:
 - ▶ Ngritur akuza të diskriminimit me bazë në aftësinë e kufizuar;
 - ▶ Hetuar mbi këto akuza; dhe
 - ▶ Aksuesuar zgjidhjet dhe dëmshpërblimin e duhur;
- ▶ Të sigurojë që agjencitë e pavararura të:
 - ▶ Dëgjojnë akuzat mbi diskriminimin sistematik dhe çështjet e veçanta;
 - ▶ Hetojnë dhe raportojnë mbi këto akuza; dhe
 - ▶ Kërkojnë zgjidhje dhe dëmshpërblim sistematik dhe ndryshime përmes kanaleve ligjore dhe mjeteve të tjera të përshtatshme.

Lidhja mes legjislacionit në zbatim dhe Konventës

Legjislacioni në zbatim duhet të përfshijë termat e Konventës ose një referencë specifike me të, në mënyrë që të tregojë qartësisht se ligjet duhen interpretuar në përputhje me mesazhin dhe shpirtin e Konventës.

Konventa bazohet mbi mirëkuptimin se aftësia e kufizuar është rezultat i ndërveprimit të një personi dhe mjedisit të tij/saj, dhe se aftësia e kufizuar nuk është diçka që ekziston tek individi si rezultat i ndonjë dëmtimi. Ky shpjegim reflekton implikime të rëndësishme për legjislacionin që do të zbatohet Konventën, sidomos në identifikimin e pengesave të cilat pengojnë realizimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe në përcaktimin e zgjidhjeve të përshtatshme. Parlamentarët mund të dëshirojnë të konsultohen me ekspertë të çështjeve të aftësisë së kufizuar, duke përfshirë persona me aftësi të kufizuar dhe organizatat e tyre përfaqësuese,

për të përditësuar njohuritë e tyre mbi natyrën dhe format e aftësisë së kufizuar dhe mënyrat me anë të të cilave mund të zhidhen pengesat sociale të pjesëmarrjes.

Llojet e aftësisë së kufizuar që duhet të adresohen në legjislacion

Konventa përmbledh një listë të paplotë të aftësive të kufizuara për t'u adresuar nga legjislacioni, me fjalë të tjera, përcakton një minimum. Konventa përshkruan njerëzit me aftësi të kufizuar si “ata të cilët kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijimore, dëmtime të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të efektshme në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.”

Ky përcaktim nuk përjashton kategoritë e aftësive të kufizuara të cilat bien nën mbrojtjen e Konventës; forma të tjera të aftësive të kufizuara, si dëmtimet apo aftësitë e kufizuara afatshkurtra, mund të mbulohen nga Konventa dhe si të tilla mund të mbulohen edhe nga ligjet e Shteteve anëtare, sidomos në kontekstin social të aftësive të kufizuara.

Meqënëse neni 4(4) thekson faktin se Konventa nuk duhet të minojë ose të zëvendësojë standartet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në ligjin kombëtar, për Shtetin mbetet i hapur adoptimi i një përkufizimi më të gjerë. Një Shteti nuk i kërkohet të kufizojë përkufizimin e tij për kategoritë e përmendura sipas nenit 2 të Konventës.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit

Nën **Ligjin Evropian**, është parë i nevojshëm adoptimi i parashikimeve të veçanta në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, duke përfshirë çështjet e diskriminimit të aftësisë së kufizuar. Për shembull, neni 10 i **Udhëzuesit të Këshillit 2000/78/EC** i datës 27 nëntor vendos një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe vendin e punës dhe thotë:

“Barra e provës

1. Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin masat e nevojshme, në përputhje me sistemet e tyre juridike, për të siguruar që, në rastet kur personat e dëmtuar ngaqë parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, sjellin përpara një trupë gjykues ose një autoriteti tjetër kompetent, fakte nga të cilat mund të hamendësohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë ose indirekt, i Akuzuari duhet të jetë i aftë të provojë që nuk ka pasur shkelje të principit të trajtimit të barabartë.
1. Paragrafi 1 nuk duhet të ndalojë Shtetet Anëtare për vendosjen e rregullave të provës, të cilat janë në favor të akuzuesve.”

“Akomodimi i arsyeshëm” si një gur themeli i legjislacionit

Konventa thekson se dështimi për t’i siguruar një personi “akomodim të arsyeshëm” mbi bazë të aftësisë së kufizuar, çon në diskriminim. Për rrjedhojë, çdo përkufizim ligjor i diskriminimit duhet të përfshijë mohimin e akomodimit të arsyeshëm si një akt diskriminues. Referenca duhet bërë bazuar në përkufizimin e “akomodimit të arsyeshëm” sipas nenit 2 të Konventës.

“Akomodimi i arsyeshëm” njihet gjithashtu si detyrim për të akomoduar; rregullim i arsyeshëm; përshtatje e masave, ose modifikime të efektshme ose të përshtatshme. Të bësh të mundur që një person të përfitojë “akomodim të arsyeshëm” do të thotë, për shembull, të kryesh adaptime në mjedisin e punës, të ndërtosh një mjedis edukues, një qendër shëndetësore ose shërbim transporti për të hequr pengesat që ndalojnë një person me aftësi të kufizuar të marrë pjesë në një aktivitet apo të përfitojë shërbime në mënyrë të barabartë me të tjerët. Në rastin e punësimit, kjo mund të përfshijë ndryshime fizike të ndërtesave, blerje ose modifikim të pajisjeve, një lexues ose përkthyes ose trajnim ose mbikqyrje e duhur, adaptim të procedurave të testimit ose vlerësimit, kombinim të orëve standarte të punës, ose ndarje të disa prej detyrave të një pozicioni me një person tjetër.

Në disa vende, ligjet mund të kenë nevojë për strategji prokurimi të ndjeshme ndaj aftësisë së kufizuar, sipas së cilës agjencitë publike mund t’i japin preferencë pajisjeve që janë plotësisht të aksesueshme (ndihmojnë aksesin/përshtatshmërinë) ose të bazuara në parimin e dizenjimit për të gjithë, ose kompanive që kanë përqindje specifike të personave me aftësi të kufizuar në forcën e tyre punonjëse.

Si adresohet “akomodimi i arsyeshëm” në vende të ndryshme

Akti mbi Amerikanët me Aftësi të Kufizuar i 1990, 42 USC §12112

(a) Rregull i përgjithshëm

Asnjë entitet nuk duhet të diskriminojë një individ të kualifikuar me aftësi të kufizuar për shkak të aftësisë së kufizuar së këtij individ në lidhje me procedurat e aplikimit, marrjen në punë, karrierën ose shkarkimin e punonjësve, kompensimin e punonjësit, trajnimin në punë, dhe metodat, kushtet, dhe privilegjet e tjera të punësimit.

(b) Ndërtime

Sipas përdorimit në nënkapitullin (a) të këtij kapitulli, termi “diskriminim” përfshin:

...

VAZHDON ►

(5) (A) moskryerje të akomodimit të arsyeshëm ndaj kufizimeve të njohura fizike ose mendore të një individi të vlerësuar me aftësi të kufizuar, i cili është një aplikant ose i punësuar, vetëm nëse ky entitet mund të provojë se akomodimi do të impononte një vështirësi të padrejtë mbi kryerjen e punës së entitetit të sipërpërmendur; ose

(B) mohim të mundësive të punësimit të një aplikanti ose punonjësi të vlerësuar me aftësi të kufizuar, nëse ky mohim bazohet mbi nevojën që ky entitet duhet të kryejë për akomodimin e arsyeshëm të dëmtimeve fizike ose mendore të punonjësit ose aplikantit....

Ligji i Spanjës mbi Mundësitë e Barabarta, Mos-diskriminimin dhe Aksesueshmërinë Universale të Personave me Aftësi të Kufizuar, i vitit 2003, përfshin edhe akomodimin e arsyeshëm (Ajuste razonable). “Ajuste razonable” përkufizohet si “masa për akomodimin e mjedisit fizik, social dhe sjelljen ndaj nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuar të cilat, në formë efektive dhe praktike dhe pa supozuar një ngarkesë të pabarabartë, lehtësojnë aksesueshmërinë ose pjesëmarrjen e një personi me aftësi të kufizuara në kushte të barabarta me pjesën tjetër të qytetarëve” (paragrafi 7.c).

Akti mbi Diskriminimin e Aftësive të Kufizuara i Mbretërisë së Bashkuar i vitit 1995 për ligj detyrimin e punëmarrësve “për përshatje” (k 6 (1)). Ky detyrim aplikohet atje ku “ndonjë rregullim” ose “ndonjë tipar fizik i ndërtesave” të punëmarrësit [e] vendos personin me aftësi të kufizuar në disavantazh të plotë në krahasim me personat që nuk kanë paaftësi. Në këtë rast, “është detyra e punëmarrësit të ndërmarrë hapat e duhur, në të gjitha kushtet e rastit, në mënyrë që të merren masa për parandalimin e rregullimeve ose tipareve që shkaktojnë këtë efekt”. Nënkapitulli 6 (3) paraqet shembuj specifikë të hapave që duhet të ndërmarrë një punëmarrës për pëmbushjen e këtij detyrimi:

- ▶ Rregullim të ndërtesave;
- ▶ Shpërndarje të disa prej detyrave të personit me aftësi të kufizuar, një personi tjetër;
- ▶ Transferimin e tij/saj për plotësimin e një vendi vakant ekzistues;
- ▶ Kombinim të orëve të punës së tij/saj;
- ▶ Vendosjen e tij/saj në një tjetër vend pune;
- ▶ Lejimin e tij/saj për të munguar gjatë orëve të punës për rehabilitim, vlerësim ose trajtim;
- ▶ Trajnim i tij/saj ose mundësi për trajnim;

◀ VAZHDIM

- ▶ Blerje ose modifikim pajisjesh;
- ▶ Modifikim udhëzimesh ose manualesh reference;
- ▶ Modifikim procedurash për testim ose vlerësim;
- ▶ Marrje në punë të një lexuesi ose përkthyesi;
- ▶ Mbikqyrje.

Sipas **Magna Carta të Njerëzve më Aftësi të Kufizuara në Filipine**, në kontekstin e punësimit, akomodimi i arsyeshëm përfshin “(1) përmirësimin e mjediseve ekzistuese të përdorura nga punonjësit në mënyrë që këto të fundit të jenë të lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme nga personat me aftësi të kufizuara; dhe (2) modifikimin e turneve të punës, emërimin në një vend të lirë pune, blerjen ose modifikimin e pajisjeve ose mjeteve, rregullime të përshtatshme ose modifikime të ekzaminimeve, materialeve të trajnimit ose politikave, rregullave dhe rregulloreve të kompanisë, sigurimin e ndihmës dhe shërbimeve mbështetëse, dhe të tjera akomodime të ngjashme për personat me aftësi të kufizuara” (s 4 (h)).

Në lidhje me sigurimin e shërbimeve publike dhe akomodimin publik, Magna Carta për Personat me Aftësi të Kufizuara deklaron se diskriminimi përfshin:

“një dështim në kryerjen e modifikimeve të arsyeshme në politika, praktika ose procedura, kur këto modifikime janë të nevojshme për sigurimin e mallrave, shërbimeve, mjediseve, privilegjeve, avantazheve, ose akomodim të individëve me aftësi të kufizuara, vetëm nëse entiteti mund të demonstrojë se kryerja e këtyre modifikimeve do të ndryshojë në mënyrë themelore natyrën e mallrave, mjediseve, shërbimeve, privilegjeve, avantazheve, ose akomodimeve” (k 36 (2)).

Ndërsa akomodimi i nevojave të veçanta të personave me aftësi të kufizuara kërkohet sipas Konventës, kërkesa kryesore është akomodimi i arsyeshëm. Nëse akomodimi i kërkuar do të imponojë një barrë të joproportionale ose të padrejtë mbi personin ose organin që duhet ta plotësojë atë, atëherë një dështim i tillë nuk do të përbente diskriminim.

Në një numër vendesh, legjislacioni vendos faktorët të cilët duhen marrë parasysh kur vlerësohet nëse akomodimi i kërkuar kthehet në barrë joproportionale. Këto përfshijnë praktikitetin e ndryshimeve të kërkuara, kostot e përfshira, natyrën, përmasat dhe burimet e entit të përfshirë, burime të tjetra financiare, implikime të natyrës shëndetësore dhe të sigurisë, si dhe ndikimin mbi aktivitetin e entit.

Strategjia e prokurimit në mbështetje të aftësisë së kufizuar në Shtetet e Bashkuara të Almerikës

Në disa vende, legjislacioni rekomandon Qeverinë të japë preferencë në prokurimet e saj publike ndaj pajisjeve dhe teknologjisë që përmbushin standartet e aksesueshmërisë, përgjithshmërisë dhe gjithpërfshirjes. Për shembull, kapitulli 508 i Aktit të Rehabilitimit të ShB i vitit 1973, 29 U.S.C. § 794 (d) shprehet:

“§ 794 D. TEKNOLOGJIA ELEKTRONIKE DHE E INFORMACIONIT

(a) Kërkesa për departamentet dhe agjencitë federale

(1) Aksesueshmëria

(A) Zhvillimi, prokurimi, mirëmbajtja, ose përdorimi i teknologjisë elektronike dhe të informacionit

Gjatë zhvillimit, prokurimit, mirëmbajtjes, ose përdorimit të teknologjisë elektronike dhe të informacionit, çdo departament ose agjenci Federale, duke përfshirë Shërbimin Postar të Shteteve të Bashkuara, duhet të sigurojë, me përjashtim të rasteve kur mbi këtë departament ose agjenci imponohet barrë e padrejtë, se teknologjia elektronike dhe e informacionit lejon që, pavarësisht nga lloji i mjetit të teknologjisë-

(i) individë me aftësi të kufizuar të cilët janë punonjës Federalë të kenë akses dhe mundësi përdorimi të informacionit dhe të dhënave të krahasueshme me aksesin dhe mundësinë e përdorimit të të dhënave nga punonjës Federalë që nuk janë persona me aftësi të kufizuara.; dhe

(ii) individë me aftësi të kufizuar të cilët janë anëtarë të departamentit për marrëdhënie me publikun ose shërbimeve të një departamenti Federal ose agjencie, të kenë akses dhe mundësi përdorimi të informacionit dhe të dhënave të krahasueshme me aksesin dhe mundësinë e përdorimit të të dhënave nga anëtarë të publikut të cilët nuk janë persona me aftësi të kufizuara.

(B) Mjete dhe përpjekje alternative

Në rastet kur zhvillimi, prokurimi, mirëmbajtja, ose përdorimi i teknologjisë elektronike dhe të informacionit që përkon me standartet e vendosura nga Bordi i Aksesueshmërisë sipas paragrafit (2) do të impononte një barrë të padrejtë, departamenti ose agjencia Federale duhet t’u sigurojë personave me aftësi të kufizuar sipas paragrafit (1) informacionin dhe të dhënat e përfshira nga një burim tjetër alternativ që lejon këtë individ të përdorë informacionin dhe të dhënat”

Barra joproporcionale dhe e padrejtë

Ligji i Spanjës mbi Mundësitë e Barabarta, Mos-diskriminimin dhe Aksesueshmërinë Universale të Personave me Aftësi të Kufizuar, i vitit 2003 që përfshin akomodimin e arsyeshëm (Ajuste razonable), përdor termin “ngarkesë e pabarabartë” (“carga desproporcionada”) në legjislacionin e tij. Neni 7 shprehet se, “për të përcaktuar nëse një ngarkesë është proporcionale ose jo duhen marrë në konsideratë kostot e masës, efektet diskriminuese që dështimi i adaptimit të masës do të ketë mbi personat me aftësi të kufizuar, struktura dhe karakteristikat e personit, entitetit apo organizatës që duhet ta zbatojë dhe mundësinë e financimit zyrtar ose ndonjë asistencë tjetër.”

Sipas **Aktit për Diskriminimin e Aftësisë së Kufizuar së Mbretërisë së Bashkuar**, një punëdhënës diskriminon një person me aftësi të kufizuar nëse plotëson dy kushtet e mëposhtme: “(a) ai dështon në përmbushjen e detyrimit të kapitullit 6 [për kryerjen e rregullimeve të arsyeshme] në lidhje me personat me aftësi të kufizuar; dhe (b) ai nuk mund të provojë se dështimi i tij për të përmbushur detyrimin është i justifikueshëm.” Kapitulli 6 (4) i Aktit, rendit faktorët kryesorë të cilët duhen konsideruar gjatë përcaktimit nëse është e arsyeshme që një punëdhënës të ndërmarrë një hap të veçantë për respektimin e detyrimit për kryerjen e rregullimeve të arsyeshme:

- “(a) Kufiri deri ku ndërmarrja e hapave të duhur do të parandalonte efektin në fjalë;
- (b) Kufiri deri ku është e praktikueshme për punëmarrësin të ndër-marrë këtë hap;
- (c) Kostot financiare ose të tjera të cilat do të shpenzohen nga punëmarrësi në marrjen e hapit dhe kufirin deri ku mund të merret pa dëmtuar ndonjë nga aktivitetet e tij;
- (d) Kufirin financiar dhe burime të tjera të punëmarrësit;
- (e) Asistencën financiare ose tjetër të punëmarrësit në lidhje me ndërmarrjen e hapit.”

Sipas **Aktit për Diskriminimin të Aftësisë së Kufizuar të Australisë të vitit 1992**, punëmarrës, autoritetet mësimore dhe të tjerë duhet të kryejnë “rregullim të arsyeshëm” për sa kohë që kjo nuk imponon një vështirësi të pajustificueshme ose të paarsyeshme.

Kapitulli 11 thotë se “në përcaktimin e asaj çka përbën vështirësi të pajustificueshme, duhen marrë parasysh të gjitha rrethanat e duhura të çështjes së veçantë,” duke përfshirë:

- ▶ Natyrën e përfitimit ose disavantazhit që ka gjasa të përkeqësohet ose të pësohet nga ndonjë person i prekur;

VAZHDON ►

◀ VAZHDIM

- ▶ Efektin e aftësisë së kufizuar të një personi të prekur;
- ▶ Rrethanat financiare dhe shpenzimet e përafërta që duhen kryer nga personi që pretendon vështirësi të pajustificuar; dhe
- ▶ Në rast kryerjeje të shërbimeve, ose përshtatjes së mjediseve, Komisioni duhet të pajiset me një plan pune sipas kapitullit 64.

Përsa i përket kostove të punëmarrësit, Komisioni Australian për të Drejtat e Njeriut dhe Mundësitë e Barabarta specifikon se duhen marrë në konsideratë "kostot neto (ose përfitimet) të cilat janë të identifikueshme ose kanë gjasa të shpenzohen nga punëmarrësi, e jo vetëm kostoja direkte ose e përgjithshme." Kjo mund të kërkojë marrjen parasysh të:

- ▶ Kostove direkte;
- ▶ Taksave përjashtuese, granteve ose përfitimeve të tjera financiare në lidhje me rregullimin ose në lidhje me punësimin e personit në fjalë;
- ▶ Kostove ose përfitimeve të tërthorta, duke përfshirë prodhueshmërinë e pozicionit të dhënë, punonjësit e tjerë dhe vetë kompaninë;
- ▶ Rritjeve ose uljeve në shitje, të ardhura ose në efektshmërinë e shërbimit ndaj klientit;
- ▶ Deri në ç'masë arrin kostoja shtesë e një përshtatjeje mbi koston e pajisjeve ose mjediseve ekzistuese ose që do të sigurohen për një punonjës në pozicion të ngjashëm por që nuk ka aftësi të kufizuar;
- ▶ Deri në ç'masë mund të kërkohej një rregullim nga ligje, standarte ose marrëveshje të tjera në fuqi; dhe
- ▶ Aftësive të duhura, zotësisë, trajnimit dhe ekperiencës së personit që kërkon rregullimin.

Përveç marrjes në konsideratë të koston financiare dhe përfitimeve të kryerjes së rregullimit dhe dhënien e mundësisë, trajtimit ose pjesëmarrjes së barabartë një personi me aftësi të kufizuar të përfshirë drejtpërdrejt, mund të merret parasysh gjithashtu:

- ▶ Çdo përfitim, ose disavantazh, i rregullimit të kryer që lidhet me aksesin ose mundësitë e punonjësve të tjerë, klientëve ose persona të tjerë të cilët mund të influencohen;
- ▶ Përfitimi ose disavantazhi i rregullimit në fjalë ndaj organizimit të efektshëm të punës në kompaninë ose vendin e punës të përfshirë,

VAZHDON

◀ VAZHDIM

përsa i përket: numrit të punonjësve, organizimit të hapësirës së punës; natyrës së punës që duhet kryer; kërkesave të klientëve; nevojave të planifikimit të forcës së punës; çdo “krizë” ose ndërprerje në prodhimin e përfshirë gjatë rregullimit, dhe çdo faktor tjetër që ndikon mbi efektshmërinë; prodhimin, suksesin dhe, atje ku ndodh, konkurrencën së kompanisë;

- ▶ Nëse rregullimi do të imponojë kërkesa të paarsyeshme mbi punonjësit e tjerë;
- ▶ Natyra dhe gjasat që mund të ketë çdo përfitim ose disavantazh ndaj shëndetit ose sigurisë së çdo personi gjatë kryerjes së rregullimit;
- ▶ Natyra dhe gjasat që mund të ketë çdo përfitim ose disavantazh mjedisor si rezultat i rregullimit; dhe
- ▶ Nëse rregullimi i përfshirë do të ndihmojë, ose do të ndërhyjë, në përputhje me parashikimet e ligjeve, në standarte ose marrëveshje të tjera dhe në natyrën dhe gjasat e ndonjë përfitimi ose disavantazhi tjetër si rezultat i kryerjes së rregullimit.

Masat e veçanta

Legjislacioni nuk duhet kufizuar vetëm me ndalimin e diskriminimit, por gjithashtu mund të kërkojë nga Shteti dhe aktorët privatë marrjen e masave pozitive. Neni 5 (4) i Konventës thotë se në mënyrë që të sigurohet barazia me të tjerët, ndonjëherë mund të jetë e nevojshme mbështetja e veçantë për individë të veçantë ose persona me lloje të veçanta të aftësisë së kufizuar. Kjo mund të marrë dy forma:

▶ **Masa të vazhdueshme ose të përhershme**

Këto janë masa të veçanta që do të jenë të vazhdueshme ose mundësisht të përhershme. Për shembull, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të mund të lëvizin po aq lirshëm sa edhe të tjerët, Qeveritë mund të lidhin një pension udhëtimi për persona me aftësi të kufizuar për përdorimin e takside.

▶ **Masa të veçanta të përkohshme**

Këto masa adoptohen për të riadresuar disavantazhin e mëparshëm të personave me aftësi të kufizuar, por ato mund të gjasin për një periudhë të caktuar kohe. Për shembull, një Qeveri mund të përcaktojë objektiva ose kuota për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, me qëllim heqjen e kuotave pas arritjes së objektivit.

Masat e veçanta të vazhdueshme edhe ato të përkohshme lejohen nga Konventa dhe sipas saj nuk përbëjnë diskriminim. Në fakt, të dy llojet e masave të veçanta mund të jenë të nevojshme për arritjen e barazisë dhe për këtë arsye një Shtet anëtar

do të detyrohet të miratojë një sërë masash të veçanta në fusha të ndryshme të jetës sociale.

Ndonjëherë, kur miratohen masa të veçanta për adresimin e historikut të dis-avantazhit dhe vazhdimësinë e tij nga anëtarë të një grupi të caktuar, ato sfidohen nga persona të cilët nuk i përkasin atij grupi mbi pretendimin se janë diskriminuese. Parlamentet duhet të marrin parasysh se çdo garanci cilësie, kushtetuese ose legislative, duhet të bëjë të qartë se masat e veçanta të përmendura në Konventë janë të ligjshme sipas ligjit të vendit dhe nuk janë subjekte sfide sipas garantëve të tjerë të barazisë, nga persona të cilët nuk kanë aftësi të kufizuar por pretendojnë se përjashtimi i tyre është një shkelje e të drejtave të tyre të barazisë.

Parlamentet kanë gjithashtu një rol të veçantë për rritjen e ndërgjegjësimit në komunitetin e gjerë, të nevojës për masa speciale dhe përfitimin që ka shoqëria si një e tërë. Madje, mund të jetë e nevojshme që departamentet shtetërore dhe korporatat private të raportojnë çdo vit mbi masat që ato kanë marrë për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Kërkesat e raportimit mund të mbulojnë disa

Detyrimet e Shteteve anëtarë për rregullimin e sektorit privat:

- ▶ Shtetet Anëtare ndërmarrin ...të gjitha masat e duhura për eliminimin e diskriminimit me bazë në aftësinë e kufizuar nga çdo person, organizatë ose kompani private (neni 4 (1) (e)).
- ▶ Shtetet Anëtare ndërmarrin ... nxitjen e të gjithë organeve të medias për portretizimin e personave me aftësi të kufizuar në linjë të drejtë me qëllimin e Konventës në fjalë (neni 8 (2) (c)).
- ▶ Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin masat e duhura për të ... siguruar se kompanitë private të cilat ofrojnë shërbime dhe mjedise të hapura për publikun duhet të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesueshmërisë për njerëzit me aftësi të kufizuar (neni 9 (2) (b)).
- ▶ Shtetet Anëtare duhet të ... marrin mjekë profesionistë për të siguruar përkujdesje të së njëjtës cilësi për personat me aftësi të kufizuar si edhe për personat e tjerë, bazuar në miratimin e lirë dhe të informuar, inter alia, duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut, dinjitetin, autonominë dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet trajnimit dhe përhapjes së standarteve etike për kujdesin shëndetësor publik dhe privat (neni 25 (d)).
- ▶ Shtetet Anëtare duhet të mbrojnë dhe të promovojnë realizimin e të drejtës për të punuar, përfshirë personat që fitojnë një aftësi të kufizuar gjatë periudhës së punësimit, duke ndërmarrë hapat e duhur, edhe në mënyrë ligjore, për, inter alia ... promovimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuar në sektorin privat përmes politikave dhe masave të përshtatshme, të cilat mund të përfshijnë programe aksioni angazhuese, nxitëse dhe masa të tjera (neni 27 (1) (h)).

fusha të ndryshme, përfshirë: hapat e marra për t'u siguruar që të drejtat e personave me aftësi të kufizuar po garantohen në praktikë; rritjen e sukseshme të përqindjes së punonjësve të cilët janë persona me aftësi të kufizuar; ose përmirësimin e shërbimeve ndaj klientëve me aftësi të kufizuar të cilët mund të kenë nevoja të veçanta.

Diskriminimi nga autoritetet e Shtetit, personat privatë dhe korporatat

Një nga elementët kryesorë të Konventës është që personat me aftësi të kufizuar duhen mbrojtur ndaj diskriminimit si nga aktorët publikë ashtu edhe nga ata privatë. Për këtë arsye, një ligj anti-diskriminim ose masa të tjera legjislative që ndalojnë diskriminimin dhe përligjin trajtimin e barabartë duhen zbatuar për individë, organizma ose korporata private, si edhe për zyrtarë publikë dhe organet shtetërore. Gjithashtu, Konventa detyron Shtetet të rregullojnë sektorin privat.

Fushat specifike për reformë legjislative

Konventa specifikon një numër fushash që kërkojnë garanci ose mbrojtje legjislative. Neni 12 (1) i Konventës riafirmon të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për njohjen e tyre si persona përpara ligjit, dhe neni 12 (2) pranon se personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të përdorin kapacitetet e tyre ligjore njësoj si të tjerët. Neni 12 (3) nënvizon nevojën për marrjen e masave në mbështetje të ushtrimit të këtij kapaciteti, ndërsa neni (4) bën thirrje për caktimin e mbikqyrësve për të siguruar mosshpërdorimin e kësaj mbështetjeje.

Meqënëse mohimi i kapacitetit ligjor të personave me aftësi të kufizuar ka çuar në shkelje flagrante të të drejtave të tyre, çdo proces reformash ligjore duhet ta adresojë këtë si një çështje prioritare. Parlamentet duhet të shqyrtojnë ligjin në fuqi për të përcaktuar nëse ekzistojnë kufizime formale ndaj kapacitetit të personave me aftësi të kufizuar dhe nëse parashikimet e ligjit dhe praktika përputhen me Konventën. Parlamentet duhet gjithashtu të konsiderojnë nëse, pavarësisht garancive formale për respektimin e kapacitetit ligjor të personave me aftësi të kufizuar, kapaciteti ligjor respektohet në praktikë. Konventa në mënyrë specifike kërkon nga Shtetet të marrin masat e duhura për t'u siguruar se personat me aftësi të kufizuar që kanë nevojë për asistencë në ushtrimin e këtij kapaciteti, e marrin atë.

Për më tepër, Konventa përmban një numër garancish përsa i përket fushave ku të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuar janë dhe vazhdojnë të mohohen. Këto përfshijnë të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së njeriut (neni 14) dhe të drejtat e lirisë nga tortura dhe lirisë nga shfytëzimi, dhuna dhe abuzimi brenda dhe jashtë shtetësisë.

Një Shtet duhet të rishikojë në mënyrë të kujdesshme ligjet dhe zbatimin e tyre, sidomos në fusha si heqja e lirisë së personave me aftësi të kufizuar, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuar intelektuale dhe mendore. Për shembull, Shtetet duhet të kenë parasysh kërkesat e Konventës mbi jetesën e pavarur në komunitet në vend të institucionalizimit të detyruar ose ndërhyrjeve të detyruara mjekësore, dhe duhet të sigurojnë se ekzitojnë ligje dhe procedura për monitorimin e zbatimit të këtij ligji, të

Shtete që njohin gjuhën kombëtare të shenjave

Kushtetuta e Ugandës, në mënyrë të veçantë, njih gjuhën e shenjave dhe detyrën e Shtetit për të mbajtur zhvillimin e saj. Neni 24 i Kushtetutës thotë se:

“Shteti duhet të promovojë zhvillimin e një gjuhe shenjash për personat me probleme dëgjimi.”

Neni 17 i **Kushtetutës së Finlandës** (1995), Neni 17 - E drejta e njeriut për gjuhën dhe kulturën, thotë se:

“... Të drejtat e personave që përdorin gjuhën e shenjave dhe e personave që kanë nevojë për interpretim ose përkthim për shkak të aftësisë së kufizuar duhet garantuar me Ligj.”

Neni 101 i **Kushtetutës së Republikës Bolivariene të Venezuelës** i vitit 1999 thotë se:

“Shteti garanton lëshimin, marrjen dhe qarkullimin e informacionit kulturor. Media televizive duhet të përdorë nëntituj dhe përkthim në gjuhën Venezueliane të shenjave për personat me probleme dëgjimi. Kushtet dhe modalitetet e këtyre detyrimeve duhen përcaktuar me ligj.”

Gjuha e Shenjave Tailandeze u njoh si **“gjuha kombëtare e personave me probleme dëgjimi në Tailandë”** në gusht 1999, në një rezolutë të firmosur nga Ministri i Arsimit si përfaqësues i Qeverisë Mbretërore të Tailandës.

Në vitin 2006, në **Zelandën e Re hyri në fuqi Akti për Gjuhën e Shenjave**. Ky statut siguron njohjen zyrtare të Gjuhës së Shenjave të Zelandës së Re (NZSL), që është gjuha e parë e preferuar e Zelandezëve me probleme dëgjimi. Akti njih gjuhën e persona me probleme dëgjimi si një gjuhë unike të Zelandës së Re dhe i jep NZSL status të njëjtë me atë të gjuhëve të folura. Akti siguron që çdo njeri që përfshihet në procedura ligjore të mund të përdorë NZSL gjatë këtyre procedurave. Akti gjithashtu thotë se komuniteti i persona me probleme dëgjimi duhet të konsultohet mbi çështje që ndikojnë mbi gjuhën e tyre, duke përfshirë, për shembull, promovimin e përdorimit të NZSL; se NZSL duhet përdorur për promovimin e shërbimeve të qeverisë dhe për ndarjen të informacionit me publikun; si edhe që shërbimet dhe informacioni zyrtar duhet të jetë i aksesueshëm nga komuniteti i personave me probleme dëgjimi nëpërmjet mjeteve të duhura, ku përfshihet përdorimi i NZSL.

Akti gjithashtu siguron se departamentet zyrtare duhet, në mënyrën më të praktikueshme të mundur, të udhëhiqen nga parime ndërveprues me komunitetin e personave me probleme dëgjimi (paragrafi 9). Asgjë në këtë paragraf nuk duhet lexuar si lejim i avantazheve për komunitetin e personave me probleme dëgjimi, avantazhe të cilat nuk i gëzojnë të tjerët (paragrafi 9 (2)).

Zgjidhje

Sipas **Urdhëresës mbi Diskriminimin e Aftësive të Kufizuara** të vitit 1995, kur një padi për diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar paraqitet përpara Gjykatës në **Hong Kong, Rajon me Administrim Special i Kinës**, Trupi Gjykues gëzon pushtet mjaft të gjerë, që i jep të drejtë, sipas s 72, të:

- “ (a) Lëshojë një deklaratë se i akuzuari është sjellë, ose ka kryer një akt, që është i paligjshëm sipas kësaj Urdhërese, dhe urdhëron që i akuzuari të mos përsërisë një sjellje apo akt të tillë të paligjshëm;
- (b) Urdhërojë që i akuzuari të ndërmarrë çdo akt ose sjellje të arsyeshme për të kompensuar ndonjë humbje ose dëmtim të pësuar nga akuzuesi;
- (c) Urdhërojë që i akuzuari të punësojë ose ri-punësojë akuzuesin;
- (d) Urdhërojë që i akuzuari të promovojë akuzuesin;
- (e) Urdhërojë që i akuzuari të paguajë dëmshpërblim ndaj akuzuesit për ndonjë humbje ose dëmtim të pësuar si pasojë e sjelljes ose aktit të të akuzuarit;
- (f) Urdhërojë që i akuzuari të paguajë dëmtime ndëshkuese ose shembullore ndaj akuzuesit; ose
- (g) Të lëshojë një urdhër që deklaron void ab initio të plotë ose të pjesshëm nga data që specifikohet në urdhër, të çdo kontrate ose marrëveshje në kundërshtim me këtë Urdhëresë.”

hetojnë rastet e abuzimit dhe të imponojnë masa ndëshkuese, sipas nevojës (neni 16 (4)).

Ligjet për pronësinë intelektuale dhe sigurimi i aksesit për librat, filmat dhe format e tjera të medias

Shtetet anëtare duhet të kontrollojnë ligjet e tyre të pronësisë intelektuale për të siguruar se ato nuk pengojnë personat me aftësi të kufizuar nga aksesimi i materialeve kulturore. Një numër vendesh kanë adoptuar një legjislacion të tillë në mbështetje të detyrimeve të tjera ndërkombëtare, siç janë marrëveshjet e lidhura me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Organizatën Botërore të Tregëtisë.

Legjislacion që njeh gjuhë(ët) kombëtare të shenjave

Konventa detyron Shtetet anëtare të njohin dhe promovojnë përdorimin e gjuhës së shenjave. Kjo ka gjasa të kërkojë zbatimin e disa ligjeve.

Procedurat e ankimit sipas ligjit kombëtar

Legjislacioni duhet të sigurojë se një person që ka pësuar diskriminim të paligjshëm është i aftë të sigurojë një zgjidhje të efektshme. Zgjidhjet mund të përfshijnë kompensime ose dëmshpërblime, urdhër arresti, urdhër për ndalimin e veprimeve diskriminuese dhe parandalimin e tyre në të ardhmen, kërkesë për plotësimin e akomodimit të arsyeshëm sipas të drejtave të individit, falje, urdhër për marrjen e masave dëmshpërblyese në shkallë të gjerë, përfshirë reagimin pozitiv, ose masa të tjera.

Sipas ligjit të diskriminimit në një numër vendesh, pasi një akuzues ka mbledhur fakte nga të cilat mund të provohet ekzistenca e diskriminimit, barra e provës i kalon të akuzuarit për të treguar se trajtimi në fjalë nuk bazohej në një fushë të ndaluar diskriminimi ose, nëse ishte, që ishte kryer brenda një kufiri të lejueshëm të ndalimit të diskriminimit. Duke marrë parasysh vështirësitë se ankuesit në rastet e diskriminimit përballen shpesh me prova direkte të diskriminimit, ky është një dimension i rëndësishëm i ligjit procedural që duhet adresuar (shiko kutinë mbi përjasjet e ndryshme të legjislacionit të diskriminimit në faqen e mëparshme).

Masat procedurale për të promovuar zbatimin

Roli që mund të luajnë parlamentarët në procesin paraprirës të ratifikimit është diskutuar më sipër në këtë Udhëzues. Pas ratifikimit ose pranimit të Konventës, Shteti përballlet me detyrime të rëndësishme, dhe legjislatura mund të luajë një rol të rëndësishëm në realizimin e tyre. Si hapa të parë pas nënshkrimit dhe ratifikimit të Konventës, parlamentarët duhet të:

Ndërmarrin një rishikim gjithëpërmblëdhës

Neni 4 (1) (b) i Konventës detyron Shtetet anëtare “të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë legjislacionin, për modifikimin ose shfuqizimin e ligjeve ekzistuese, rregulloreve, zakoneve dhe praktikave që përbëjnë diskriminim kundër personave me aftësi të kufizuar.” Kështu, një prej hapave më të rëndësishëm që një Shtet duhet të ndërmarrë sa më shpejt pasi është bërë palë e Konventës, preferueshmërisht pas nënshkrimit të Konventës, është rishikimi i përgjithshëm i ligjit ekzistues për të përcaktuar deri në çfarë mase përputhet me marrëveshjen. Shteti gjithashtu duhet të identifikojë masa të reja legjislative dhe politika në mënyrë që Konventa të jetë e efektshme. Po kështu, duhet zhvilluar një kalendar i detajuar për rishikimin legjislativ dhe reformën.

Një rishikim i përgjithshëm i kësaj natyre mund të jetë veçanërisht i dobishëm për Shtetin gjatë përgatitjes së raportit fillestar për Konventën, brenda dy viteve që nga ratifikimi i saj. Raporti fillestar do të vendosë bazën për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, do të tregojë fushat ku reforma është një prioritet, dhe do të ndihmojë zhvillimin e një programi për përmirësimin e situatës në mënyrë të kujdesshme, të planifikuar dhe të monitoruar.

Çështje kritike që duhen adresuar në masat legjislative

- ▶ Çdo legjislacion duhet të bazohet mbi mirëkuptimin se:
 - ▶ Aftësia e kufizuar është rezultat i ndërveprimit të personit me mjedisin dhe se
 - ▶ Personat me aftësi të kufizuar gëzojnë të drejta civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale në baza të barabarta me të tjerët.
- ▶ Diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë mohimin e akomodimit të arsyeshëm si një formë diskriminimi, nga sektori publik dhe privat është i ndaluar.
- ▶ Personat me aftësi të kufizuar duhet të përfshihen dhe të marrin pjesë në të gjitha aspektet e shoqërisë, përfshirë:
 - ▶ Jetën politike publike (në bazë të konsultimeve me persona me aftësi të kufizuar për zbatimin e Konventës dhe politikave ose ligjeve që ndikojnë mbi to, rishikim të ligjit zgjedhor, etj);
 - ▶ Jetën kulturore, zbavitjen, kohën e lirë dhe sportet; dhe
 - ▶ Arsimin.
- ▶ Mjedi fizik, transporti, teknologjitë, informacioni dhe komunikimi, dhe shërbimet e mjedisit duhet të jenë të aksesueshme.
- ▶ Përsheptimi ose arritja e barazisë de facto përfshin masa specifike të një natyre të përkohshme.
- ▶ Sigurimi i zgjidhjeve të përshtatshme në favor të të drejtave të individëve dhe grupeve të veprimit civil, kriminal dhe administrativ kundër diskriminimit me bazë aftësinë e kufizuar.
- ▶ Çdo përcaktim mbi llojet e aftësisë së kufizuar duhet të jetë në përputhje me nenin 2 të Konventës.
- ▶ Duhet siguruar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar si persona përpara ligjit dhe njohja e kapacitetit të tyre ligjor, duke përfshirë masat mbështetëse dhe mbikqyresit e duhur.
- ▶ Personat me aftësi të kufizuar duhet të kenë akses ndaj drejtësisë, duke kërkuar akomodim procedural në të gjitha fazat e procedurave ligjore.
- ▶ Duhet krijuar një mekanizëm kombëtar për monitorimin e zbatimit të Konventës.

Ekzistojnë një numër mënyrash me të cilat mund të kryhet ky rishikim. Për rishikimin dhe raportimin pranë Qeverisë mund të krijohet një organ i veçantë i pavarur, ose kjo detyrë mund t'i ngarkohet një organi ekzistues, si një komisioni për barazinë, komisionit kombëtar për të drejtat e njeriut ose komisionit për aftësinë e kufizuar. Vetë Parlamenti, mund të ngrejë një komision për mbikqyrjen e procesit ose t'ia ngarkojë këtë detyrë një prej organeve të tij ekzistues.

Kuadri i Konventës duhet të jetë standarti kundrejt të cilit niveli i gëzimit të të drejtave të njeriut nga personat me aftësi të kufizuar, është i matshëm. Personat me aftësi të kufizuar duhet të marrin pjesë gjerësisht në proces, si anëtarë të organit mbikqyrës ashtu edhe si kontribues. Rishikimi nuk duhet të jetë një aktivitet i njëhershëm. Organit në fjalë duhet t'i jepet përgjegjësi për mbikqyrjen në vazhdim ose duhet siguruar ekzistenca e një rishikimi të pavarur për zbatimin e rekomandimeve të tij pas një periudhe të arsyeshme kohore, për shembull, tre deri në pesë vjet.

Të sigurohet se të gjithë ligjet janë në përputhje me Konventën

Siguria se ligjet dhe rregulloret e reja janë në përputhje me, dhe tejkalojnë, objektivat e Konventës është po aq e rëndësishme sa edhe rishikimi i ligjeve ekzistuese. Konventa i detyron Shtetet të marrin parasysh të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në të gjitha politikat dhe programet (neni 4 (1) (c)). Për këtë qëllim, zyrtarët e qeverisë duhet të sigurohen se propozimet e tyre përputhen me Konventën kur ata zhvillojnë politika dhe hartojnë legjislacionin.

Legjislacioni luan një rol kritik në shqyrtimin e ligjeve të reja. Parlamentet duhet të sigurojnë se ekziston një fazë në procesin e legjislacionit kur ligji duhet analizuar për përputhjen e tij me Konventën. Kjo mund të kërkojë ngritjen e një komisioni anëtarët e të cilit do të shqyrtojnë propozimet legjislative ose do ia përcjellin këtë përgjegjësi një komisioni ose komisioneve ekzistuese që shqyrtojnë legjislacionin për pajtueshmëri me parimet e të drejtave të njeriut. Sërish, është thelbësore përfshirja e personave me aftësi të kufizuar dhe e organizatave që merren me çështje të aftësisë së kufizuar në këtë proces. Parlamentet mund të duhet të bëjnë përpjekje të veçanta për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar janë të ndërgjegjësuar mbi proceset

“Afrika e Jugut ka shënuar një progres të dallueshëm në fushën e aftësisë së kufizuar, vetë prezantimit dhe reformës së politikave. Megjithatë, kjo Konventë do të çimentojë dhe do të sigurojë se pavarësisht ndryshimit të dimensionit politik, nëse dhe kur të ndodhë, vendi do të jetë i aftë të vazhdojë të mbrojtë, dhe të ketë përgjegjësi ndaj njerëzve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe do të sigurojë trajtimin e tyre si qytetarë të klasit të parë si gjithë personat e tjerë me aftësi të kufizuar.”

Hendrietta Bogopane-Zulu, AP (Afrikë e Jugut)

dhe hartimin e legjislacionit, dhe të ndërmjetësojnë përcjelljen e këndvshtrimeve të tyre legjislativës.

Disa parlamente kanë nevojë që dega ekzekutive e qeverisë të deklarojë se legjislacioni përputhet me standartet e duhura ndërkombëtare ose të japë një vlerësim mbi ndikimin e legjislacionit mbi një grup të veçantë kur prezantohet draft legjislacioni në parlament. Një deklaratë për ndikimin mbi aftësinë e kufizuar, e pavarur ose pjesë e vlerësimit të ndikimit të drejtave të njeriut, do të ndihmonte përqëndrimin e vëmendjes së Qeverisë në këtë çështje.

Të përfshijnë persona me aftësi të kufizuar në procesin ligjor

Personat me aftësi të kufizuar duhen përfshirë në mënyrë aktive në draftimin e legjislacionit dhe në të tjera procese vendimarrëse të cilat ndikojnë mbi ta – ashtu siç u aktivizuan efektshmërisht edhe në formulimin e vetë Konventës.

Ata gjithashtu duhen inkurajuar të ofrojnë vëzhgime dhe udhëheqje gjatë zbatimit të ligjeve. Ekzistojnë disa mënyra për t'u siguruar se të gjitha pikëpamjet janë marrë në konsideratë, duke përfshirë dëgjimin e publikut (me lajmërim dhe publicitet të mjaftueshëm), duke u dërguar propozime me shkrim komisioneve të duhura parlamentare dhe duke ndarë komentet e mbledhura me publikun e gjerë, përmes faqes së internetit të parlamentit dhe mjete të tjera të medias.³

Parlamenti duhet të sigurojë se ligjet, procedurat dhe dokumentacioni i tij është në dispozicion të publikut në formate të aksesueshme, të botuara, në gjuhën e vendit dhe Braille, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të mund të marrin pjesë gjerësisht në zhvillimin e legjislacionit në përgjithësi, dhe sidomos në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar. Ndërtesa e parlamentit dhe vende të tjera që organizojnë seanca dëgjimore duhet të jenë të aksesueshme edhe nga personat me aftësi të kufizuara.

Të përfshijnë parlamentet provinciale apo shtetërore

Duke pasqyruar gjuhën e Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 4 (4) i Konventës deklaroi se parashikimet e Konventës “janë të vlefshme për të gjithë Shtetet federale pa asnjë kufizim ose përjashtim.” Në disa Shtete federale, përgjegjësia kryesore dhe pushteti për të zbatuar parashikime të caktuara të Konventës mund t'i besohet provincave ose trupave zgjedhorë.

Një dështim në ushtrimin e këtij pushteti mund të detyrojë Shtetin, në tërësi, të thyejë detyrimet e tij ndërkombëtare. Nuk ka asnjë justifikim se Qeveria qendrore nuk kishte pushtet në këtë fushë. Ky parashikim ofron disa mundësi, derisa organet

³ Një diskutim më gjithëpërfshirës mbi përfshirjen e qytetarëve në proceset parlamentare mund ta gjeni në: Parlamenti dhe Demokracia në Shekullin e Njëzetë: Udhëzues mbi Praktikën e Mira (Gjenevë, Bashkimi Ndër-Parlamentar, 2006), fq. 79-87.

ligjvënese shtetërore ose të specializuara të mund të zbatojnë nismat e tyre ligjore, brenda fushës së tyre të kompetencës, për të realizuar efektin e parashikuar në Konventë, krahas masave të ndërmarra nga Qeveria qendrore.

LISTË PËR PARLAMENTARËT

Si mund të ndihmoj për përfshirjen e Konventës në ligjin e vendit:

- Sigurohu që ligji suprem i vendit (kushtetutë ose ligj bazë) mbrohet dhe njeh të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale të personave me aftësi të kufizuara.
- Sigurohu që legjislacioni ekzistues do të rishikohet për përputhjen e tij me Konventën.
- Sigurohu që të gjitha fushat e përfshira në Konventë janë përfshirë në ligjet e vendit, si ligjet e reja ashtu edhe ato ekzistuese.
- Sigurohu që personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre janë konsultuar gjatë procesit ligj-bërës.
- Sigurohu që janë ngritur institucionet dhe mekanizmat e duhura në nivelin parlamentar në mënyrë që çdo ligj i ri i miratuar të jetë në përputhje me Kushtetutën.
- Siguro financime të përshtatshme në buxhetin e shtetit për sektorë të ndryshëm, në funksion të përmbushjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- Përdor procedurat parlamentare si:
 - ▶ Pyetje me gojë dhe me shkrim;
 - ▶ Paraqitjen e draft ligjeve; dhe
 - ▶ Debat parlamentar.
- Rrit ndërgjegjësimin mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përmes:
 - ▶ Debatit në gjirin e partisë tënde politike;
 - ▶ Aleancave me parlamentarë të tjerë, për të forcuar kapacitetin tuaj lobues;
 - ▶ Partneritete me organizatat e personave me aftësi të kufizuara; dhe
 - ▶ Fushata për ndërgjegjësim publik.



KAPITULLI GJASHTË

Nga parashikimet ligjore në praktikë: zbatimi i Konventës

Vetëm përmirësimi i legjislacionit nuk do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë të drejtat e tyre. Shtetet do të duhet të formulojnë politika të efektshme dhe programe që do të transformojnë parashikimet e Konventës në praktika që do të kenë një ndikim të vërtetë mbi jetët e personave me aftësi të kufizuar.

Për personat me aftësi të kufizuar, ashtu si për të gjithë njerëzit, mohimi i një të drejte mund të çojë në mohimin e të drejtave dhe mundësive të tjera gjatë gjithë jetës së tyre. Për të ilustruar këtë pikë, më poshtë theksohen pesë parashikime të Konventës. Marrëdhënia midis aftësisimit dhe riaftësisimit (neni 26), aksesueshmëria (neni 9), arsimiti (neni 24), puna (neni 27) dhe kapaciteti ligjor (neni 12) shpjegohen qartësisht. Megjithatë, kjo nuk sygjeron, se këto pesë fusha duhen priorizuar mbi parashikimet e tjera të Konventës. Përkundrazi, meqenëse të drejtat ndërthuren, Shtetet duhet të përqipen për zbatimin e parashikimeve të veçanta të Konventës në mënyrë konkurruese.

Aftësimi dhe riaftësimi

Si mëson të jetojë si një pjesëtar aktiv i shoqërisë, një fëmijë i lindur i verbër? Si përshtatet me kushtet e reja të jetesës një i ri i cili pëson lëndime të rënda në shtyllën kurrizore dhe humb aftësinë për të ecur? Si vazhdon punën dhe kujdeset për familjen e saj një nënë që ka humbur këmbët nga shpërthimi i një mine?

Aftësimi dhe riaftësimi (neni 26) janë hapat e parë të rëndësishëm për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar janë të aftë të bëjnë jetë të pavarur (neni 19), të lëvizin lirshëm në shoqëri (neni 20) dhe janë të aftë të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Përmes këtyre proceseve, personat me aftësi të kufizuara fitojnë dhe zhvillojnë aftësi që do t'i mundësojnë ata të punojnë dhe

të fitojnë të ardhura, të marrin vendime të rëndësishme, të kontribuojnë në shoqërisë dhe të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera të përmendura në Konventë.

Aftësimi përfshin të mësuarit e aftësive që do të mundësojnë një person të jetë i vlefshëm në shoqëri. Këto programe më të shumtën e rasteve fokusojnë fëmijët e lindur me aftësi të kufizuar. Riaftësim do të thotë rikthim i kapaciteteve dhe aftësive. Kjo zakonisht zbatohet për një të rritur që duhet të riadaptohet në shoqëri pas pësimit të një aftësie të kufizuar.

Zakonisht, aftësimi dhe riaftësimi janë procese me kohë të kufizuar të cilat përshtaten me individin. Ato përfshijnë përcaktimin e objektivave që duhen arritur me ndihmën e mbështetjes së koordinuar të profesionistëve dhe mundësisht me pjesëmarrjen e anëtarëve të familjes dhe miqve të ngushtë. Aftësimi dhe riaftësimi mund të përfshijnë mbështetje mjekësore, psikologjike, sociale dhe vullnetare. Pa përfitim të këtyre ndërhyrjeve, personat me aftësi të kufizuar nuk do të mund të realizojnë të drejtat për aksesueshmëri, arsim dhe punësim.

Riaftësimi me bazë në komunitet

Riaftësimi me bazë në komunitet (CBR) është një përfaqëse e praktikuar në më shumë se 90 vende në të gjithë botën. Është pjesë e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e komunitetit që përfshin uljen e varfërisë, mundësitë e barabarta dhe përfshirjen e individëve me aftësi të kufizuar në shoqëri. Meqënëse komunitetet dallojnë në kushtet social-ekonomike, terren, kultura dhe sisteme politike, nuk mund të ekzistojë një model i vetëm CBR i aplikueshëm në të gjithë botën. Për këtë arsye, CBR është një strategji lehtësisht e përshtatshme, dinamike dhe adaptuese që përfshin aksesin ndaj kujdesit shëndetësor, arsimit dhe trajnimit artizanal, projekte që nxisin të ardhurat, si edhe pjesëmarrje dhe përfshirje në komunitet.

CBR punon me dhe përreth komuniteteve. Ai zbatohet nëpërmjet përpjekjeve të kombinuara të personave me aftësi të kufizuar, familjeve të tyre, organizatave dhe komuniteteve, dhe organizatave të duhura qeveritare ose jo-qeveritare (OJF) që punojnë në sektorin e zhvillimit. Meqënëse është aktiviteti i komunitetit ai që siguron se personat me aftësi të kufizuar kanë të njëjtat të drejta dhe mundësi si anëtarët e tjerë të komunitetit, CBR konsiderohet gjithnjë e më shumë si një përbërës thelbësor i zhvillimit të komunitetit.

WHO, ILO, UNESCO, OJF ndërkombëtare me eksperiencë të gjerë mbi aftësinë e kufizuar dhe zhvillimin, dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuar po hartojnë udhëzime se si CBR mund të ndihmojë personat me aftësi të kufizuara të kuptojnë të drejtat e tyre dhe të promovojnë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.